




PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS


DORACAK MBI TATIMET NË KOSOVË



2007

info@atk-ks.org
www.atk-ks.org

DORACAK MBI TATIMET NË KOSOVË



Pyetje
Përgjigje
Shembuj

BOTIMI I

PËRMBAJTJA

<input type="checkbox"/>	PARATHËNIE	
	INFORMACIONET E PËRGJITHSHME PËR BIZNESET DHE TATIMET NË KOSOVË.....	7
	Cilat janë tipet e biznesit që mund të krijohen në Kosovë?	9
	Cilat janë tatimet mbi bizneset ?.....	9
	Kush janë obliguesit e Tatimit në të ardhurat e korporatave?	10
	Kush janë obliguesit e Tatimi në të Ardhurat Përsonale ?.....	10
	Çfarë është Tatimi në Vlerën e Shtuar?	11
	Çfarë nënkuptojmë me Deklaratë Tatimore ?.....	11
	Cilat janë deklaratat tatimore?	11
<input type="checkbox"/>	TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	
	Çka është tatimi në të ardhura personale dhe cilat burime të të hyrave i përfshinë ?	15
	Kush është tatimpagues i të ardhurave personale si dhe çka është objekti i të tatimit?.....	15
	Pyetje - Përgjigje - Shembuj rreth tatimit në paga	16
	Çfarë kuptojmë me të ardhura nga aktivitetet afariste?	25
	Çfarë përfshijnë të ardhurat nga qëraja?.....	25
	Çfarë përfshijnë të ardhurat nga pasuria e paprekshme?.....	26
	Çfarë përfshijnë të ardhurat nga interesi ?	26
	Çfarë përfshijnë të ardhurat nga dividendi?	26
	Çfarë përfshijnë të ardhurat nga fitimet në kapital?	26
	Të ardhurat nga lojërat e fatit	26
	Pyetje - Përgjigje - Shembuj	28
<input type="checkbox"/>	TATIMI NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE	
	Hyrje	51
	Pyetje dhe përgjigje mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.....	52
	Shembuj mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.....	61
	Sqarimet për llogaritjen e ndëshkimeve dhe interesave për pagesë të pamjaftueshme të tatim në fitim për periudhën tatimore 2004.....	79
<input type="checkbox"/>	TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR	
	Funksionimi dhe zbatimi i TVSH-së në Kosovë	85
	Pyetje - Përgjigje - Shembuj	86
<input type="checkbox"/>	RIMBURSIMI - RIKTHIMI SI PJESË E LEGJISLACIONIT	
	Pyetje - Përgjigje - Shembuj	97
<input type="checkbox"/>	KONTROLI TATIMOR	
	Roli dhe rëndësia e kontrollit tatimor	107
	Parimet themelore të kontrollit tatimor.....	107
	Vetë - Vlerësimi	108
	Vlerësimi i Organeve tatimore	108
	Procesi i kontrollit tatimor	109
	Planifikimi i kontrollit tatimor... ..	111
	Ekzekutimi i kontrollit tatimor	112
	Formimi i gjykimit.....	113
	Raportimi	115
	Krijimi i dosjes	118
	Shembull.....	118
<input type="checkbox"/>	Mbledhja dhe përmbushja e obligimeve	
	Mbledhja dhe përmbushja e obligimeve	129
	Zgjidhja e problemeve të mbledhjes së detyrimeve	129
	Vendosja e barrës mbi pasuritë e tatimpaguesëve	130
	Urdhër-vjelja e pasurisë	131
	Urdhër-vjelja mbi pasuritë e tatimpaguesëve që gjenden të palët e treta	131
	Shpallja e tatimit në rrezik	131
	Njoftim i Autoriteteve Doganore për ndaljen e importeve dhe eksporteve	132
	Procedurat e shitjes	133

PARATHËNIE

Administrata Tatimore e Kosovës është i vetmi Autoritet që administron tatimet, nxjerrë rregulla të përgjithshme administrative të cilat janë të detyrueshme të zbatohen si për Administratën Tatimore, ashtu dhe për Tatimpaguesit. ATK siguron një zbatim uniform të ligjeve dhe të rregulloreve që kanë të bëjnë me tatimet. Me anë të këtyre ligjeve janë përcaktuar përgjegjësitë e Administratës Tatimore të Kosovës. Këto përgjegjësi kanë të bëjnë me administrimin e tatimeve në nivel qeveritar, siq janë: TVSH në afarizmin vendor, Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimin në të Ardhurat e Koorparatave dhe Kontributet Pensionale.

Misioni i Administratës Tatimore të Kosovës është “ **Ngritja në maksimum e përmbushjes vullnetare, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, të ofrojë shërbim profesional, transparent dhe të efektshëm për Tatimpaguesit** ”.

Departamenti i Përmbushjes, jep mbështetje të fuqishme arritjes së këtij misioni. Ky Departament ka obligim që të sigurojë mbështetjen më të mire, më efikase, më të plotë dhe në kohë, për kryerjen e funksionit të edukimit të tatimpaguesëve, kontrollit të tatimpaguesëve, mbledhjes së detyrueshme, inkasimit të kontributeve pensionale, përcaktimit të rrezikut të zhvillimit të aktiviteteve tek tatimpaguesit, në përputhje me ligjin 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe në pajtim me të gjitha rregulloret e aplikueshme për tatimet në Kosovë dhe urdhëresat administrative mbi tatimet.

Secila rregullore, për mënyrën e zbatimit më të lehtë, ka udhëzimet sqaruese. Ndryshimet dhe plotësimet e shpeshta të legjislacionit tatimor në Kosovë dhe zgjerimi i skemës tatimore, krijon mundësi të përafritimit me praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën fiskale.

Me qëllim të realizimit të misionit të ATK-së, Departamenti i Përmbushjes, ka përgatitur librin “ **DORACAK MBI TATIMET NË KOSOVË** “, i pari i këtij lloji në Kosovë. Është i thjeshtë, gjithëpërfshirës dhe sqarues për gjitha llojet e tatimeve që zbatohen në Kosovë.

Qëllimi i këtij libri është që, në mënyrë të përmbledhur, në një tekst të vetëm, të ofrojë njohuri themelore për obligimet e tatimpaguesëve, varësisht nga statusi i tyre në zhvillimin e afarizmit, prej të cilit lindin obligimet tatimore.

Prishtinë , Janar 2007

Sakip Imeri , zv/drejtor i ATK-së

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME PËR BIZNESET DHE TATIMET NË KOSOVË

Personat, të cilët pretendojnë për t'u marrë me aktivitet ekonomik në Kosovë, duhet të regjistrojnë një biznes apo degë të biznesit në Zyrën e regjistrimit të bizneseve, bazuar në Rregulloren Nr. 2001/6, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 2002/22

Objekt i kësaj rregulloreje është krijimi i mundësive për themelimin e rregullt të shoqërive tregtare fitimprurëse në Kosovë; caktimi i pronësisë, përgjegjësia dhe kompetencat për të vendosë lidhur me to; mënyrat, mjetet dhe procedurat për organizimin, strukturën dhe administrimin e tyre; mënyrat, mjetet dhe procedurat për përfundimin dhe likuidimin e tyre; të drejtat dhe detyrimet që u takojnë; dhënia e kompetencave dhe autorizimeve personave përgjegjës dhe organeve përkatëse (dhe pasuesëve të tyre) për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje. Kjo rregullore rregullon vetëm shoqëritë tregtare fitimprurëse.

Vendi për të marrë certifikatën e regjistrimit, për të zhvilluar aktivitet ekonomik, është zyra për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë

Cilat janë tipet e bizneseve që mund të krijohen në Kosovë ?

Tipet e bizneseve (shoqërive tregtare) në Kosovë mund të jenë:

- *Ortakëritë e përgjithshme*
- *Ortakëritë e kufizuara*
- *Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar*
- *Shoqëritë aksionare*
- *Njësitë e përhershme të përsoneve jo-rezident*
- *Ndërmarrjet personale, apo bizneset individuale*

Cilat janë tatimet mbi bizneset ?

Për bizneset, ekzistojnë një numër i tatimeve që duhet të zbatohen, varësisht nga lloji i entitetit të biznesit apo statusit, dhe qarkullimit vjetor të biznesit. Tatimet e zbatuara në Kosovë nga 01.01.2005, që administrohen nga Administrata Tatimore janë:

1. Tatimi në të ardhurat e korporatave
2. Tatimi në të ardhurat personale.
3. Tatimi mbi vlerën e shtuar (tatim mbi konsumin)

Administrata Tatimore e Kosovës është agjencion i autorizuar i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për mbledhjen e kontributeve pensionale, bazuar në Rregulloren Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë.

Kush janë obliguesit e Tatimit në të ardhurat e korporatave ?

Që nga 1 Janari 2005 Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 “Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave”) aplikohet mbi:

- Organizatat biznesore korporata (ku janë entitetet juridike jo-individuale, Sh. p. K., Sh. a.),
- Njësitë e përhershme të personave jo-rezidentë,
- Ndërmarrjet Publike
- Ndërmarrjet Shoqërore
- Organizatat joqeveritare (OJQ)

Kush janë obliguesit e Tatimit në të Ardhurat Personale ?

Deri më 31 Dhjetor 2004, tatimi në të ardhurat personale në Kosovë është aplikuar vetëm në të ardhurat personale nga pagat.

Nga 1 Janari 2005, Kosova, tash, ka një tatim gjithëpërfshirës në të ardhura (sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/52 “Mbi Tatimin në të Ardhura Personale”).

Tatimi në të ardhurat personale aplikohet mbi të gjithë individët, përfshirë ortakët jo-korporata të ortakërive, të cilët do të taten mbi hisen e tyre të të ardhurave nga ortakëria. Aplikohet mbi pagat, të ardhurat nga biznesi dhe qiraja, të realizuara nga individët (e që më herët kanë qenë të mbuluara nga Tatimi i Paragjykuar), interesi, dividendet, të ardhurat nga pasuria e patrupëzuar, fitoret në lotari dhe anuitetet pensionale, (fitimet/humbjet kapitale të individëve do të fillojnë të taten prej vitit 2010).

Tatimi në paga mbahet në burim dhe transferohet çdo muaj nga punëdhënësit.

Tatimi në interes, dividend dhe fitoret në lotari paguhet çdo muaj duke mbajtur në burim 20% të tatimeve me rastin e pagesës të atyre të ardhurave, nëse pagesit e këtyre të ardhura janë persona juridikë.

Po ashtu, edhe pagesit e qirasë, për marrjen e objekteve në shfrytëzim, nëse janë persona juridikë, duhet të ndalin 16% tatim në burim nga pagesa, dhe për çdo muaj ta transferojnë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Tatimi në të ardhurat nga biznesi, qiraja dhe të ardhurat nga pasuria e patrupëzuar, paguhet çdo tre-muaj (përveç atyre që u është mbajtur saktë tatimi në burim).

Shkallëzimet e të ardhurave tatimore me 0%, 5%, 10% dhe 20% të grupimeve të të ardhurave personale janë:

Të ardhurat mujore nga pagat	Tatimi
Deri 80 €	0%
80.01€– 250 €	5%
250.01€– 450 €	10%
Mbi 450 €	20%

Të ardhurat personale vjetore nga pagat dhe aktiviteti ekonomik	Tatimi
Deri 960 €	0%
960.01€– 3,000 €	5%
3,000.01€– 5,400 €	10%
Mbi 5,400 €	20%

Çka është Tatimi në Vlerën e Shtuar ?

Tatimi në vlerën e shtuar (TVSh) ka filluar të aplikohet në importe dhe furnizimet vendore të mallrave dhe shërbimeve që nga 1 Korriku 2001 (sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/11 “Mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar” e cila u ndryshua me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/17 dhe 2004/35).

Aplikohet me shkallën prej 15% dhe me shkallën zero (0%)

Subjektet të cilat duhet të regjistrohen si persona të tatuar, janë personat me qarkullim vjetor mbi 50,000 € (dhe ata të cilët janë nën pragun, por të cilët zgjedhin të jenë deklarues të TVSh-së) e aplikojnë dhe vjelin TVSH-në e llogaritur nga blerësit apo konsumatorët e tyre dhe marrin një kreditim të tatimit të zbritshëm për TVSH-në e paguar në importet dhe blerjet vendore të tyre.

Formularët e deklarimit të TVSH-së kërkohet të plotësohen çdo muaj. Aty ku tatimi i zbritshëm i TVSH-së së kërkuar tejkalon tatimin e llogaritur të TVSH-së së vjelur, personi i tatuar do të ketë të drejtën për kreditim të TVSH-së.

Çfarë nënkuptojmë me Deklaratë Tatimore ?

Parimet e tatimeve në Kosovë janë të mbështetura mbi vetëdeklarimin e të ardhurave nga ana e Tatimpaguesit. Pra, tatimpaguesi duhet t'i vetëdeklarojë të gjitha të ardhurat e tij, duke plotësuar deklaratën e tij tatimore në kohën e caktuar, varësisht nga lloji i të ardhurave që i deklaron .

Çdo person që i nënshtrohet tatimit, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë, duhet të dorëzojë në ATK ose tek agjenti i saj, një deklaratë të plotësuar sipas kërkesave të Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat (Ligji Nr. 2004/48).

Cilat janë deklaratat tatimore ?

1. Deklarata e Tatimit në të Ardhurat Personale,
2. Deklarata e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave,
3. Deklarata e TVSH-së dhe
4. Deklarata e Kontributeve Pensionale

Ligjet tatimore e obligojnë ATK-në që, nëse konstaton se tatimpaguesi ka dështuar ta dorëzojë deklaratën tatimore, apo me rastin e dorëzimit i ka nëndeklaruar, apo mbideklaruar të ardhurat e tij, ta bëjë një vlerësim tatimor. Në këto raste, ATK-ja përmes kontrollit, ka të drejtë ta bëjë një vlerësim tatimor.

TATIMI MBI TË
ARDHURAT PERSONALE

ÇKA ËSHTË TATIMI NË TË ARDHURA PERSONALE DHE CILAT BURIME TË TË HYRAVE I PËRFSHINË?

Tatimi në të ardhura personale, i cili ka hy në fuqi më 1 prill të vitit 2002, ka tatuar vetëm pagat. Që nga 1 janari i vitit 2005, është tatim më gjithëpërfshirës dhe tatimon edhe burime tjera të të ardhurave me sa vijon:

- Pagat
- të ardhurat nga aktivitetet biznesore,
- të ardhurat nga qiraja,
- lojërat e fatit,
- dividendet,
- interesin,
- fitimet kapitale, dhe
- çdo të ardhur tjetër që rritë pasurinë neto të tatimpaguesit.

Kush është tatimpaguesi i tatimit në të ardhurave personale si dhe çka është objekt i tatimit ?

Sipas Rregullores mbi TAP Nr. 2004/52, tatimpagues janë personat fizikë, banorë (rezidentë) dhe jobanorë (jorezidentë) të Kosovës të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura bruto.

Objekt i tatimit për tatimpaguesin banor (rezident) janë të ardhurat e krijuara në Kosovë dhe burimi i të ardhurave nga jashtë.

Objekti i tatimit për tatimpaguesin jo-banor (jo-rezident) janë të ardhurat e tatueshme nga të ardhurat që e kanë burimin në Kosovë.

PYETJE – PËRGJIGJE DHE SHEMBUJ RRETH TATIMIT NË TË ARDHURAT NGA PAGAT

1. Cilat janë të Ardhurat Bruto nga Pagat?

Përgjigje:

- Të ardhurat bruto, sipas Rregullores Nr. 2004/52 “Mbi të Ardhurat Personale në Kosovë”, përfshijnë të gjitha të ardhurat e marra ose akruara në formën e pagave gjatë periudhës tatimore;
- Të ardhura bruto nga pagat përfshijnë por nuk do të limitohen në: Rrogat e paguara nga ose në emër të punëdhënësit për punën e bërë nga i punësuarit sipas udhëzimeve të punëdhënësit;
- Bonuset, komisionet, dhe forma të tjera kompensimi që një punëdhënësi, ose dikush tjetër në emër të punëdhënësit, i paguan të punësuarit mbi rrogën;
- Të ardhurat e fituara sipas kontratave për punë të përkohshme;
- Pensionet dhe të ardhura të tjera të paguara nga punëdhënësi i mëparshëm ose nga qeveria;
- Të ardhurat nga një punësim i ardhshëm, si p.sh një bonus për nënshkrimin e kontratës;
- Premi sigurimi që punëdhënësi paguan për një të punësuar;
- Faljen e borxhit ose obligimit të punësuarit ndaj punëdhënësit;
- Pagesën e shpenzimeve personale të të punësuarit; dhe benefitet në natyrë që një punëdhënësi i jep të punësuarit, e cila tejkalon shumën minimale të specifikuar në udhëzimin administrativ.

2. Kush është i obliguar të paguaj Tatimin në të Ardhurat Personale nga pagat ?

Përgjigje: Të gjithë individët, rezidentë dhe jorezidentë, që fitojnë të ardhura nga pagat në Kosovë do të konsiderohen të punësuar dhe janë të obliguar të paguajnë tatim në të ardhurat personale nga pagat, përveç të punësuarëve të huaj në trupat e përcaktuara në Nenin 7 të Rregullorës Nr. 2004/52 ‘Mbi Tatimin në të Ardhurat Personale në Kosovë.

3. Çfarë hapash duhet ndërmarrë në fillim të punësimit?

Përgjigje: Secili i punësuar, pavarësisht a punon për një apo më tepër punëdhënësi, obligohet të caktojë punëdhënësin kryesor, duke plotësuar formularin për caktimin e punëdhënësit kryesor brenda 15 ditëve nga dita e fillimit të punës. Këtë formular duhet ta dorëzojë në Zyren e Shërbimit të Tatimpaguesëve në Administratën Tatimore të Kosovës. Punëdhënësit të cilët nuk janë të zgjedhur si punëdhënësi kryesor nga i punësuarit i tyre, do të trajtohen si punëdhënësi sekondarë për çështjet tatimore.

a) **Punëdhënësit kryesorë** duhet të llogarisin (për çdo muaj të mbajnë në burim) dhe të paguajnë tatimin sipas grupimeve të pagave dhe shkallëve tatimore të dhëna në tabelën në vijim:

Grupimet e të ardhurave mujore nga pagat dhe shkallët tatimore	
0 € - 80 €	0 %
80 € - 250 €	5 %
250 € - 450 €	10 %
Mbi 450 €	20 %

b) **Punëdhënësit sekondarë** duhet ta llogarisin (për çdo muaj të mbajnë në burim) dhe të paguajnë tatimin, vetëm me shkallën maksimale 20%.

4. Kush është i obliguar të kontribuojë për kursimet pensionale?

Përgjigje: Prej 1 Gushti 2003, të gjithë punëtorët, që janë banorë të përhershëm të Kosovës, janë të obliguar t'i paguajnë kontributet për kursimet pensionale.

Gjithashtu edhe punëdhënësit, janë të obliguar që për të punësuarit e tyre rezidentë, të paguajnë një shumë të caktuar të kontributeve pensionale. (Rregullorja Nr. 2001/35” Mbi Kontributet Pensionale në Kosovë).

Programi i kursimeve pensionale mbulon të gjithë punëtorët vendorë në Kosovë.

5. Sa është obligimi për të kontribuar për kursime pensionale?

Përgjigje: Punëdhënësi (si ai primar ashtu edhe ai sekondar) duhet të kontribuojë 5% në pagën bruto të punëtorit në emër të punëtorit. Njëkohësisht, punëdhënësi duhet të ndalë në burim edhe 5% nga paga bruto e punëtorit, dhe t'i paguajë ato menjëherë në formë të kontributeve pensionale. Që të dy, si punëdhënësi ashtu edhe punëtori, mund të ngrisin vullnetarisht shumën e kontributit edhe për 10%. Kontributi i kombinuar, pra, përqindja e punëtorit dhe punëdhënësit, nuk mund të jetë më e vogël se 10%, por as më e madhe se 30%. Vetëm kontributi i të punësuarit do të jetë i zbritshëm për qëllime tatimore nga paga e tij / saj. Ndërsa kontributi i punëdhënësit do të jetë shpenzim i zbritshëm për qëllime tatimore të punëdhënësit.

6. Si bëhet llogaritja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga pagat ?

Përgjigje: - Se si bëhet llogaritja e Kontributeve Pensionale dhe Tatimit në të Ardhurat Personale, më konkretisht do të njoftoheni nga shembujt në vijim.

SHEMBULLI 1:

Një i punësuar punon vetëm të një punëdhënës, dhe ate e ka zgjedhur si punëdhënës kryesor duke plotësuar dhe dorëzuar formularin adekuat, për caktimin e punëdhënësit kryesor në Administratën Tatimore të Kosovës.

Supozojmë se:

Paga mujore e tij është	450 €
Shpenzimet e rrugës(personale)	22 €
Shpenzimet për ushqim	66 €
Të ardhurat mujore bruto	538 €

Llogaritja mujore e Kontributeve për Kursime Pensionale dhe Tatimit në të Ardhurat Personale është si më poshtë:

Të ardhurat e tatuara = Të Ardhurat bruto - zbritjet e lejueshme

$$538 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributet e punëdhënësit)} = 26.90 \text{ €}$$

$$538 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributet e të punësuarit)} = 26.90 \text{ €}$$

$$538 \text{ €} \text{ (Të Ardhurat bruto)} - 26.90 \text{ €} \text{ (Kontributet e të punësuarit)} = 511.10 \text{ €}$$

511.10 € Të ardhurat e tatuara

$$0 \text{ €} - 80 \text{ €} = 80 \text{ €} \times 0\% = 0.00 \text{ €}$$

$$80 \text{ €} - 250 \text{ €} = 170 \text{ €} \times 5\% = 8.50 \text{ €}$$

$$250 \text{ €} - 450 \text{ €} = 200 \text{ €} \times 10\% = 20.00 \text{ €}$$

$$450 \text{ €} - 511.10 \text{ €} = 61.10 \text{ €} \times 20\% = 12.22 \text{ €}$$

Totali i tatimit mujor: = 40.72 €

Llogaritja vjetore e kontributeve për kursim pensional dhe tatimit në të Ardhurat personale nga pagat, është si më poshtë:

Supozohet se paga mujore gjatë vitit është e njëjtë.

$$\text{Të ardhurat mujore bruto } 538 \text{ €} \times 12 \text{ (muaj)} = 6456 \text{ € Ardh/bruto vjetore}$$

$$6,456 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributi i të punësuarit)} = 322.80 \text{ €}$$

Të ardhurat e tatuara = Të Ardhurat bruto – zbritjet e lejueshme

$$6,456 - 322.80 = 6,133.20 \text{ €}$$

0 € – 960 €	=	960 €	x	0%	=	0.00 €
960 € – 3,000 €	=	2,040 €	x	5%	=	102.00 €
3,000 € – 5,400 €	=	2,400 €	x	10%	=	240.00 €
5,400 € – 6,133.20 €	=	733.20 €	x	20%	=	146.64 €
Totali i obligimit tatimor vjetor						= 488.64 €

SHEMBULLI 2:

Një i punësuar punon për dy punëdhënës. Njërin prej tyre e ka zgjedhur punëdhënës kryesor, ndërsa tjetri trajtohet si punëdhënës sekondar.

Të punëdhënësi që e ka zgjedhur si punëdhënës kryesor, paga e tij mujore ka qenë 300 €, kurse tek punëdhënësi sekondar 100 €

Llogaritja mujore e Kontributeve për Kursim Pensional dhe Tatimit në të Ardhurat Personale nga punëdhënësi kryesor është:

$$300 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributet e punëdhënësit)} = 15 \text{ €}$$

$$300 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributet e të punësuarit)} = 15 \text{ €}$$

Të ardhurat e tatuara = Të Ardhurat bruto – zbritjet e lejueshme

$$300 \text{ €} - 15 \text{ € (kontributi i të punësuarit)} = 285 \text{ €}$$

$$0 \text{ €} - 80 \text{ €} = 80 \text{ €} \times 0\% = 0.00 \text{ €}$$

$$80 \text{ €} - 250 \text{ €} = 170 \text{ €} \times 5\% = 8.50 \text{ €}$$

$$250 \text{ €} - 285 \text{ €} = 35 \text{ €} \times 10\% = 3.50 \text{ €}$$

$$\text{Totali i tatimit mujor} = 12.00 \text{ €}$$

Llogaritja mujore e kontributeve për kursim pensional dhe tatimit në të ardhurat personale nga punëdhënësi sekondar është:

$$100 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributi i punëdhënësit)} = 5 \text{ €}$$

$$100 \text{ €} \times 5\% \text{ (Kontributi i të punësuarit)} = 5 \text{ €}$$

Të ardhurat e tatuara = Të Ardhurat bruto – zbritjet e lejueshme

$$100 \text{ € Ardh/bruto} - 5 \text{ € (kontributi i të punësuarit)} = 95 \text{ € Ardh/Tatueshme}$$

$$95 \text{ € Ardh/tatueshme} \times 20\% = 19 \text{ € totali i tatimit mujor}$$

Llogaritja vjetore e kontributit për kursime pensionale dhe tatimit në të Ardhurat Personale në fund të vitit është si më poshtë:

$$\text{Të ardhurat bruto nga punëdhënësi kryesor} \quad 300 \text{ €} \times 12 \text{ muaj} = 3600 \text{ €}$$

$$\text{Të ardhurat bruto nga punëdhënësi sekondar} \quad 100 \text{ €} \times 12 \text{ muaj} = 1200 \text{ €}$$

Të ardhurat vjetore bruto $400 \text{ €} \times 12 \text{ muaj} = 4800 \text{ €}$

$4,800 \text{ €} \times 5\%$ kontributet e të punësuarit = 240 €
 $4,800 \text{ €} - 240 \text{ €} = 4,560 \text{ €}$

$4,800 \text{ €} - 240 \text{ €}$ (kontributet e të punësuarit) = $4,560 \text{ €}$

Të Ardhurat e tatuara = $4,560 \text{ €}$

$0 \text{ €} - 960 \text{ €} = 960 \text{ €} \times 0\% = 0,00 \text{ €}$

$960 \text{ €} - 3,000 \text{ €} = 2,040 \text{ €} \times 5\% = 102,00 \text{ €}$

$3,000 \text{ €} - 4,560 \text{ €} = 1,560 \text{ €} \times 10\% = 156,00 \text{ €}$

Totali: = $258,00 \text{ €}$

Nga llogaritja mujore, shihet se ky i punësuar të punëdhënësi, që e ka zgjedhur punëdhënësi kryesor, ka paguar 180 € kontribute, po ashtu 180 € ($15 \text{ €} \times 12 \text{ muaj}$) ka paguar punëdhënësi i tij, si dhe 144 € ($12 \text{ €} \times 12 \text{ muaj}$) i është mbajtur tatimi në burim.

Të punëdhënësi sekondar i punësuar ka kontribuar 60 € ($5 \text{ €} \times 12 \text{ muaj}$), kurse tatimi i është mbajtur në burim në vlerë prej 228 € ($19 \text{ €} \times 12 \text{ muaj}$).

Tatimi i mbajtur në burim gjatë periudhës tatimore 372 €

Obligimi tatimore për të ardhurat vjetore nga pagat 258 €

114 € (Parapagim)

Në këtë rast i punësuar është obligues për të dorëzuar deklaratën tatimore dhe ka mundësi që parapagimin prej 114 € ta rimbursojë, ose ta ketë si parapagim për ndonjë këst në të ardhmen.

SHEMBULLI 3:

Një i punësuar, gjatë vitit ka punuar vetëm dy muaj të një punëdhënësi i cili prej tij është zgjedhur punëdhënësi kryesor. Paga mujore e tij ka qenë 450 €, dhe gjatë vitit nuk ka realizuar të ardhura tjera individuale.

Llogaritja mujore e kontributit për kursim pensional dhe tatimit në të ardhurat personale nga pagat është si vijon:

$450 \text{ €} \times 5\%$ (Kontributet e punëdhënësit) = $22,50 \text{ €}$

$450 \text{ €} \times 5\%$ (Kontributet e të punësuarit) = $22,50 \text{ €}$

Të ardhurat e tatuara = Të Ardhurat bruto – zbritjet e lejueshme

$450 \text{ € Ar/Bruto} - 22,50 \text{ € Kontributet e të punësuarit} = 427,50 \text{ €}$ të Ar/e tatuara

$0 \text{ €} - 80 \text{ €} = 80 \text{ €} \times 0\% = 0,00 \text{ €}$

$80 \text{ €} - 250 \text{ €} = 170 \text{ €} \times 5\% = 8,50 \text{ €}$

$250 \text{ €} - 427,5 \text{ €} = 177,5 \text{ €} \times 10\% = 17,75 \text{ €}$

Totali i tatimit mujor: = $26,25 \text{ €}$

26.25 € x 2 muaj = 52.50 € (Totali i tatimit të mbajtur në burim gjatë periudhës tatimore)

Llogaritja vjetore e kontributit për kursim pensional dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat është si në vijim:

Të ardhurat bruto 450 € x 2 (muaj) = 900 €
900 € x 5% (kontributi i të punësuarit) = 45 €

900 € - 45 € = 855 €
0 € - 855 € = 855 € x 0% = 0 €

Në këtë rast i punësuarit duhet të deklarojë deri më 1 Prill të vitit vijues dhe ka të drejtën e rimbursimit të tatimit për shumën prej 52.50 €

7. Si bëhet pagesa e tatimit në të ardhurat personale nga pagat ?

Përgjigje: Punëdhënësi duhet ta plotësojë formularin “Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagimit të tatimit”, atë formular duhet ta dorëzojë në njërën nga bankat komerciale të Kosovës dhe ta bëjë pagesën e tatimit më ose para datës 15 të muajit që pason në muajin në të cilin janë dhënë pagat.

Po ashtu, punëdhënësi duhet ta ketë numrin e regjistrimit të biznesit me anën e të cilit e bënë pagesën e tatimit në të ardhurat personale.

8. Ku dhe si duhet t’i paguajë kontributet pensionale?

Përgjigje: Në fund të çdo muaji, punëdhënësi duhet të plotësojë formularin “Pasqyra e Kontributeve për pension dhe formulari i pagesës” dhe ta dorëzojë atë në njërën prej bankave komerciale të licencuara në Kosovë. Ky formular mund të merret në të gjitha zyrat regjionale të Administratës Tatimore të Kosovës si në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj dhe në vetë bankat komerciale të Kosovës. Afati i fundit për të bërë pagesën është data 15 e muajit vijues.

9. Cila është procedura e raportimit të kontributeve?

Përgjigje: Si pagesa, ashtu edhe raportimi i kontributeve të paguara janë përgjegjësi e punëdhënësit. I punësuarit duhet të ndihmojë punëdhënësin vetëm duke dhënë numrin e tij/saj të saktë të letërnjoftimit.

Raportimi mund të bëhet në dy mënyra: mujor dhe tremujor.

- **Raportimi tremujor** bëhet duke dorëzuar në ATK “Formularin e kontributeve të mbajtura në burim dhe të paguara” duke i bashkangjitur përmbledhjen e listës së pagave. Ky raport duhet të dorëzohet deri me datën 15 të muajit pas përfundimit të tremujorit.
- **Raporti mujor** elektronik bëhet ashtu që punëdhënësi dërgon listën e pagave në format elektronike në TKPK, personalisht apo përmes internetit. Pastaj, punëdhënësi do të merr formularin e deklarimit mujor të gjeneruar, për të bërë pagesën e kontributeve pensionale. TKPK, pastaj, çdo tremujor i raporton ATK-së, në emër të punëdhënësit.

10. Si mund të refundohen mjetet për personat jo-rezidentë apo për personat të cilët kanë bërë gabim gjatë pagesës?

Përgjigje: Në rastet kur punëdhënësi ka bërë pagesë në emër të personave jo-rezidentë apo është bërë gabim në shumën e pagesës, atëherë duhet të plotësohet “Kërkesë për Refundim të Kontributeve Pensionale” dhe me këto forma, kontribuuesit, mund të pajisen në të gjitha zyrat regjionale të ATK dhe në zyrën qendrore të TKPK-së. Formulari për refundim ka dy mundësi: Refundimi bankar dhe Transfer i pagesës për periudhë tjetër të obligimeve. Në rast të refundimit bankar kontribuuesit duhet të kenë këto dokumente:

1. Kërkesa e Refundimit e plotësuar dhe e detalizuar për periudhat për të cilat kërkohet refundimi / transferi
2. Fotokopjet e Pasqyrave të kontributeve për pension dhe formulari i pagesës, fotokopjet e Raportit tremujor për kontributet e mbajtura në burim të paguara dhe lista e punëtorëve
3. Një dokument zyrtar nga banka që dëshmon se personi në fjalë disponon me numrin e llogarisë të cilin kontribuuesi e ka paraqitur në kërkesën e refundimit
4. Një letër sqaruese lidhur me natyrën e refundimit
5. Korrigjimin e Pasqyrave të kontributeve për pension dhe formulari i pagesës, korrigjimin e Raportit tremujor për kontributet e mbajtura në burim të paguara dhe lista e punëtorëve.

Kërkesa duhet t’i dorëzohet Inspektorit tatimor i cili e mbikëqyrë biznesin, kurse në raste të transferimit në periudha të tjera obliguese, prapë duhet të kontaktohet Inspektori tatimor.

11. Çka duhet vepruar nëse kuptoni se raporti tremujor nuk është proceduar?

Përgjigje: Nëse për çfarëdo arsye nuk është proceduar raporti tremujor i pensioneve, atëherë duhet të vizitohet zyra regjionale e ATK-së dhe së bashku me kopjet e raportit të diskutueshëm të verifikohet me zyrtarët pensionalë si dhe të përmirësohen gabimet e mundshme. Gabimet më të shpeshta janë të numrat e letërnjoftimit të cilët duhet të jenë 10 shifror dhe të saktë.

12. Cilat janë obligimet e punëdhënësit?

Përgjigje: Punëdhënësi për qëllime të Tatimit mbi të Ardhurat Personale është i obliguar që të mbajë librat dhe regjistrimet e mëposhtme:

- a) Një libër-pagash mujore;
- b) Një listë-pagese mujore;
- c) Një listë-pagese vjetore

Po ashtu duhet:

- d) Të dorëzojë pasqyrën përmbledhëse tatimore vjetore në ATK, së bashku me listë-pagesat vjetore.
- e) Të pajisë të punësuarit e tij me “Certifikatë të Kontributit pensional dhe Mbajtjes në Burim të Tatimit” deri më 1 Mars të vitit që pason periudhën tatimore.

13. Cilat janë obligimet e të punësuarit ?

Përgjigje: Çdo i punësuar duhet:

- Të ketë numrin personal të UNMIK-ut me anën e të cilit e bënë pagesën e tatimit në të ardhurat personale. Numrin personal tatimor të përkohshëm, mund ta marrin edhe në zyrat regjionale të ATK-së, nëse nuk posedon ID të UNMIK-ut.
- Duhet që, brenda 15 dite pasi të fillojë të punojë, ta informojë ATK-ën, se cili është punëdhënësi kryesor i tij. Informimi bëhet duke plotësuar formën “Caktimi i punëdhënësit Kryesor”. Kjo formë mund të merret në të gjitha zyrat regjionale.
- Deri më 1 prill të vitit pasues duhet ta plotësojë dhe dorëzojë formën ”Formular i deklaramentit dhe pagesës për tatimin në të ardhurat personale”. Në rastet kur punëdhënësi i tij nuk ka qenë i obliguar ta mbajë tatimin në burim, ose me kusht që duhet të paguajë tatimin shtesë apo të kërkojë rimbursimin e tatimit të paguar më tepër.
- Pra, në këto raste i punësuar duhet të deklarojë të ardhurat e tërësishme të realizuara nga pagat përmes formës deklarata përfundimtare e tatimit në të ardhurat personale që do ta paraqesim në vijim:

14. Ku shkojnë mjetet e kursimeve pensionale?

Përgjigje: Mjetet e Trustit të kursimeve pensionale të Kosovës investohen në të mirë të kontribuesëve. I tërë përfitimi i cili fitohet nga investimi i mjeteve u shpërndahet më pas të gjithë kontribuesëve në mënyrë proporcionale, pra në bazë të përqindjes që mjetet e individit përbëjnë gjithsejt mjetet e investuara.

15. Sa janë të sigurta mjetet e kontributeve pensionale?

Përgjigje: Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës është institucion i pavarur financiar, i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Autoriteti i bankave dhe pagesave të Kosovës.

Të gjitha transaksionet që i bën Trusti, kontrollohen nga organi i lartpërmendur. Njëkohësisht të gjitha institucionet financiare ndërkombëtare me të cilat bashkëpunon TKPK, u nënshtrohen rregullatorëve bankarë dhe financiarë të shteteve ku ato afardojnë.

Në mënyrë që të shtohet siguria e mjeteve, TKPK është i detyruar me Rregulloren Nr. 2001/35, që gjatë investimit të mjeteve, asnjëherë të mos ikin prej kritereve për investime të dobishme të përcaktuara nga kjo rregullore.

Mjetet për pensionet e ardhshme të kosovarëve, si rrjedhojë, investohen në tregje të sigurta të kapitalit, dhe atë vetëm në ato instrumente investuese, të cilat kanë dëshmuar stabilitet jetëgjatë në treg.

Një aspekt tjetër i sigurisë së këtyre mjeteve është edhe shpërndarja. Ato, gjatë investimit, shpërndahen nëpër një spektër të gjërë instrumentesh të ndryshme, gjithnjë duke i pasur parasysh rregullat e lartshënuara, kështu që, nuk mbahen të gjitha në një vend.

16. Si do të merret pensioni nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës?

Përgjigje: Të drejtën në pension do ta ketë secili person që ka kontribuar në Trust dhe që ka arritur moshën 65 vjeçare (moshën e pensionimit të caktuar me ligj), përveç në rastet e jashtëzakonshme siç janë vdekja e kontribuuesit apo invaliditeti i tij/saj.

Me arritjen e moshës së pensionimit, kontribuuesi duhet që vet ta zgjedh kompaninë e sigurimeve, me të cilën do të nënshkruajë kontratë për blerjen e anuitetit (konvertimin e shumës së parave të grumbulluara në këste mujore).

Për më tepër shih Nenin 12.5 të Rregullores Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë.

17. Si do të llogaritet pensioni?

Përgjigje: Shuma e kontributeve plus përqindja e kthimit nga investimet, e cila zbatohet në formë të kamatës, do të paraqet shumën e përgjithshme të grumbulluar në llogarinë individuale në Trust.

18. Si do të marr pensionin nga TKPK?

Përgjigje: Çdo individ i cili ka kontribuar në TKPK dhe ka arritur moshën 65 vjeçare (moshën e pensionimit të caktuar me ligj), ka të drejtë për përfitimin pensional. Në moshën 65 vjeçare, shuma e parave në llogarinë individuale në TKPK konvertohet në pagesë mujore duke blerë anuitet nga ndonjë kompani sigurimesh. Nëse shuma në llogari nuk është e mjaftueshme për të blerë anuitet, ajo shumë do të paguhet si total përnjëherë. Ekzistojnë dy raste kur kursimet pensionale mund të merren para moshës 65 vjeçare: nëse individ vdes, atëherë trashëgimtari i tij e gëzon të drejtën e shfrytëzimit, ose kur ai/ajo bëhet invalid i përherëshëm. Për më shumë detaje ju lutem të shikoni Nenin 12.5 të Rregullores Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë.

19. Cilat janë dokumentet e nevojshme për aplikim për përfitim pensional?

Përgjigje: Dokumentet e nevojshëm për aplikim të të moshuarëve janë:

- Letërnjoftimi i aplikuesit (përfituesit)
- Kartela valide e bankës (bashkë me numrin e llogarisë)

Dokumentet e nevojshëm për aplikim për pension në emër të përfituesit të ndjerë janë:

- Certifikata e vdekjes së të ndjerit
- Letërnjoftimi i të ndjerit
- Letërnjoftimi i bashkëshortit/es i cili aplikon
- Çertifikata e kurorëzimit
- Kartela valide bankare e personit i cili aplikon
- Një letër nga punëdhënësi për të treguar vendin ku ka punuar.

20. Ku mund të marr informata lidhur me kontributet pensionale?

Përgjigje: Informatat rreth procedimit, formularët, rregulloret dhe informata tjera janë në web faqen e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës më adresë www.kpst.org, në web faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave www.mfe-ks.org, dhe web faqen e Administratës Tatimore të Kosovës www.atk-ks.org.

Çfarë kuptojmë me të ardhura nga aktivitetet afariste?

Të ardhurat e përgjithshme nga aktivitetet afariste do të thotë të ardhurat e krijuara nga personi fizik i angazhuar në aktivitete të tilla.

Secili tatimpagues i cili realizon të ardhura nga veprimtaritë afariste, paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga Administrata tatimore në një bankë të licencuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).

Shuma për secilën pagesë tremujore të tatimit është me sa vijon:

- a) Tatimpaguesit me 5,000 € apo me pak të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste, paguan 37.5€ për tremujor.
- b) Tatimpaguesit me mbi 5,000€ - 50,000€ të ardhura bruto vjetore nga veprimtaritë afariste :
 - Tre përqind (3%) të ardhurave bruto nga tregtia , transporti , bujqësia dhe veprimtaritë e ngjashme komerciale të çdo tremujori.
 - Pesë përqind (5%) të ardhurave bruto nga shërbimet , veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme të çdo tremujori
- c) Tatimpaguesit me të ardhura bruto vjetore që tejkalojnë 50,000€ nga veprimtaritë afariste:
 - një të katërtën (1/4) e detyrimit tatimor të përgjithshëm për periudhën aktuale tatimore duke u bazuar në të ardhurat e tatueshme të llogaritura apo
 - për periudhën e dytë tatimore dhe ato pasuese, për të cilat tatimpaguesi bën pagesën sipas këtij paragrafi , një të katërtën (1/4) e 110% e detyrimit tatimor të përgjithshëm për periudhën tatimore që i paraprinë periudhës aktuale tatimore

Çfarë përfshijnë të ardhurat nga qiraja?

Të ardhurat bruto nga qiraja përfshijnë:

- a) Të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e pasurisë së patundshme sikurse janë ndërtesat, toka dhe apartamentet.
- b) Të ardhurat e fituara nga dhënia me qira e pajisjeve, automjeteve transportuese dhe llojeve tjera të pasurisë.

Secili tatimpagues që realizon të ardhura nga qiraja paguan, çdo tremujor, tatimin në një llogari bankare. Shuma e secilës pagesë tremujore është 20 % e të ardhurave të tatueshme.

Po të ardhurat nga pasuria e paprekshme ?

Të ardhurat nga pasuria e paprekshme përfshijnë të ardhurat e krijuara nga patentat , të drejtat autoriale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuritë tjera që përbëhen vetëm nga të drejtat dhe që nuk kanë formën fizike.

Secili tatimpagues që realizon të ardhura nga pasuria e paprekshme paguan çdo tremujor tatimin në një llogari bankare. Shuma e secilës pagesë tremujore është 20% e të ardhurave të tatueshme.

Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat bruto nga interesi përfshijnë:

- a) Interesit nga huat e dhëna për personat fizikë apo subjektet (entitetet),
- b) Interesit nga fletobligacionet ose letrat me vlerë, të lëshuara nga autoritetet publike dhe organizatat afariste,
- c) Interesit nga llogaritë (e kursimeve) të cilat sjellin interes, e që mbahen në banka dhe institucione të tjera financiare

Secili autoritet publik, organizatë biznesi, bankë apo institucion tjetër financiar, që bën pagesë të interesit, ndal tatimin në shumën e barabartë me 20% për çdo shumë të paguar apo të kredituar të interesit

Të ardhurat nga dividendet

Të ardhurat bruto nga dividendet përfshijnë dividendet dhe fitimin tjetër të shpërndarë për tatimpaguesin.

Secila organizatë afariste që bën pagesë të dividendeve ndal tatimin në një shumë të barabartë me 20 % të secilës shumë të dividendit të paguar apo kredituar.

Të ardhurat nga fitimet në kapital

Me të ardhurat bruto nga fitimet në kapital nënkuptojmë fitimin që tatimpaguesi realizon nëpërmjet shitjes apo formave të tjera të tjetërsimit të pasurisë kapitale, duke përfshirë pasurinë e patundshme dhe letrat me vlerë.

Të ardhurat nga lojërat e fatit

Secili organizator i lotarisë apo i një loje të fatit ndal tatimin në shumën e barabartë me 20 % nga secila pagesë e fitimit, dorëzon një deklaratë të tatimit të ndaluar dhe e ridërgon shumën e tatimit të ndaluar në një llogari bankare.

Deklaratat tatimore dhe pagesat

Përveç rasteve kur vlejnë nenet 26.2 dhe 26.3 të Rregullores Nr. 2004/52, të gjithë tatimpaguesit duhet të përgatisin një deklaratë tatimore vjetore më 1 prill ose para një prilli të vitit që pason periudhën tatimore. Deklarata bëhet në formularët e paraparë nga Administrata Tatimore dhe përfshinë, mes tjerash, të ardhurat bruto nga të gjitha burimet, zbritjet e lejueshme, të ardhurat e tatueshme dhe tatimin për t'u paguar në përputhje me nenin 5 të Rregullores Nr. 2004/52.

PYETJE –PËRGJIGJE DHE SHEMBUJ PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

1. A zbritet prej të ardhurave vjetore kontributi i pronarit i paguar për vetveten si dhe kontributi i punëdhënësit për të punësuarin, për llogaritjen e tatimit në të ardhurat nga biznesi individual ?

Përgjigje: Nëse biznesi juaj është objekt i tatuarjes reale atëherë kontributi i paguar për punëtorin nga punëdhënësi si dhe kontributi për vetveten si i vetëpunësuar do të zbriten nga e ardhura me rastin e deklarimit vjetor. Kontributi i paguar për vetveten paraqitet në kolonën [23], në deklaratën vjetore, ndërsa kontributi nga punëdhënësi për punëtorin hyn bashkë me shpenzimet tjera në kolonën [21].

P.sh. Nëse kontributi i të vetëpunësuarit për tremujor është 600€(max)x4 tremujorë = **2,400€** në vit, atëherë shuma prej **2,400 €** vendoset në kolonën [23] të deklaratës vjetore, ndërsa kontributi i paguar për punëtorin nga punëdhënësi ka qene **900 €** në vit (pagat bruto gjatë vitit kanë qenë 18,000 €), atëherë shuma **900 €** vendoset në kolonën [21], bashkë me shpenzimet tjera.

2 . Jam punëtor i një ndërmarrjeje shoqërore dhe kam një pagë mujore prej 50 € në muaj. Nga paga ime a do të ndalen kontributet pensionale dhe tatimi i mbajtur në burim pasi që këtë ndërmarrje e kam punëdhënës kryesor?

Përgjigje: Meqenëse paga juaj është më e vogël se 80€, atëherë nuk jeni bartës i tatimit në burim ndërsa kontributet pensionale paguhet mbi bazën e pagës minimale në Kosovë prej 78€

P.sh. $78 \text{ €} \times 5 \% = 3.9 \text{ €}$ në emër të punëdhënësit dhe
 $78 \text{ €} \times 5 \% = 3.9 \text{ €}$ në emër të të punësuarit

7.8 € gjithsej

3. Jam profesor i gjuhës angleze dhe punoj në një shkollë të mesme, por ndërkohë jam përkthyes edhe i një avokati dhe marr nga 70 € për përkthime. A jam obligues edhe i kontributit pensional apo vetëm i tatimit në paga? Punëdhënësi im(avokati) me ndalë vetëm tatimin në paga ndërsa kontributin pensional jo.

Përgjigje: Po. Nga paga juaj duhet të ndalet kontributi pensional dhe tatimi në paga. Pyetjen tuaj do ta demonstrojmë me këtë shembull:

70 €x 5% = 3.50 €kontributi pensional i paguar nga punëdhënësi
 70 €x 5% = 3.50 €kontributi pensional në emër të punësuarit
 70 €- 3.5€ = **66.50 €** paga e tatueshme
 66.50 €x 20% = **13.30 €** tatimi i mbajtur në burim

4. *Jemi biznes individual me qarkullim mbi 50,000 € në vit dhe qarkullimi gjatë vitit 2005 ka qenë 200,000 €. A pranohet si shpenzim amortizimi i pajisjeve me rastin e deklarimit vjetor?*

Përgjigje: Ju si biznes i madh individual duhet të bëni një deklaratë vjetore deri me 1 prill të vitit pasues (neni 26 , paragrafi 26.1 i Rregullores Nr. 2004/52), në të cilën përfshihen ndër të tjera të ardhurat e realizuara gjatë vitit nga të gjitha burimet si dhe zbritjet e lejueshme. Në këto zbritje përfshihen shpenzimet plotësisht të lejuara dhe ato pjesërisht të lejuara. Shpenzimet do të vendosen në kolonën [21], të deklaratës vjetore, pas rregullimeve që do t'i bëni. Në këto shpenzime, natyrisht, përfshihet edhe amortizimi i pajisjeve.

5. *Për cilën pagë bëhet fjalë në kutinë [8] në formularin e tatimit në të ardhura personale?*

Përgjigje: Kolona[8] e deklaratës mbi TAP përfshinë pagën tuaj, marrë nga punëdhënësi primar dhe ai sekondar .

SHEMBULL: Nëse paga juaj, të punëdhënësi primar, është 400 € në muaj, ndërsa të ai sekondar është 150 € në muaj, atëherë do të kemi këtë përlllogaritje:

$$\begin{aligned} 400 \text{ €} \times 12 \text{ muaj} &= \mathbf{4,800 \text{ €}} \text{ paga bruto të punëdhënësi primar} \\ \underline{150 \text{ €} \times 12 \text{ muaj}} &= \mathbf{1,800 \text{ €}} \text{ paga bruto të punëdhënësi sekondar} \\ & \mathbf{6,600 \text{ €}} \text{ paga bruto gjatë vitit të dy punëdhënësit} \end{aligned}$$

Shuma prej **6,600€** vendoset në kolonën [8] të deklaratës vjetore.

6. *A duhet që të gjitha bizneset e vogla dhe të mëdha individuale të dorëzojnë deklaratë vjetore?*

Përgjigje: Bizneset e mëdha individuale si dhe ato që janë nën 50,000 € por që dëshirojnë të jenë objekt i tatuarjes reale, janë të obliguara të bëjnë deklaratë vjetore. Ndërsa, bizneset që janë nën 50,000 €, por janë objekt i tatuarjes së paragjykuar, mund të zgjedhin që të përgatisin dhe dorëzojnë deklaratën vjetore deri më 1 prill të vitit pasues (neni 26, paragrafi 26.4 i Rregullores Nr. 2004/52).

7. *Biznesi individual – deklarues vullnetar i TVSH-së ka pasur shitje 42,000 € për vitin 2005. Gjatë vitit ka deklaruar me formular biznese të vogla. A mund të kalohet në të ardhura reale?*

Përgjigje: Për t'u përgjigjur në këtë pyetje, i referohemi nenit 30. të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2005 për të ardhura personale, ku thuhet: tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto 5,000€ deri 50,000€ mund të zgjedhin që të taten sipas skemës së tatuarjes të ardhurave reale në vend të tatuarjes në mënyrën e paragjykuar. Këta tatimpagues mund ta bëjnë këtë duke plotësuar një formular aplikacioni, brenda periudhës tatimore, dhe ta dorëzojnë atë në Administratën Tatimore. Formulari i aplikacionit është dhënë në nenin 30 në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2005 'Mbi të Ardhurat Personale'.

8. Nëse periudhat e para të kësteve të tatimit i ka paguar me metodën e paragjykuar prej 3% , ndërsa dy periudhat e fundit, këstet janë paguar me metodën e grupimit të të ardhurave, si do të llogaritet tatimi në të ardhurat personale në fund të vitit për këta tatimpagues ?

Përgjigje: Në këtë rast, ky tatimpagues do të bëjë deklaratë vjetore dhe gjatë procesimit të gjitha pagesat e tij do të transferohen në kuadër të periudhës vjetore, pa marrë parasysh se ka përdorur formular të ndryshëm (me arsytim se ka pasë ngritje në qarkullim). Po ashtu, kalkulimi i deklaratës vjetore do të bëhet konform Rregullores Nr. 2004/52, duke aplikuar të gjitha ndëshkimet dhe interesat e nevojshme.

Tatimpaguesi nuk ka nevojë të korigjojë dy periudhat e para me formularin e bizneseve të mëdha individuale.

9. Klubi futbollistik paguan pagën lojtarëve në bazë të kontratës, mirëpo përveç pagës paguan:

- a) pagesa për stërvitje
- b) pagesa e premive (në raste të fitoreve në ndeshje)
- c) për ushqim
- d) për transport për vajtje- ardhje në punë

A llogaritet tatimi në të ardhurat si më lart ?

Përgjigje: Duke u bazuar në nenin 8 të Rregullores Nr. 2004/52, në pagën bruto inkorporohen të gjitha format e kompensimeve , premive, pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit si dhe forma tjera që rrisin pagën bruto. Në këtë rast, të gjitha format e pagesës për lojtarë e përbëjnë pagën bruto dhe tatimohen. Kjo vlenë për lojtarë rezidentë dhe jo-rezidentë, sepse neni 2 i Rregullores Nr. 2004/52 thotë se tatimpagues janë personat fizikë rezidentë dhe jo-rezidentë.

P.sh. pagesa e stërvitjeve është 400 €, pagesa e premive 800€, për ushqim 50 € për transport 60 €si dhe pagesa sipas kontratës 1,000 € E tërë e ardhura e tij do të jetë:

$$400 \text{ €} + 800 \text{ €} + 50 \text{ €} + 60 \text{ €} + 1,000 \text{ €} = \mathbf{2,310 \text{ €}} - \text{Paga bruto.}$$

Nëse ky lojtar ka zgjedhë punëdhënës kryesor, atëherë kjo e ardhur do të tatimohet sipas shkallëve tatimore, ndërsa nëse klubi është punëdhënës sekondar atëherë kjo e ardhur do të tatimohet me shkallën maksimale 20%, por pasi t'i zbritet kontributi pensional.

$$\begin{aligned} 2,310 \text{ €} \times 5\% &= \mathbf{115.50 \text{ €}} \text{kontributi pensional i të punësuarit} \\ 2,310 \text{ €} - 115.50 \text{ €} &= \mathbf{2,194.50 \text{ €}} \text{paga e tatueshme} \\ 2,194.5 \text{ €} \times 20\% &= \mathbf{438.90 \text{ €}} \text{tatimi në paga} \end{aligned}$$

10. Bizneset e vogla individuale me qarkullim 5,000 € -50,000 € nëse dëshirojnë të bëjnë deklaratë vjetore thuhet se ju njihen 25% në emër të shpenzimeve, mënyra se si lirohet ?

Përgjigje: Neni 26 , paragrafi 26.4 i Rregullores Nr. 2004/52, ju mundëson bizneseve me të ardhura prej 5,000€-50,000€ që të bëjnë deklaratë vjetore dhe me këtë rast ju njihen shpenzime të zbritshme prej 25% e të ardhurave bruto.

P.sh. nëse e ardhura bruto gjatë vitit është 45,000€ e cila vendoset në kolonën [9] të deklaratës vjetore , atëherë $45,000 \text{ €} \times 25\% = 11,250 \text{ €}$ në emër të shpenzimeve dhe kjo shumë vendoset në kolonën [21] të deklaratës vjetore.

$45,000 \text{ €} - 11,250 \text{ €}$ shpenzime = **33,750 €** e ardhura e tatueshme (vendoset në kolonën [27] të deklaratës vjetore), mbi të cilën aplikohen shkallët tatimore vjetore.

11. Pronari i ndërmarrjes personale ka paguar kontributet dhe tatim në burim në baza mujore. Gjithashtu, ka paguar edhe tatim 10%, në deklaratën e tatimit në të ardhura personale. A është pronari i ndërmarrjes obligues i këtyre tatimeve?

Përgjigje: Pronari i ndërmarrjes nuk është bartës i tatimit në paga. Pronari është bartës i kontributeve pensionale si i vetëpunësuar d.m.th që paguhet 10% e të ardhurave neto (çdo tremujor), nëse është biznes mbi 50,000 € apo 1/3 e tatimit, nëse është biznes nën 50,000 € (max 600 €)

12 . Tatimi në pronë, a është shpenzim i biznesit?

Përgjigje: Nëse lokali juaj për të cilin paguani tatim në pronë është në emër të biznesit tuaj d.m.th shfrytëzohet për veprimtarinë e biznesit, tatimi në pronë që paguani për të patjetër do të jetë i zbritshëm për qëllime tatimore, natyrisht, nëse jeni objekt i tatuarjes reale.

13. Nëse banka dështon në transferimin e tatimit në interes (kamata) kush duhet ta bartë obligimin për vonesat ?

Përgjigje: Meqë neni 18, paragrafi 18.1 dhe 18.2 i Rregullores Nr. 2004/52, obligon bankat që me rastin e pagesave të interesit të mbajnë tatimin në burim prej 20%, atëherë për mosmbajtje dhe transferim të tatimit, bartës i obligimeve do të jetë banka.

14. Jam biznes individual dhe shfrytëzoj 7 lokale me qira. Të gjithë qiradhënësit janë persona fizikë. A jam i obliguar të mbajë tatimin në burim apo bartës të tatimit në qira, janë vet pronarët e lokaleve?

Përgjigje: Te qiraja është me rëndësi të dihet statusi i qiramarrësit. Nëse qiramarrësi është person juridik, është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallë prej 16%. Nëse qiramarrësi është person fizik atëherë nuk është i obliguar që të mbajë tatimin në burim , por bartës i tatimit është qiradhënësi i cili paguan tatimin në qira për çdo tremujor në shkallë prej 20% e të ardhurave neto nga qiraja. Themi të ardhura neto, pasi që Rregullorja Nr. 2004/52 ju mundëson që të zbresin nga e ardhura bruto 20% në emër të shpenzimeve ose shpenzime reale (nëse ka libra dhe regjistrime). Prandaj, ju si biznes individual nuk e mbani tatimin në burim por bartës të tatimit janë pronarët e lokaleve.

15. Jam pronar i disa lokaleve me qira, ku dy prej tyre i shfrytëzojnë persona fizikë ndërsa njërin lokal një organizatë joqeveritare. Si të veproj me rastin e deklarimit të tatimit ?

Përgjigje: Ju si pronar i lokaleve me qira jeni bartës i tatimit në qira dhe këtë do ta bëni çdo tremujor, deri në ditën e 15 pas përfundimit të tremujorit. Mirëpo, duhet të dini se organizata joqeveritare si person juridik, me rastin e pagesës së qirasë do të ndalë tatimin në burim në qira në shkallë prej 16%. Andaj, duhet keni parasysh se, me rastin e deklarimit tuaj, duhet të zbrisni tatimin e mbajtur në burim nga organizata joqeveritare.

P.sh: Nëse të hyrat nga qiraja nga personat fizikë i keni 2,000 € në muaj dhe 3,000 € nga personi juridik, atëherë duhet të bëni këtë përlllogaritje:

$2,000 \text{ €} \times 3 \text{ muaj} = 6,000 \text{ €}$ në tremujor nga personat fizikë

$3,000 \text{ €} \times 3 \text{ muaj} = 9,000 \text{ €}$ në tremujor nga personi juridik

15,000 € e ardhura bruto në tremujor (vendos në kolonën [8] të pasqyrës së tatimit mbi qiranë dhe pasurinë e patrupëzuar).

$15,000 \text{ €} \times 20\% = 3,000 \text{ €}$ në emër të shpenzimeve (vendos në kolonën [9]) të pasqyrës

$15,000 \text{ €} - 3,000 \text{ €} = 12,000 \text{ €}$ e ardhura e tatueshme (vendos në kolonën [10]) të pasqyrës

$12,000 \text{ €} \times 20\% = 2,400 \text{ €}$ tatimi në qira (vendos në kolonën [11]) të pasqyrës

Organizata joqeveritare ju ka mbajtur çdo muaj tatimin në burim:
 $3,000 \text{ €} \times 16\% = 480 \text{ €}$ në muaj

$480 \text{ €} \times 3 \text{ muaj} = 1,440 \text{ €}$ tatimi i mbajtur në burim nga organizata joqeveritare, dhe këtë duhet ta zbrisni nga shuma 2,400 €

$2,400 \text{ €} - 1,440 \text{ €} = 960 \text{ €}$ tatimi që duhet paguar (vendos në kolonën [12]).

Në vijim, këtë shembull do të vendosim në pasqyrën e tatimit mbi qiranë dhe pasurinë e patrupëzuar :



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



PASQYRA E TATIMIT MBI QIRANË DHE PASURINË E PATRUPËZUAR

[1] Periudha e deklarimit:	TM1/ 2006		[2] Nr. Serik:	[2] IR						
[3] Numri Identifikues i Tatimpaguesit :	1	2	3	4	5	6	7	8	9	0
[4] Emri i tatimpaguesit	[4] Andi Guri									
[5] Adresa e tatimpaguesit (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)	[5] Lidhja e Prizrenit pn									
[6] Emri i Personit të Kontaktit	[6]					Telefoni				
[6] Emri i Personit të Kontaktit	[6]					Telefoni				
[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.										
<input type="checkbox"/> Shtesë			<input type="checkbox"/> Korrigjim			<input type="checkbox"/> Vetëm pagesë				

a. Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja	Të ardhurat	Tatimi
[8] Te ardhurat bruto nga qiraja te perfituara gjate 3-mujorit (Vini re: Kjo shume do te jete me e madhe ne rastet kur qiramarrësit tuaj jo-individual ju kane ndalur tatim ne burim)	[8] 15,000 €	
Minus: Zbritjet e lejueshme nga te ardhurat bruto (Vini re: Ose -20% e qirase kur nuk ka regjistrime, [9]=[8] x 20%; Ose - kur ka regjistrime shuma e shpenzimeve te qirase [9]=Shpenzimet aktuale	[9] 3,000 €	
[10] Te Ardhurat Neto nga Qiraja [10]=[8]-[9]	[10] 12,000 €	
[11] Tatimi ndaj te ardhurave neto [11]=[10] x 20%		[11] 2,400 €
[12] Minus: Tatimin e ndalur ne burim nga qiramarrës jo-individual në emër tuajin		[12] 1,440 €
[13] Tatimi i pagueshem per këtë 3-mujor [13]=[11] -[12]		[13] 960 €
b. Tatimi mbi pasurinë e patrupëzuar		
[14] Te ardhura nga pasuria e patrupëzuar	[14]	
[15] Minus: shpenzimet e kryera për të realizuar të ardhurën [15]	[15]	
[16] Te ardhurat neto nga pasuria e patrupëzuar [16]= [14]-[15]	[16]	
[17] Tatimi mbi të ardhurat nga pasuria e patrupëzuar [17]=[16] x 20%		[17]
[18] Tatimi i pagueshem për këtë 3-mujor [18]=[13]+[17]		[18] 960 €

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.
Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula
(_____)

dd/mm/vv
____/____/____

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

Udhëzimet në plotësimin e Pasqyrës së Tatimit mbi Qiranë dhe Pasurinë e Patrupëzuar

- Kutia [1]** Vendos periudhën tatimore për të cilën pasqyra është dorëzuar, p.sh. TM-1. 2005
- Kutia [2]** Numri serik i pasqyrës do të jetë i paraprintuar kështu që mos shëno ne kutinë [2]
- Kutia [3]** Vendos numrin e regjistrimit të individit ID UNMIK-ut, p.sh 1234573789
- Kutia [4]** Vendos emrin e individit që realizon të ardhura nga qiraja dhe pasuria e patrupëzuar
- Kutia [5]** Shkruaj adresën e individit, p.sh ‘Rruga e Barrikadave’ Nr 87, Gjakovë si dhe numrin e telefonit të individit
- Kutia [6]** Vendos emrin e personit kontaktues dhe jep numrin e telefonit të këtij personi
- Kutia [7]** Ne kutinë [7], nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për atë 3 muajorë këtë pasqyrë mund të vendosësh një **X** në një prej tre kutive:
- Shtesë** – nënkupton deklaram shtesë brenda të njëjtit 3 muajorë.
- Korrigjim** – nënkupton kur dëshiron të ndryshosh të dhënat e deklaruara më parë për atë 3 muajorë.
- Vetëm pagesë** – nënkupton se dëshironi të bëni pagesë shtesë pa ndryshuar ndonjë prej të dhënave të mëhershme që janë deklaruar për të njëjtin 3 muajorë.
- Kutia [8]** Vendos të ardhurat bruto të qirasë për tremujor. Në rastet kur qiramarrësi është një jo individ, tatimi duhet të mbahet në burim ashtu që të ardhurat bruto do të jenë më të larta se të ardhurat që në të vërtetë ju keni marrë.
- Kutia [9]** Janë dy mundësi në kutinë [9]. Varësisht nga shpenzimet së ju doni t’i zbrisni: nëse keni mbajtur të gjitha dokumentet e nevojshme për të mbështetur shpenzimet që kanë dalë për realizimin e qirasë vendose atë shumë në një kuti [9]. Nëse nuk keni ndonjë dokument për të mbështetur shpenzimet, ju mund të zbrisni 20% të të ardhurave bruto të qirasë duke vendosur atë në kutinë tjetër [9].
- Kutia [10]** Bëni zbritjen në mes të të ardhurave bruto të qirasë të vendosur në kutinë [8] dhe zbritjet e lejueshme në një prej kutive [9] dhe vendos rezultatin në kutinë [10]
- Kutia [11]** Shumëzo shumën e vendosur në [10] me 20% dhe vendos rezultatin në kutinë [11]
- Kutia [12]** Vendos shumën e tatimit të mbajtur në burim nga qiramarrësit jo individual
- Kutia [13]** Vendos në kutinë [13] ndryshimin në mes të shumës të vendosur në kutinë [11] me kutinë [12]
- Kutia [14]** Vendos të ardhurat e marra nga pasuria e patrupëzuar në kutinë [14]
- Kutia [15]** Vendos çdo shpenzim të dokumentuar që lidhet me gjenerimin e të ardhurave nga pasuria e patrupëzuar në kutinë [15]
- Kutia [16]** Vendos ndryshimin në mes të shumave të vendosura në kutinë [14] dhe kutinë [15] në kutinë [16]
- Kutia [17]** Shumëzo shumën e vendosur në kutinë [16] me 20% dhe vendos rezultatin në kutinë [17]
- Kutia [18]** Vendos shumën e kutisë [13] dhe kutisë [17] në kutinë [18] nëse keni të ardhura nga të dyja, qiraja dhe pasuria e patrupëzuar.
- Kutia [19]** Arkëtarë i bankës do të vendos shumën e tatimit të paguar me këtë formular

Pasqyra duhet të nënshkruhet dhe t’i vihet data nga individi apo një person i caktuar nga ai dhe të dorëzohet në bankë deri në 15 ditë pas përfundimit të tremujorit kalendarik

Lerëni të zbrazët vendin ku shkruan “**Pjesa e bankës**” që të plotësohet nga personi i autorizuar nga banka.

16. Jemi ortakëri. Si do ta bëjmë pagesën e tatimit?

Përgjigje: Bazuar në nenin 1 paragrafi 1. c të Rregullores Nr. 2004/52 mbi TAP si dhe nenin 31 të Udhëzimit Administrativ 02.2005 të kësaj rregulloreje, ortakët do të dorëzojnë pasqyrat tremujore të të ardhurave, të bëjnë pagesat tremujore paradhënie në lidhje me kontributin e tyre në ortakëri, do të dorëzojnë deklaratën e barazimit për periudhën tatimore dhe do të paguajnë çdo tatim obligim ose të kërkojnë çdo rimbursim për tatimin e paguar tepër.

17. Bizneset individuale a paguajnë dividend?

Përgjigje: Për t'u përgjigjë në këtë pyetje, fillimisht ndalemi të termi biznes individual (Rregullore Nr 2004/52). Biznes individual d.m.th **person fizik** që merret me një afarizëm, ndërsa **dividend** d.m.th shpërndarja nga kompania, e parave të gatshme ose aksioneve aksionarëve. Nga këto dy terme kuptojmë se biznesi individual nuk shpërndanë dividend por, nëse pronari i biznesit individual është aksionar në ndonjë kompani tjetër, atëherë këto të hyra i paraqet me rastin e deklarimit vjetor në kolonën [14] si dhe tatimin e mbajtur në dividend nga kompania në kolonën [37], të deklaratës vjetore.

18. A është interesi i llogaritur nga ATK-ja si shpenzim i zbritshëm?

Përgjigje: Çdo veprimtari biznesi është i përcjellur me një sërë shpenzimesh. Mirëpo, për qëllime tatimore, Rregullorja Nr. 2004/52 mbi TAP, këto shpenzime i ka klasifikuar në tri grupe:

- shpenzime të zbritshme
- shpenzime pjesërisht të zbritshme dhe
- shpenzime të pazbritshme

Në grupin e shpenzimeve të pazbritshme (neni 9 paragrafi 9.9 pika c i Rregullores Nr. 2005/52), si shpenzime të pazbritshme janë edhe gjobat dhe ndëshkimet.

19. A pranohet si shpenzim qiraja e paguar për lokalit që shfrytëzoj për qëllime biznesore?

Përgjigje: Tatimi në burim në qira mbahet vetëm nga personat juridikë, prandaj ju si biznes individual nuk jeni të obliguar të mbani tatimin në burim. Bartës i tatimit në qira do të jetë pronari i lokalit.

Mirëpo, nëse posedoni kontratë dhe dëshmi për pagesën e qirasë suaj për shfrytëzimin e lokalit në emër të biznesit tuaj, atëherë patjetër do ta shfrytëzoni këtë shpenzim si të zbritshëm nëse jeni objekt i tatuarjes reale.

20. Nëse biznesi, gjatë vitit 2005, ka pasur tejkalime në emër të shpenzimeve të përfaqësimit p.sh: reklamës, reprezentacionit, ndërsa, në vitin 2006, këto shpenzime kanë qenë të ulta, në raport me atë që lejon Rregullorja (2% të të hyrave bruto). Shpenzimet që nuk janë shfrytëzuar në vitin 2005, për qëllime tatimore, a mund të shfrytëzohen në vitin 2006?

Përgjigje: Neni 9 paragrafi 9.2 i Rregullores Nr. 2004/52 thotë se, lejohen si zbritje nga të ardhurat e përgjithshme, të krijuara gjatë periudhës tatimore që janë tërësisht, vetëm dhe drejtpërdrejtë të lidhura me kryerjen e aktiviteteve të tilla afariste, prandaj shpenzimet e përfaqësimit, neni 9.3 paragrafi a. mund të zbriten deri në shumën maksimale 2% të të ardhurave bruto që i përkasin asaj periudhe tatimore .

21. Personi fizik nuk është i regjistruar si biznes, por realizon të hyra nga qiraja mbi 50,000 € në vit. Çfarë tatimi është i obliguar të paguajë ky person ?

Përgjigje: Ky person është i obliguar të paguajë tatimin në të ardhurat nga qiraja në çdo tremujor në shkallë prej 20 % të të ardhurave neto. Rregullorja e tatimit në të ardhura personale nuk e përcakton limitin se deri në çfarë shkalle të të ardhurave trajtohen të ardhurat nga qiraja, por thotë se çdo tatimpagues që krijon të ardhura nga qiraja është i obliguar të paguajë tatimin në qira.

Por, pasi kalon limitin mbi 50,000 € është obligues edhe të regjistrohet në TVSh. Mirëpo, me rastin e llogaritjes të tatimit paraprakisht nga e ardhura e tij, heq pjesën e TVSh-së, pastaj llogaritë tatimin në qira.

P.sh. të hyrat nga qiraja në muaj janë 10,000 €

10,000 € : 7.66666666 = **1,304.34 €** TVSh i paguan çdo muaj (këtë e bën pasi të bëhet deklarues i TVSh-së).

10,000 € - 1,304.34 € = 8,695.66 €

Shuma prej 8695.66 € do të jetë bazë për tatimin në qira. Mirëpo, pasi tatimi në qira deklarohet çdo tre muaj, atëherë do të kemi:

8,695.66 € x 3 muaj = 26,086.98 €
 26,086.98 € x 20% shpenzime = 5,217.39 € në emër të shpenzimeve
 26,086.98 € - 5,217.39 € = 20,869.59 € e ardhura e tatueshme
 20,869.59 € x 20% = **4,173.91 €** tatimi në qira

22 . Jemi kompani publike dhe kemi një ekspert të huaj, Me rastin e pagesës nuk kemi ndalë tatimin në burim me arsyetimin se është jo-rezident?

Përgjigje: Ju, si kompani publike, jeni të obliguar të mbani tatimin në burim për ekspertin e huaj, sepse neni 2 i Rregullores Nr. 2004/52 për TAP, thotë se tatimpagues janë personat fizikë banorë dhe jo-banorë.

Nga tatimi në paga përjashtohen vetëm personat që i takojnë nenit 7 të Rregullores Nr. 2004/52 mbi TAP.

23. Jam pronar i një restoranti dhe organizoj mbrëmje muzikore me këngëtarë të ndryshëm. Me rastin e pagesës, në bazë të kontratës që kam me këngëtarin, a kam obligime apo bartës i tatimit është vet këngëtari?

Përgjigje: Ju si pronar i lokalit jeni i obliguar që me rastin e pagesës së këngëtarit ta mbani në burim tatimin në paga dhe kontributin pensional. Në këtë rast ju trajtoheni si punëdhënës sekondar dhe aplikoni shkallën maksimale prej 20% por, pasi të zbritni kontributin pensional në shkallë prej 5%.

24. Një i punësuar punon për dy punëdhënës. Njërin prej tyre e ka zgjedhur punëdhënës kryesor, ndërsa tjetri trajtohet si punëdhënës sekondar. Të punëdhënësi që e ka zgjedhur si punëdhënës kryesor, paga e tij mujore ka qenë 300 €, kurse të punëdhënësi sekondar 100 €.

Përgjigje: Llogaritja mujore e Kontributeve për Kursim Pensional dhe Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga punëdhënësi kryesor është:

$$300 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributet e punëdhënësit)} = 15 \text{ €}$$

$$300 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributet e të punësuarit)} = 15 \text{ €}$$

Të ardhurat e tatueshme = Të ardhurat bruto – zbritjet e lejueshme

$$300 \text{ €} - 15 \text{ € (kontributi i të punësuarit)} = 285 \text{ €}$$

$$0 \text{ €} \text{-----} 80 \text{ €} = 80 \text{ €} \times 0\% = 0 \text{ €}$$

$$80 \text{ €} \text{-----} 250 \text{ €} = 170 \text{ €} \times 5\% = 8.5 \text{ €}$$

$$250 \text{ €} \text{-----} 285 \text{ €} = 35 \text{ €} \times 10\% = 3.5 \text{ €}$$

$$\textbf{Tatimi i mbajtur në burim = 12.00 €}$$

Llogaritja mujore e kontributeve për kursim pensional dhe tatimit mbi të Ardhurat personale nga punëdhënësi sekondar është:

$$100 \text{ €} \times 5\% = \text{(kontributi i punëdhënësit)} = 5 \text{ €}$$

$$100 \text{ €} \times 5\% = \text{(kontributi i të punësuarit)} = 5 \text{ €}$$

Të ardhurat e tatueshme = Të ardhurat bruto – zbritjet e lejueshme

$$100 \text{ € Ardh/bruto} - 5 \text{ € (kontributi i të punësuarit)} = 95 \text{ € Ardh/Tatueshme}$$

$$95 \text{ € Ardh/ tatueshme} \times 20\% = 19 \text{ € totali i tatimit të mbajtur në burim}$$

Llogaritja vjetore e kontributit për kursime pensionale dhe tatimit mbi të Ardhurat Personale në fund të vitit, nëse të ardhurat janë si më poshtë:

Të ardhurat bruto nga punëdhënësi kryesor	300 x 12 muaj = 3,600€
<u>Të ardhurat bruto nga punëdhënësi sekondar</u>	<u>100 x 12 muaj = 1,200€</u>
Të ardhurat vjetore bruto	400 x 12 muaj = 4,800€

Llogarisim kontributet pensionale :

$$4,800 \text{ €} \times 5\% \text{ (kontributet e të punësuarit)} = 240 \text{ €}$$

$$4,800 \text{ €} - 240 \text{ € (kontributet e të punësuarit)} = 4,560 \text{ €}$$

Të ardhurat e tatuara 4,560 €

I zbatojmë shkallët tatimore vjetore:

$$0 \text{ €} \text{-----} 960 \text{ €} = 960 \text{ €} \times 0\% = 0.00 \text{ €}$$

$$960 \text{ €} \text{-----} 3,000 \text{ €} = 2,040 \text{ €} \times 5\% = 102.00 \text{ €}$$

$$\underline{3,000 \text{ €} \text{-----} 4,560 \text{ €} = 1,560 \text{ €} \times 10\% = 156.00 \text{ €}}$$

Totali : 258.00€

Nga llogaritja mujore shihet se ky i punësuar, të punëdhënësi që e ka zgjedhur punëdhënësi kryesor, ka paguar 180 € kontribute. Gjithashtu, punëdhënësi i tij ka paguar 180 € (15 € x 12 Muaj) dhe 144 € (12 € x 12 muaj) i është mbajtur tatimi në burim.

Të punëdhënësi sekondar i punësuarit ka kontribuar 60 € (5 x 12 muaj), kurse tatimi i është mbajtur në burim në vlerë prej 228 € (19 x 12 muaj).

$$\text{Tatimi i mbajtur në burim gjatë periudhës tatimore} \quad 372 \text{ €}$$

$$\underline{\text{Obligimi tatimor për të ardhurat vjetore nga pagat} \quad 258 \text{ €}}$$

(Parapagim) 114 €

Në këtë rast, i punësuarit është obligues për të dorëzuar deklaratën tatimore dhe ka mundësi që parapagimin prej 114 € ta rimbursojë, ose këtë parapagim mund ta shfrytëzojë për të mbuluar obligime në ndonjë këst në të ardhmen.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
 MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
 MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



**FORMULAR I DEKLARIMIT VJETORË DHE PAGESËS PËR TATIMIN
 NË TË ARDHURA PERSONALE**

[1] Periudha e deklarimit: [2] Nr. Serial:

[3] Numri i Regjistrimit të Biznesit :

 [3a.] Numri Individual i Regjistrimit :

[4] Emri i tatimpaguesit

[5] Adresa e tatimpagu.
 (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)

[6] Telefon

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.
 Shtesë Korrigjim Vetëm pagesë

[50] Shuma obligative
 (Barteni shumën nga kutia [45])
 [51] Shuma e tatimit të paguar

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Deklaratë Tatimore janë të vërteta.
 Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula
 (_____)

dd/mm/vv
 ____/____/____

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	[52] Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

Të ardhurat e tatueshme

[8] Pagat bruto	[8]	4 800.00 €	
[9] Të ardhurat bruto nga biznesi	[9]		
[10] Të ardhurat bruto nga ortakëritë.....	[10]		
[11] Qiratë bruto	[11]		
[12] Të ardhurat bruto nga pagesat e pensionit	[12]		
[13] Të ardhurat bruto nga interesi.....	[13]		
[14] Të ardhurat bruto nga dividendi	[14]		
[15] Të ardhurat bruto nga fitoret në lotari	[15]		
[16] Të ardhurat bruto nga pasuria e patrupëzuar	[16]		
[17] Fitimet kapitale (aplikohen pas vitit 2010)	[17]		
[18] Të ardhurat me burim nga jashtë	[18]		
[19] Të ardhura tjera (specifiko)	[19]		
[20] Totali i të ardhurave të tatueshme	[20]	4 800.00 €	

Zbritjet

[21] Shpenzimet e bizn., reale ose 25% të të ardhurave të biznesit	[21]		
[22] Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e qirasë-reale ose 20% të qirasë bruto	[22]		
[23] Shpenzimet për kontributet pensionale (bashkëngjit dokumentet).....	[23]	240.00 €	
[24] Shpenzimet që lidhen me të ardhurat nga pasuria e patrupëzuar.....	[24]		
[25] Shpenzimet tjera të lejueshme (specifiko)	[25]		
[26] Totali i shpenzimeve të lejuara (mbledh 21 deri 25)	[26]	240.00 €	
[27] Shuma e tatueshme (20-26) – nëse është negative vendos shumën në kllapa.....	[27]	4 560.00 €	

Tjera

[28] Humbjet e bartura	[28]		
[29] Zbritja për kontributet bamirëse 5% të shumës së tatueshme.....	[29]		
[30] Totali i zbritjeve tjera.....	[30]		
[31] Të ardhurat e tatueshme para tatimit [27]-[30] – nëse është negative vendose shumën në kllapa.....	[31]	4 560.00 €	
[32] Tatimi në të ardhurat e tatueshme sipas grupeve tatim. (nëse është negative vendos 0)	[32]	258.00 €	

Tatimi i mbajtur ne burim gjatë vitit

[33] Tatimi i mbajtur në burim në paga nga punëdhënësit (bashkëngjit certifikatat) ..	[33]	372.00 €	
[34] Tatimi në interesin të mbajtur në burim nga bankat (bashkëngjit certifikatat)	[34]		
[35] Tatimi në dividendë i mbajtur në burim nga kompanitë (bashkëngjit certifikatat) ..	[35]		
[36] Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë (bashkëngjit certifikatat)	[36]		
[37] Tatimi i mbajtur në burim mbi fitoret në lotari (bashkëngjit certifikatat)	[37]		
[38] Kreditimi I tatimit te huaj (bashkëngjit certifikatat) përkatëse.....	[38]		
[39] Totali I tatimit të mbajtur në burim dhe kreditimi.....	[39]	372.00 €	
[40] Tatimi Total I pagueshëm për periudhën [32]-[39]	[40]	-114 .00 €	
[41] Pagesat tremujore paradhënie mbi të ardhurat nga biznesi.....	[41]		
[42] Pagesat tremujore paradhënie mbi të ardhurat nga qiraja dhe pasuria e patrupëzuar	[42]		
[43] Totali i pagesave paradhënie për periudhat [41] + [42]	[43]	0.00 €	
[44] Totali i tatimit për pagesë [44] = [40] - [43].....	[44]	-114 .00 €	

Nëse rezultati në kutinë [44] është (+) ju keni një **shumë obligative**. Nëse rezultati në kutinë [44] është (-) ju keni një **rimbursim**. Vendos shumën në kutinë e duhur.

[45] Shuma obligative [45] 0.00 €

[46] Rimbursimi [46] 114.00 €

[47] Emri i bankës	[47]	
[48] Bartësi i llogarisë		
[49] Numri i llogarisë		

25. Një punëtor gjatë periudhës prej 01.01.2005-31.12.2005 ka pasur këto të ardhura:

a. Nga punëdhënësi primar, 3.600 € të ardhura bruto (300 €x 12 muaj)
 Nga punëdhënësi primar i janë ndalë në burim dhe paguar kontribute pensionale 5% dhe tatimi në paga sipas shkallëve mujore .
 Nga punëdhënësi primar ka marrë certifikatën e kontributit dhe tatimit të mbajtur në burim për vitin 2005 ,sipas së cilës kontributi i të punësuarit i ndalur gjatë vitit është **180 €**(15 €x 12 muaj), kontributi i punëdhënësit është 180 € kurse tatimi në paga i ndalur në burim dhe i paguar për tërë vitin është **144 €**(12 €x 12 muaj).

b. Nga punëdhënësi sekondar, 2,500 € të ardhura bruto gjatë vitit 2005. Nga punëdhënësi sekondar i është ndalë kontributi pensional prej 5% dhe tatimi në paga në shkallën maksimale prej 20%,natyrisht, pasi është zbritur kontributi i të punësuarit 5%.
 Nga punëdhënësi sekondar, ka marrë certifikatën e kontributit dhe tatimit të mbajtur në burim për tërë vitin në shumën prej 125 €(2,500 €x 5%) dhe kontributi i punëdhënësit 125€ (2,500 €x 5%), kurse tatimi në paga i ndalur në burim dhe i paguar për tërë vitin është **475€** (375 €x 20%)

c. Nga qiraja **3400€**të ardhura bruto (1,800€nga biznesi individual dhe 1,600€nga personi juridik –OJQ).

- për lokalin, lëshuar biznesit individual, për 6 muaj (prill –shtator) të vitit 2005 nga 300 €në muaj (6 muaj x 300 €= 1,800 €)
- për objektin tjetër të lëshuar me qira një OJQ-je për 4 muaj nga 400 €në muaj (400 €x 4 muaj = 1,600 €). Kjo OJQ (person juridik) i ka ndalë në burim dhe paguar për çdo muaj 16% tatim në qira. Nga kjo OJQ ka marrë certifikatën e tatimit të mbajtur nga qiraja për vitin 2005 prej 256 €(1,600 €x 16%= 256 €)

Për të ardhurat nga qiraja, ky person ka dorëzuar pasqyrën tremujore dhe ka paguar tatimin në qira me ID.

Nga banka ka 500 €të ardhura nga interesi. Banka i ka ndalë në burim dhe ka paguar 100 € (500 €x 20%) tatimin në interes.

Nga Banka ka marrë certifikatën e tatimit në interes të mbajtur në burim prej 100 €(500 € x 20%).

d. Nga lotaria ka fituar 2,000 €dhe organizuesi i lojërave të fatit ia ka ndalë në burim 400€(2,000 €x 20%). Nga lotaria ka marrë certifikatën e tatimit të mbajtur nga lojërat e fatit.

Sqarimet e llogaritjeve të tatimit në të ardhurat personale sipas grupeve.**SHEMBULLI I. Punëtori X. Y.**

Llogaritjet, sipas grupeve për Kutinë (32) të Deklaratës së Tatimi në të Ardhurat Personale.

0 €-	960 €=	960 € x	0%	=	0.00 €
9,60 €-	3,000 €=	2,040 € x	5%	=	102.00 €
3,000 €-	5,400 €=	2,400 € x	10%	=	240.00 €
5,400 €-	11,015 €=	5,615 €x	20%	=	1,123.00 €
	Kutia [32]				1,465.00 €



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



**FORMULAR I DEKLARIMIT VJETORË DHE PAGESËS PËR TATIMIN
NË TË ARDHURA PERSONALE**

[1] Periudha e deklarimit:	2005	[2] Nr. Serial:	[2] PD
[3] Numri i Regjistrimit të Biznesit :	[3a.] Numri Individual i Regjistrimit :		
7 0 1 1 1 1 1 1			
[4] Emri i tatimpaguesit	[4] X . Y		
[5] Adresa e tatimpagu. (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)	[5]		
[6] Telefon	[6]		
[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.			
<input type="checkbox"/> Shtesë	<input type="checkbox"/> Korrigjim	<input type="checkbox"/> Vetëm pagesë	

[50] Shuma obligative	[50] /
(Barteni shumën nga kutia [45])	
[51] Shuma e tatimit të paguar	[51] /

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Deklaratë Tatimore janë të vërteta.
Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula
(_____)

dd/mm/vv
____/____/____

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	[52] Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

32. Plotësimi i Deklaratës Vjetore për Tatimin në të Ardhurat Personale- viti 2005. Biznesi individual Y. Z.

Ndërmarrja Y. Z., si biznes individual gjatë vitit 2005, ka pasë këto të dhëna:

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve prej	160,000 €
Të ardhurat bruto nga qiratë për objektin e lëshuar personit juridik	12,000 €
Të ardhurat nga interesi	4,000 €
Të ardhurat nga dividendi	3,000 €
Shpenzimet pas përshtatjeve (rregullimeve)	113,000 €
Pagesa paradhënie për Tatimin në TAP. (1,800 €x 4)	7,200 €
Pagesa e kontributeve pensionale (600 €x 4)	2,400 €
Pagesa e kontributeve bëmirëse shoqatave humanitare	5,000 €

Sqarime:

- Ky biznes për vitin 2005, si biznes i madh individual, ka paguar tatimin në T A P për çdo tremujor nga 1,800 € dhe kontribute pensionale nga 600 € D.m.th gjithsejtë, për vitin 2005, pagesa tremujore paradhënie për tatimin në TAP është 7,200 € dhe kontribute pensionale gjithsejtë 2,400 €
- Të ardhurat nga qiraja i ka 12,000 € Objekti i është dhënë me qira një personi juridik. Tatimi në qira i është ndalë në burim dhe paguar në shumën prej 1,920 €(12,000 €x 16%). Prandaj, është marrë certifikata e tatimit në qira, të mbajtur në burim.
- Për interes, prej bankës është marrë certifikata e tatimit në interes, të mbajtur në burim, prej 800 €(4,000 €x 20%).
- Për dividend është marrë certifikata e tatimit në dividend, të mbajtur në burim, prej **600€**(3,000 €x 20%).
- Gjatë vitit 2005, në emër të kontributeve bëmirëse u janë dhënë shoqatave humanitare 5,000 € Këto kontribute, nuk duhet të përfshihen në kutinë (21). Kur t'i gjejmë shpenzimet e biznesit, tani këto kontribute pranohen si shpenzime të zbritshme vetëm **3,060 €** (61,200 €x 5%).

Udhëzime :

Për të plotësuar Kutinë [21], do të jetë ndihmë shumë e madhe nëse për rregullimin e shpenzimeve përdoren tabelat përkatëse të Deklarata e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



**FORMULAR I DEKLARIMIT VJETORË DHE PAGESËS PËR TATIMIN
NË TË ARDHURA PERSONALE**

[1] Periudha e deklarimit:	2005	[2] Nr. Serial:	[2] PD
[3] Numri i Regjistrimit të Biznesit :	[3a.] Numri Individual i Regjistrimit :		
7 0 2 2 2 2 2 2			
[4] Emri i tatimpaguesit	[4] Y . Z		
[5] Adresa e tatimpagu. (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)	[5]		
[6] Telefon	[6]		
[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.			
<input type="checkbox"/> Shtesë	<input type="checkbox"/> Korrigjim	<input type="checkbox"/> Vetëm pagesë	

[50] Shuma obligative	[50] /
(Barteni shumën nga kutia [45])	
[51] Shuma e tatimit të paguar	[51] /

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Deklaratë Tatimore janë të vërteta.
Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula
(_____)

dd/mm/vv
____/____/____

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	[52] Shuma e tatimit të paguar _____ €	
	Teksti:		
	Data ____/____/____		

Të ardhurat e tatueshme

[8] Pagat bruto	[8]	160 000.00 €	
[9] Të ardhurat bruto nga biznesi	[9]		
[10] Të ardhurat bruto nga ortakëritë.....	[10]	12 000.00 €	
[11] Qiratë bruto	[11]		
[12] Të ardhurat bruto nga pagesat e pensionit	[12]	4 000.00 €	
[13] Të ardhurat bruto nga interesi.....	[13]	3 000.00 €	
[14] Të ardhurat bruto nga dividendi	[14]		
[15] Të ardhurat bruto nga fitoret në lotari	[15]		
[16] Të ardhurat bruto nga pasuria e patrupëzuar	[16]		
[17] Fitimet kapitale (aplikohen pas vitit 2010)	[17]		
[18] Të ardhurat me burim nga jashtë	[18]		
[19] Të ardhura tjera (specifiko)	[19]		
[20] Totali i të ardhurave të tatueshme	[20]	179 000.00 €	

Zbritjet

[21] Shpenzimet e bizn., reale ose 25% të të ardhurave të biznesit	[21]	113 000.00 €	
[22] Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e qirasë-reale ose 20% të qirasë bruto	[22]	2 400.00 €	
[23] Shpenzimet për kontributet pensionale (bashkëngjit dokumentet).....	[23]	2 400.00 €	
[24] Shpenzimet që lidhen me të ardhurat nga pasuria e patrupëzuar.....	[24]		
[25] Shpenzimet tjera të lejueshme (specifiko)	[25]		
[26] Totali i shpenzimeve të lejuara (mblidh 21 deri 25)	[26]	117 800.00 €	
[27] Shuma e tatueshme (20-26) – nëse është negative vendos shumën në kllapa.....	[27]	61 200.00 €	

Tjera

[28] Humbjet e bartura	[28]		
[29] Zbritja për kontributet bamirëse 5% të shumës së tatueshme.....	[29]	3 060.00 €	
[30] Totali i zbritjeve tjera.....	[30]	3 060.00 €	
[31] Të ardhurat e tatueshme para tatimit [27]-[30] – nëse është negative vendose shumën në kllapa.....	[31]	58 140.00 €	
[32] Tatimi në të ardhurat e tatueshme sipas grupeve tatim. (nëse është negative vendos 0)	[32]	10 890.00 €	

Tatimi i mbajtur ne burim gjatë vitit

[33] Tatimi i mbajtur në burim në paga nga punëdhënësit (bashkëngjit certifikatat) ..	[33]		
[34] Tatimi në interesin të mbajtur në burim nga bankat (bashkëngjit certifikatat)	[34]	800.00 €	
[35] Tatimi në dividendë i mbajtur në burim nga kompanitë (bashkëngjit certifikatat) ..	[35]	600.00 €	
[36] Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë (bashkëngjit certifikatat)	[36]	1 920.00 €	
[37] Tatimi i mbajtur në burim mbi fitoret në lotari (bashkëngjit certifikatat)	[37]		
[38] Kreditimi I tatimit te huaj (bashkëngjit certifikatat) përkatëse.....	[38]		
[39] Totali I tatimit të mbajtur në burim dhe kreditimi.....	[39]	3 320.00 €	
[40] Tatimi Total I pagueshëm për periudhën [32]-[39]	[40]	7 570.00 €	
[41] Pagesat tremujore paradhënie mbi të ardhurat nga biznesi.....	[41]	7 200.00 €	
[42] Pagesat tremujore paradhënie mbi të ardhurat nga qiraja dhe pasuria e patrupëzuar	[42]		
[43] Totali i pagesave paradhënie për periudhat [41] + [42]	[43]	7 200.00 €	
[44] Totali i tatimit për pagesë [44] = [40] - [43].....	[44]	370.00 €	

Nëse rezultati në kutinë [44] është (+) ju keni një **shumë obligative**. Nëse rezultati në kutinë [44] është (-) ju keni një **rimbursim**. Vendos shumën në kutinë e duhur.

[45] Shuma obligative [45] 370.00 €

[46] Rimbursimi [46] 0.00 €

[47] Emri i bankës	[47]	
[48] Bartësi i llogarisë		
[49] Numri i llogarisë		

TAK

TATIMI MBI TË
ARDHURAT E KORPORATAVE

1. Hyrje

Që nga 1 Janari 2005, në Kosovë ka filluar të zbatohet Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave, sipas Rregullores Nr. 2004/51.

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave zëvendëson Tatimin në Fitim, sipas Rregullores Nr.2002/3, i cili (T. F.) kishte filluar të aplikohet në Kosovë që nga 01.04.2002. Në T.F ishin të regjistruar personat juridikë por edhe biznese individuale. Me hyrjen në fuqi të Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatave, kusht për tu regjistruar është vendosja e statusit juridik.

Ky Doracak Tatimor, mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave në Kosovë, është përgatitur nga Administrata Tatimore e Kosovës për t'ua lehtësuar tatimpaguesëve që ta kuptojnë Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe që të japë një vështrim të përgjithshëm mbi konceptet, termat, përkufizimet dhe rregullat që janë përfshirë në Rregulloren Nr. 2004/51 “Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave në Kosovë” dhe Udhëzimin Administrativ shoqërues.

Korporata

PYETJE DHE PËRGJIGJE MBI TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

1. Çfarë është Tatimi në të Ardhurat e Korporatave dhe cilat janë risitë në krahasim me Tatimin në Fitim?

Përgjigje: Siç tregon edhe emri i tatimit, Tatimi në të Ardhura të Korporatave është tatim që zbatohet në të ardhurat reale të korporatave. Si kriter për të qenë obligues i këtij tatimi është forma juridike e organizatës afariste .

Më parë, Tatimi në Fitim është aplikuar vetëm në fitimin e tatuar të korporatave të mëdha. Për shembull, të atyre me shkallë qarkullimi më të lartë se 100,000 € ose korporatave me asete që kanë vlerë mbi 50,000 € prej të cilave është kërkuar të përpilojnë pasqyrat financiare. Në bazë të skemës së mëparshme, korporatat me qarkullim më të ultë se 100,000 € nuk është dashur të përgatisin pasqyra financiare dhe ato i janë nënshtruar tatimit të paragjykuar që është aplikuar në fitimin e paragjykuar.

Sipas sistemit të ri të Tatimit në të Ardhura të Korporatave, të gjitha korporatat e vogla që zgjedhin t'i nënshtrohen tatimit në fitim real, mund të bartin më tej humbjet ndryshe nga tatimi i paragjykuar i cili aplikohet vetëm në shitjet bruto të korporatave. Mirëpo, disa korporata shumë të vogla do të vazhdojnë t'i nënshtrohen tatimit të 'paragjykuar'. Për shembull, duke paguar shumën fikse për tremujor, nëse shitjet bruto të tyre kanë qenë më të ulta se 5,000 € për vit, dhe duke paguar tatimin 3% (tregti etj) dhe 5% (shërbime etj) në bruto shitje, nëse qarkullimi i tyre ka qenë 5,000.01 € - 50,000 € për vit dhe nëse nuk kanë zgjedhur t'i nënshtrohen tatimit në të ardhura reale.

2. A i nënshtrohet kompania ime Tatimit në të Ardhura të Korporatës?

Përgjigje: Nëse ju e përfaqësoni organizatën afariste (sh.p.k., sh.a.), duke përfshirë ndërmarrjet publike dhe ato që janë pronë shoqërore, me status të personit legal, atëherë përgjigja në pyetjen e parashtruar është po.

Nëse ju përfaqësoni një organizatë të regjistruar në UNMIK si organizatë jo-qeveritare (OJQ), atëherë përgjigja është po. Të ardhurat e OJQ-ve me status të përfitimit publik, janë të liruara prej Tatimit në të Ardhurat e Korporatave me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime bamëmirëse (me qëllime të përfitimit publik).

Nëse ju përfaqësoni një njësi të përhershme, të një personi jo-rezident ne Kosove, përgjigja është po.

Nëse ju jeni person i vetë-punësuar, keni biznes personal ose jeni partner individual në një ortakëri, përgjigja është jo. Ju nuk i nënshtroheni Tatimit në të Ardhura të Korporatave dhe në vend të këtij tatimit ju duhet t'i nënshtroheni Tatimit në të Ardhura Personale.

3. Çka nënkuptohet me personin jo-rezident dhe çka është njësia e përhershme?

Përgjigje: ‘Personi jo-rezident’ nënkupton personin ose grupin e personave të cilët vendin e menaxhmentit efektiv e kanë të vendosur jashtë Kosovës ose kur ata janë themeluar sipas ligjeve të një vendi tjetër. Pra, personi jo-rezident është thjesht person që nuk është rezident i Kosovës. Për shembull, "X-i" është një kompani Amerikane e cila është inkorporuar në SHBA dhe vendin e menaxhmentit efektiv e ka të vendosur në New York. "X-i" ka vendosur të hap një dyqan në Prishtinë. "X-i" konsiderohet të jetë ‘person jo-rezident’. Dyqani i "X-it" është ‘njësi e përhershme’.

‘Njësia e përhershme’ nënkupton çdo vend të punës përmes të cilit personi jo-rezident zhvillon biznesin në Kosovë. Mund të jetë fabrikë, filialë, zyre e përfaqësimit, punëtori, vend për ndërtim, gurore, mjete për transport ose transmetim, dyqan, depo etj. Fitimi i njësisë së përhershme të personit jo-rezident në Kosovë i nënshtrohet tatimit në të ardhura të korporatave në Kosovë. Personi jo-rezident që ka njësi të përhershme në Kosovë, mundet që në shtetin e vet në të cilin është rezident të kreditojë pagesën e tatimit mbi të ardhurat e korporatave të paguar në Kosovë. Ai mund të marrë një dokument zyrtar prej Administratës Tatimore të Kosovës që vërteton shumën e tatimit të paguar.

4. Cilat shpenzime i nënshtrohen kufizimeve ose korrigjimeve?

Përgjigje: Shpenzime specifike të cilat janë regjistruar në pasqyra financiare i nënshtrohen kufizimeve ose përshtatjeve për qëllime tatimi. Për shembull, këto janë:

- Kontributet bëmirëse;
- Shpenzimet e përfaqësimit;
- Borxhet e këqija;
- Fondet rezervë;
- Pagesat ndaj personave të lidhur;
- Zhvlerësimi;
- Riparimet kapitale;
- Amortizimi;
- Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit.

5. Çfarë janë shpenzimet e pazbritëshme?

Përgjigje: Shpenzimet në vijim, nuk lejohet të zbriten prej të ardhurave bruto në përcaktimin e tatimit në të ardhura të korporatave:

- Kostoja e blerjes dhe përmirësimit të tokës;
- Kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rindërtimit të aseteve që janë të zhvlerësuara ose amortizuara;
- Gjobat dhe dënimet;
- Tatimi në të ardhurat e korporatave;
- TVSH e zbritshme dhe TVSH e rikthyeshme;
- Shpenzimet që nuk janë përdorë plotësisht dhe ekskluzivisht në lidhje me aktivitetet ekonomike;
- Shpenzimet që nuk janë dokumentuar në pajtim me kërkesat e udhëzimit administrativ të ngritur nga MEF.

6. Unë përfaqësoj një korporatë të vogël me bruto të ardhura vjetore prej 3,000 €. A mund të zgjedh t'i nënshtrohem tatimit në fitim real?

Përgjigje: Jo. Ajo mundësi qëndron vetëm për korporatat me bruto të ardhura ndërmjet 5,000€- 50,000 € dhe jo për korporatat e vogla. Ato kanë vetëm një mundësi: të paguajnë shumën fikse për tremujor prej 37.50 €, deri në arritjen e shkallës së caktuar.

7. Ne si korporatë duhet t'u mbajmë tatimin në burim për dividend aksionarëve tonë. Disa prej tyre janë rezidentë të shteteve të huaja. A aplikohet rregulla e njejtë për aksionarët jo-rezidentë?

Përgjigje: Po. Pa marrë parasysh faktin se aksionari është apo nuk është rezident, autoriteti distributiv duhet të mbajë tatimin në burim me përqindje prej 20% në bruto dividend. Personat jo-rezidentë mund të kreditojnë tatimin në vendin e tyre dhe për këtë ju duhet çertifikata e tatimit e lëshuar prej Administratës Tatimore të Kosovës, e cila vërteton pagesën e tatimit.

8. Vitin e kaluar bruto të hyrat kanë qenë me vlerë mbi 100,000 €. Sipas rregullores së re, një korporatë e madhe mund të parapaguajë ose në bazë të parashikimit ose duke u bazuar në obligimet tatimore të vitit të kaluar. A vlen kjo rregull për korporatën time?

Përgjigje: Po. Ju mund të zgjidhni pagesën në bazë të parashikimit të obligimeve tatimore të këtij viti. Duhet ta llogaritni fitimin e tatueshëm dhe detyrimin tatimor. Të paguani $\frac{1}{4}$ të vlerësimit të juaj çdo tremujor, ose mund të bazoheni në obligimet tatimore të vitit të kaluar. Duhet t'i kushtoni vëmendje se në mundësinë e parë, shkalla e gabimit të juaj nuk mund të jetë më e lartë se 10% të tatimit final. Përndryshe, ju do t'i nënshtroheni gjobave për pagesa të pamjaftueshme. Sipas mundësisë së dytë, ju duhet të paguani $\frac{1}{4}$ të 110% të obligimeve tatimore të vitit të kaluar. Duke vepruar në këtë mënyrë, ju mund të shpëtoni prej çfarëdo gjobe potenciale që mund të paraqitet, nëse ju vendosni të paguani sipas mundësisë së parë dhe nëse shkalla e gabimit të parashikimit tuaj është më e lartë se 10%.

9. Kur duhet të bëhen pagesat e tremujorit dhe kur duhet të dorëzohet deklarata finale e tatimit në të ardhurat e korporatave?

Përgjigje: Ju, duhet të bëni pagesa paraprake të tremujorit, brenda 15 ditësh, pas fundit të tremujorit kalendarik. Pasqyrat e tremujorit duhet të dorëzohen në cilëndo bankë të autorizuar në Kosovë. Deklarata finale tatimore duhet të dorëzohet dhe çfarëdo tatimi duhet të paguhet jo më larg se me 01 Prill, pas përfundimit të periudhës tatimore.

10. Ne, si korporatë, i kemi dhënë me qira një individ objektet tona komerciale dhe aplikojmë TVSh-në mbi atë qira. A duhet të mbajë në burim tatimin mbi qiranë mbi shumën bruto, përfshirë TVSh-në apo TVSh-në e përjashtuar? Nëse i kemi marrë objektet me qira dhe i kemi rinovuar dhe përmirësuar këto asete të marra me qira, si do t'i mbulojmë shpenzimet e tilla?

Përgjigje: Në lidhje me pyetjen tuaj të parë, nëse jeni deklarues i TVSh-së, ju do të aplikoni TVSh-në mbi furnizimet tuaja të tatueshme. TVSh-në që keni aplikuar mbi qiranë nuk paraqet të ardhura për kompaninë tuaj. Kështu, TVSh-ja do të përjashtohet nga baza e mbajtjes në burim. Lidhur me pyetjen e dytë, metoda për të mbuluar shpenzimet e përmirësimit të aseteve të marra me qira do të jetë metoda e linjës së drejtë, e bazuar në kohëzgjatjen e marrëveshjes së qirasë.

11. Nëse ia shes korporatës sime aksionet e mia me të njëjtin çmim, e kështu nuk kam as fitim e as humbje, a detyrohem ndaj ndonjë tatimi?

Përgjigje: Fitimi kapital duhet të përfshihet në të ardhurat e tatueshme dhe humbja kapitale mund të bartet në vitet pasuese sikurse humbjet tjera të biznesit. Në rastin tonë, meqë nuk ka as fitim e as humbje, transaksioni i tillë nuk ndikon në gjendjen tuaj tatimore.

12. Organizata ime organizon seminare me klientët e saj dhe paguan për shujta ose kokteje. A janë shpenzimet e tilla të zbritshme apo ato duhet të trajtohen si shpenzime të përfaqësimit?

Përgjigje: Nëse i ftoni klientët tuaj të marrin pjesë në seminare, kjo është për të ngritur biznesin tuaj. Kështu, shpenzimet e tilla janë shpenzime të përfaqësimit dhe ato i nënshtrohen një kufizimi prej 2% mbi të ardhurat bruto të korporatës brenda periudhës tatimore.

13. A pranohen si shpenzime të zbritshme për Tatim në të Ardhurat e Korporatave shpenzimet e derivateve të naftës për veturën e drejtorit. Vetura është e regjistruar në emër të ndërmarrjes ?

Përgjigje: Po. Pranohen për aq sa i takojnë asaj periudhe dhe për aq sa marrin pjesë për veprimtari ekonomike. Këto shpenzime, gjithsesi, duhet të jenë të dokumentuara.

14. Shpenzimet e transportit, që dogana i pranon tani për periudhën tatimore 2004, meqë jemi ankuar dhe kemi fituar kontestin në doganë, sepse gjatë vitit 2004 dogana nuk na i ka pranuar shpenzimet e transportit që i kemi prezentuar gjatë importit.

Përgjigje: Pasi që është fituar kontesti, nëse shpenzimet e transportit të vitit 2004 i keni regjistruar në vitin 2004, atëherë do të pranohen në atë periudhë, kurse dogana e paguar do të pranohet si shpenzim në periudhën kur edhe paguhet. Gjithashtu, edhe TVSh e paguar në lidhje me këtë, do të pranohet e zbritshme në atë periudhë kur edhe është paguar.

15. Jemi agjencion turistik dhe mallin e udhëtarëve e zhdoganomë në emër të Agjencionit, pasi kështu e kemi marrëveshjen me udhëtarët. Pastaj, secili prej udhëtarëve e merr mallin e vet.

Përgjigje: Zhdoganimi duhet të bëhet në emër të atij personi të cilit i takon malli. Me këtë veprim tuajin, ju e merrni për sipër se malli është i juaji. Në shitje, do të ju kërkohet të dëshmoni se kujt i është shitur ky mall dhe atë me vlerën e hapur te tregut.

16. Të agjencionet, për transportimin e udhëtarëve jashtë Kosovës, a pranohen shpenzimet e karburanteve të blera jashtë Kosovës?

Përgjigje: Po. Do të pranohen për aq sa janë shpenzuar për veprimtari ekonomike dhe duhet, gjithsesi, të jenë të dokumentuara dhe të besueshme.

17. Nëse, në tenderin e fituar ndalet 10% e vlerës si garancion, cila do të jetë baza e të hyrave për TVSh dhe TAK?

Përgjigje: Në rastin tuaj, baza për llogaritjen e obligimit tatimor për TAK dhe TVSh, është faturimi.

18. Subjekti që importon mall me akcizë por akciza i këthehet më vonë. Si të vepohet?

Përgjigje: Nëse gjatë importit (p.sh në nëntor 2005) jeni ngarkuar me akcizë ,e keni njohur si shpenzim ose e keni kalkuluar në çmimin e mallit , atëherë kur të këthehet kjo akcizë, duhet t'i bëni korrigjimet përkatëse.

Nëse akciza këthehet në të njëjtën periudhë tatimore kur është paguar (p.sh. në nëntor/2005 është paguar dhe në dhjetor /2005 është këthyer), atëherë ju mund ta bëni korrigjimin përkatës duke i regjistruar si të hyra apo stornuar (zvogëluar) shpenzimet. Nëse akciza këthehet në periudhën tjetër tatimore (p.sh. në nëntor/2005 është paguar dhe në janar /2006 është këthyer), korrigjimi duhet të bëhet duke i njohur si të hyra në periudhën tatimore 2006.

19. Te malli pa mbulesë (pa fatura), a pranohet Kosto e Mallit të Shitur ?

Përgjigje: Bazuar në nenin 7.2 të Rregullores Nr. 2004/51, nuk lejohet zbritje e shpenzimeve të pa dokumentuara, si dhe nuk pranohet KMSH e mallit pa faturë (pa mbulesë).

20. Kemi lidh një kontratë me një kompani të jashtme e cila do të na i kryen disa shërbime. Por, kjo kompani, nuk është e regjistruar në Kosovë.

Përgjigje: Kompania e jashtme duhet ta ketë të regjistruar një njësi të përhershme në Kosovë. Këtë, ju mund ta vërtetoni duke i kërkuar çertifikatën e regjistrimit të biznesit të cilën mund ta vërtetoni në adresën www.arbk.org

21. Ndërmarrja ka kontratë me një restorant, për ushqimin e punëtorëve . A pranohen shpenzimet e ushqimit të punëtorëve, si shpenzime të zbritshme në Tatimin në të Ardhurat e Korporatave?

Përgjigje: Po. Këto shpenzime do të pranohen si shpenzime të zbritshme për ndërmarrjen tuaj, kurse për restorantin si të hyra .

22. A pranohet tatimi në pronë si shpenzim i zbritshëm për Tatim në Fitim ose TAK?

Përgjigje: Tatimi në pronë, i paguar në emër të subjektit, pranohet si shpenzim i zbritshëm për Tatim në Fitim.

23. Pas përfundimit të TM4/2005, është vërejtur se obligimi ynë për TAK, për tërë periudhën 2005 është 4,200 €. Paradhënie kemi paguar nga 1,500 € x 3 = 4,500 € (TM1/05 = 1,500 €, TM2/05 = 1,500 € dhe TM3/05 = 1,500 € . Meqë, me tremujor, kemi paguar më shumë se që do të jetë obligimi tatimor për tërë periudhën 2005, a duhet të paguajmë për TM4/2005?

Përgjigje: Në zyre te shërbimit të tatimpaguesve apo në njërin nga bankat komerciale të licencuara nga AQBK-ja, duhet të dorëzoni Formularin “Pasqyrë e pagesës paradhënie për Korporatat e mëdha” për TM4/05, por nuk është e nevojshme të paguani, meqë me këstet e tremujorëve të mëparshme, ju keni paguar 4,500 € dhe obligimi për TAK sipas llogaritjeve tuaja do të jetë 4,200 € që d.m.th. se do të jeni në rimbursim për 300 € Rimbursimi do të vërehet me dorëzimin e deklaratës se TAK për periudhën tatimore 2005.

24. Subjekti jonë ka pasur statusin e biznesit individual dhe për periudhën tatimore 2002, 2003 dhe 2004 kemi qenë të regjistruar si obligues të Tatimit në Fitim, sipas Rregullores Nr. 2002/3. Gjatë kontrollës, në pajtim me ATK, subjekti është bërë obligues i Tatimit të Paragjykuar. Ju lutemi të me përgjigjeni, se akontacionet e paguara për Tatim në Fitim, a mund të barten në akontacione të paguara për Tatim të Paragjykuar, në mënyrë që të evitohen ndëshkimet dhe interesi për mos deklarim me kohë të TP?

Përgjigje: Nëse subjekti për periudhat 2002, 2003 dhe 2004 ka kaluar nga Tatimi në Fitim në Tatim të Paragjykuar, qoftë pa kontroll apo me kontroll, atëherë këstet e paguara për TF do të barten në tremujorët përkatës të TP dhe do të njihen si pagesa për TP, në datën në të cilën është paguar kësti (tremujori) për TF. Nëse pagesat për këstet e TF janë bërë brenda afatit dhe pas bartjes, mjaftojnë për t'i mbuluar tremujorët përkatës të TP-atëherë nuk do të ketë ndëshkime dhe interesi, e nëse nuk mjaftojnë atëherë do të ketë ndëshkime dhe interesi ashtu siç funksionon TP.

25. Subjekti jonë ka angazhuar një ekspert të jashtëm për të kryer shërbime punësimi në Kosovë. A pranohen pagesat e bëra për ekspertin e jashtëm, si shpenzime të zbritshme, për TAK.

Përgjigje: Paraprakisht, duhet të ndalni në burim dhe paguani tatimin në paga. Pastaj, bruto paga, do të pranohet si shpenzim i zbritshëm për TAK.

26. Nëse, gjatë vitit (periudhës tatimore), subjekti kalon nga subjekti i vogël në subjekt të madh, me qarkullim vjetor mbi 50,000€, a duhet të bëjë korigjimet e kësteve. Si të veprohet në këto raste?

Përgjigje: Subjekteve të vogla, që kalojnë në subjekte të mëdha, pagesat të bëra tremujore, automatikisht do të ju njihen si këste për biznese të mëdha, pas dorëzimit të deklaratës. Këto subjekte, nuk ka nevojë të bëjnë korigjime për transferime të pagesave tremujore.

27. Nuk disponojmë me dokumentacion përkatës për pajisje dhe makineri. A pranohet amortizimi i këtyre pajisjeve dhe makinerive?

Përgjigje: Bazuar në nenin 7 të Rregullores 2004/51, mbi Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, nuk lejohet zbritje për kurrfarë shpenzimesh, përveç nëse dokumentohet. .

28. Nga komuna, është bërë vlerësimi i objektit për tatim në pronë. A mund ta marrim vlerësimin e komunës si bazë për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit?

Përgjigje: Vlerësimi i komunës për tatimin në pronë nuk do të pranohet si bazë për llogaritjen e amortizimit.

29. TAK, për kompanitë e sigurimeve, a duhet të bëhet një vetëvlerësim, meqë dihet shuma e saktë e të ardhurave nga primi i shkruar bruto, pagesa e tatimit në fitim d.m.th 7% e primit bruto të shkruar. A duhet të paguhet aq sa është realisht apo të parashikohen të ardhurat?

Përgjigje: TAK për kompanitë e sigurimeve, paguhet 7% e premive për çdo tremujor. Edhe nëse ndodh ndonjë korigjim, duhet të bëhet në tremujorin të cilit i takon. Deklarata vjetore duhet të jetë totali i tremujorëve.

30. Një aset (mjet themelor) p.sh kamion, në librat kontabël ka vlerën 1,000€, mirëpo si pasojë e vjetërsisë dhe dëmtimeve, gjatë vitit 2005 është shitur me kg për 600 €. A pranohet diferenca prej 400 € si shpenzim i zbritshëm?

Përgjigje: Duhet të zvogëlohet grupi për 600€ dhe nuk njihet humbje (shpenzimi i zbritshëm), meqë i takon grupit të dytë ose të tretë, neni 19.8 i Rregullores Nr. 2004/51.

31. Banka ka realizuar të hyra nga interesi në mjetet e deponuara në një bankë tjetër vendore. Kush duhet ta paguajë këtë tatim?

Përgjigje: Banka e cila paguan interes, duhet të mbajë në burim dhe ta paguajë tatimin në interes prej 20%.

32. Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve gjatë vitit 2005, a do të pranohen plotësisht apo vetëm 5% të vlerës për riparim, pasi janë në grupin e II ?

Përgjigje: Shpenzimet e mirëmbajtjes do të pranohen si shpenzime vetëm 5% e vlerës neto të grupit dhe pjesa mbi 5% duhet të kapitalizohet. P.sh. nëse në fillim të vitit 2005, vlera neto e të gjitha mjeteve të grupit të dytë është 16,000 € dhe shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit për tërë grupin, janë bërë për 1,500 €. Atëherë vetëm 800 € ($16,000 \text{ €} \times 5\% = 800 \text{ €}$) do të pranohen si shpenzim, kurse pjesa tjetër prej 700 € ($1,500 \text{ €} - 800 \text{ €} = 700 \text{ €}$) do të kapitalizohet d.m.th. do t'i shtohet vlerës neto të mjeteve të grupit të dytë. Dhe do të kemi 16,700€ ($16,000\text{€} + 700\text{€}$) e cila shërben si bazë për amortizim.

33. Kompania jonë ka bërë ndërrimin e politikës kontabël nga ajo në baza të kesh-it në atë akruale dhe për këtë kemi bërë përshtatjen e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2003-2005. Në vitet 2003 dhe 2004, në bazë të SNK-it, kemi prekur kërkesat apo obligimet nga njëra anë dhe fitimin e mbajtur dhe tatimin në korporata nga ana tjetër. A mund, në tabelat rregulluese të vitit 2005, të paraqesim të ardhurat apo shpenzimet për të cilat, tanimë, është krijuar obligimi apo kërkesa e tatimit në korporata në vitin 2003 dhe 2004?

Përgjigje: Për vitin 2005, duhet të vazhdoni me përshtatjet, ashtu siç kërkohet në tabelat e rregullimeve. P.sh. të shpenzimet duhet të filloni nga vlera neto e mjeteve sipas tatimit, në fund të vitit 2004.

34. Për furnizim me mall nga subjekte të njohura në botën e jashtme, subjekti ynë ka bërë një marrëveshje me një subjekt ndërmjetësues i cili lidh kontrata për blerje të mallit si dhe siguron garancion bankar në emër të subjektit tonë. Për kryerjen e këtyre shërbimeve, ndërmjetësuesi na ngarkon me 10% të çmimit kushtues për mallin e blerë. Malli në doganë vjen në emër të subjektit tonë. Për shërbimet e kryera, ndërmjetësuesi, pas arritjes së mallit, na dërgon faturën e shërbimeve e cila nuk ka hyrë në procedurën doganore.

Përgjigje: Nëse ndërmjetësuesi është vendor, atëherë të ndërmjetësuesi paraqiten si të hyra, kurse të ju do të njihen si shpenzime. Nëse ndërmjetësuesi është jo rezident, atëherë të zbatohet neni 27 i Rregullores Nr. 2004/51 dhe duhet të ndalet në burim 20% e provizionit (interesi).

35. Për kontrollimin e tatimit në fitim për periudhën prej 01.04.2002 deri 31.12.2002 Administrata Tatimore, gjatë kontrollës, a duhet të verifikojë të hyrat dhe shpenzimet prej 01.01.2002 deri më 31.12.2002. TVSh-ja ka qenë lëndë kontrolli për vitin 2002, gjatë vitit 2003. Një transaksion (qarkullim) i takon vitit 2001, por gabimisht është fut në shitje të muajit janar 2002. Si trajtohet ky moment për tatimin në fitim për vitin 2002?

Përgjigje: Duhet të verifikohen të hyrat dhe shpenzimet për tërë vitin 2002 dhe në fund përdoret koeficienti 75%. Transaksioni që është fut gabimisht në shitje në një periudhë tjetër tatimore, duhet të korrigjohet dhe të bartet në periudhën, të cilës i përket. Gjithashtu, korrigjohet edhe periudha në të cilën është futur gabimisht.

36. Mulliri elektrik krijon të hyra nga ujemi që bluan për qytetarët. I njëjti ujem, kur të bluhet dhe shitet si miell dhe krunde, prapë krijohet e hyra por e shtuar si prodhim i gatshëm. A mund të regjistrohen dy të hyra në librin e shitjes apo vetëm e hyra nga shitja e miellit dhe krundeve, sepse kemi dyfishim të të hyrave?

Përgjigje: Ujemi i marr për bluarje, regjistrohet në shitje dhe në blerje. Pastaj, prodhohet mielli dhe krundet. Pas shitjes së miellit dhe krundeve do të regjistrohet në shitje, kurse ujemi i marr gjatë bluarjes do të pranohet si shpenzim (Kosto e Mallit të Shitur). Në këtë rast, nuk kemi dyfishim të të hyrave sepse ujemi i regjistruar në blerje është marr si shpenzim (KMSH).

SHEMBUJ **PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE**

1. Mbajtja në burim dhe pagesës së tatimit për dividend, interes, të drejta pronësore, qira dhe fitore në lotari.

SHEMBULL:

Banka XYZ sh. p. k. gjatë Marsit 2006, ka paguar interes prej 12,000 € Ka ndaluar në burim dhe ka paguar tatimin në interes prej 20% ($12,000 \text{ €} \times 20\% = 2,400 \text{ €}$)
Ka paguar dividend prej 5,000€ dhe ka ndal në burim tatimin në dividend prej 20% ($5,000 \text{ €} \times 20\% = 1,000 \text{ €}$)

Për objektin e marr me qira prej muajit Mars, Banka XYZ paguan 2,600 € në muaj (d.m.th. edhe për mars/2006) dhe ka mbajtur në burim tatimin në qira prej 16% ($2,600 \text{ €} \times 16\% = 416 \text{ €}$).

Deri më 15.04.2006, banka duhet të dorëzojë:

Pasqyrën mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, dividend, të drejta pronësore, qira dhe fitore në lotari.



PASQYRA MUJORE E MBAJTJES NË BURIM DHE PAGESËS SË TATIMIT NË INTERES, DIVIDEND , TË DREJTA PRONËSORE, QIRA, FITORE NË LOTARI DHE LOJRA TË FATIT

[1] Periudha e Dorëzimit:	MARS/2006	[2] Nr. Serial:	[2] WR
---------------------------	------------------	-----------------	--------

[3] Numri i Regjistrimit të Mbjtësit në Burim:	7	0	2	5	6	1	4	6		
--	---	---	---	---	---	---	---	---	--	--

[4] Emri i Mbjtësit	[4] BANKA XYZ Shpk
---------------------	---------------------------

[5] Adresa e mbajtësit (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)	[5] Deshmoret e Kombit Nr. 12 Prishtine
--	--

		Telefoni	
--	--	----------	--

[6] Emri i Personit të Kontaktit	[6]	Telefoni	
----------------------------------	-----	----------	--

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.

Shtesë Korrigjim Vetëm pagesë

a. Tatimi i mbajtur në burim në interes, dividendë, të drejta pronësore dhe marrjet ne lotari

[8] Interesi bruto i paguar për muajin -----	[8] 12,000 €	
[9] Dividenti bruto i paguar për muajin -----	[9] 5,000 €	
[10] Të drejtat pronësore të paguara për muajin (vetëm joindividëve)	[10]	
[11] Fitoret në lotari bruto të paguara për muajin (vetëm individëve)	[11]	
[12] Shuma totale e paguar për muajin [12]=[8]+[9]+[10]+[11]	[12] 17,000 €	
[13] Tatimi i mbajtur në burim përveç qirasë [13]=[12] x 20% -----	[13] 3,400 €	

b. Tatimi i mbatur në burim mbi qiratë

[14] Qiraja bruto e paguar për muajin -----	[14] 2,600 €	
[15] Tatimi i mbajtur në burim mbi qiratë e paguara [15]=[14] x16% (vetëm qiramarresit jo -individualë) -----	[15] 416 €	
[16] Tatimi total i mbajtur në burim [16]=[15]+ [13]-----	[16] 3,816 €	

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta. Emri/Mbimri/Nënshkrimi dhe vula (_____)	dd/mm/vv ____/____/____
---	-----------------------------------

Pjesa e bankës		
<i>Nënshkrimi dhe vula</i> _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	[17] Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

Udhëzimet për plotësimin e Pasqyrës mujore të mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, dividend, qira dhe fitore në lotari

Kutia [1] Vendos periudhën e deklarimit, p.sh. Mars 2006

Kutia [2] Numri serik në kutinë [2] do të jetë paraprakisht i shtypur prandaj mos shkruani në atë kuti

Kutia [3] Vendos numrin e regjistrimit të mbajtësit në burim, p.sh. 70256146

Kutia [4] Vendos emrin e mbajtësin në burim, p.sh. Banka XYZ

Kutia [5] Vendos adresën e mbajtësit, p.sh. Rr. Dëshmorët e Kombit , Nr. 12, Prishtinë

Kutia [6] Vendos emrin e personit konATKtues dhe numrin e telefonit të këtij personi

Kutia [7] Nëse nuk po e dorëzon për herë të parë në atë muaj këtë pasqyrë mund të vendosësh një X në një prej dy kutive:

Shtesë – nënkupton deklarim shtesë brenda të njëjtit muaj.

Korrigjim – nënkupton kur dëshiron të ndryshosh të dhënat e deklaruar më parë për atë muaj kalendarik.

Vetëm pagesë – nënkupton se dëshironi të bëni pagesë shtesë pa ndryshuar ndonjë prej të dhënave të mëhershme që janë deklaruar për të njëjtin muaj kalendarik

Kutia [8] Vendos interesin bruto të paguar për muaj, p.sh. 12,000 €

Kutia [9] Vendos dividendët e paguar për muajin, p.sh. 5,000 €

Kutia [10] Vendos të drejtat pronësore të paguara vetëm organizatave biznesore, p.sh. 0€

Kutia [11] Vendos fitoret në lotari të paguara vetëm individëve, p.sh. 0 €

Kutia [12] Mblidh shumat e vendosura ne kutinë 8, 9, 10 dhe 11, p.sh. 17,000 €

Kutia [13] Vendos shumën e tatimit të mbajtur në burim mbi shumën totale të paguar në
Kutia [12] Duhet të jetë 20% e shumës në kutinë [12], p.sh. $17,000 \text{ €} \times 20\% = 3,400 \text{ €}$

Kutia [14] Vendos shumën e qirasë së paguar qiradhënësve për muajin, p.sh. 2,600 €

Kutia [15] Vendos shumën e tatimit të mbajtur në burim mbi qiratë e paguara (meqë ju përfaqësoni një jo-individ). Duhet të jetë 16% e shumës së vendosur në kutinë [14], p.sh. $2,600 \text{ €} \times 16\% = 416 \text{ €}$.

Kutia [16] Mblidh shumën e vendosur në kutinë [13] dhe kutinë [15], p.sh.
 $3,400 \text{ €} + 416 \text{ €} = 3,416 \text{ €}$

Pasqyra duhet të nënshkruhet dhe t'i vihet data nga mbajtësi në burim ose një person i caktuar nga ai, të dorëzohet në bankë në afat deri në 15 ditë, pas përfundimit të muajit kur pagat janë paguar dhe tatimi është mbajtur në burim.

2. Pagesat paradhënie tremujore për veprimtaritë e bizneseve të vogla

Në përputhje me Nenin 31.2 (a) dhe (b) të Rregullores, tatimpaguesit me të ardhura bruto më pak se 5,000 € dhe ata të cilët nuk zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare, do të dorëzojnë një Pasqyrë Tremujore të Pagesës Paradhënie në një nga bankat e autorizuara më ose para 15 Prillit, 15 Korrikut, 15 Tetorit dhe 15 Janarit, në lidhje me tremujorët kalendarikë që u paraprijnë këtyre datave menjëherë.

Pasqyra Tremujore e Paradhënies është përgatitur në tri kopje origjinale. Kopja e parë dhe e dytë mbetet në bankë, ndërsa e treta i këthehet tatimpaguesit, pasi të jetë vulosur nga banka. Formulari i Pasqyrës Tremujore të Pagesës Paradhënie së bashku me udhëzimet për plotësim janë dhënë më poshtë:

SHEMBULLI A:

Nëse Qarkullimi vjetor i personit juridik është nën 5000€

Sh.p.k. "AGIMI" është themeluar në shkurt të vitit 2006. Gjatë këtij viti, nuk do të kalojë qarkullimin prej 5,000 €. Prandaj, çdo tremujor duhet të dorëzojë dhe duhet të paguajë 37.50€

Për këtë tremujor, prej kur është themeluar e deri në fund të marsit 2006, ka realizuar qarkullim prej 800 €

Prej muajit Shkurt ka lëshuar me qira, një lokal afarist (zyre) një biznesi individual me pagesë prej 100€ për çdo muaj. Biznesi individual nuk mban në burim tatimin në qira.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
 MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
 MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



**PASQYRA TREMUJORE E PAGESËS PARADHËNIE PËR
 KORPORATAT E VOGLA**

[1] Periudha e deklarimit : **TM1/ 2006** [2] Nr. Serik: **[2] QS**

[3] Numri i regjistrimit të biznesit **7 0 6 5 3 2 1 6**

[4] Emri i biznesit [4] **AGIMI shpk**

[5] Adresa e biznesit [5] **Rruga "QLIRIMI" Nr.68 Prishtine**
 (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit) Telefoni

[6] Emri i personit kontaktues [6] Telefoni

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.
 Shtesë Korrigjim Vetëm pagesë

[8] Shitjet bruto për tremujor [8] **800 €**
 (Kjo e dhënë është e përbashkët për të gjitha kategoritë e fituesve të të ardhurave nga biznesi)

I. Tatimpaguesit me arkëtime bruto vjetore më pak se 5,000 euro

[9] Vendos 37,5 euro në kutinë [9] **37.50 €**

II. Tatimpaguesit me arkëtime bruto vjetore prej 5,000.01-50,000 euro të cilët zgjedhin të paguajnë në „mënyrë të paragjykuar“. (Nëse duan të tatohen mbi të ardhurat neto, duhet të plotësojnë Pasqyrën Tremujore Paradhënie për Korporatat e Mëdha)

[10] Pagesa paradhënie [10]=[8] x 3% (shitje me pakicë, prodhim, tregti, transport, bujqësi, veprimtari tjera komerciale) [10]

[11] Pagesa paradhënie [11]=[8] x 5% (profesionale, specialitete, zbatimje, veprimtari tjera shërbyese) [11]

III. Tatimpaguesit të cilët realizojnë të Ardhura nga Qiraja

[12] Të ardhurat bruto nga qiraja [12] **200 €**

[13] Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja [13]=[12] x 16% [13] **32.00 €**

[14] Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja të mbajtur nga të tjerët [14]

[15] Tatimi final mbi të ardhurat nga qiraja [15]=[13]-[14] [15] **32.00 €**

[16] Totali i tatimit që do të paguhet me këtë pasqyrë [16]=[9]+[15] ose [10] +[15] ose [11]+[15] ose [10+11+15] [16] **69. 50 €**

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.
 Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula

dd/mm/vv

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula	Numri i llogarisë: 1000420070000373	Shuma e tatimit të paguar €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

Udhëzimet në plotësimin e Pasqyrës Tremujore të Pagesës Paradhënie për Korporatat e Vogla

- Kutia [1]** Vendos periudhën tatimore për të cilën pasqyra është dorëzuar, p.sh. TM/1 2006
- Kutia [2]** Numri serik i pasqyrës do të jetë i para printuar, ndaj mos shëno në kutinë [2]
- Kutia [3]** Vendos numrin e regjistrimit të biznesit, p.sh, 70653216
- Kutia [4]** Vendos emrin e organizatës biznesore, p.sh, Sh.p.k “AGIMI”
- Kutia [5]** Shkruaj adresën e organizatës biznesore, p.sh ‘ÇLIRIMI” Nr 68 Prishtine dhe numrin e telefonit të biznesit
- Kutia [6]** Vendos emrin e personit kontaktues dhe jep numrin e telefonit të këtij personi
- Kutia [7]** Në kutinë [7], nëse nuk po e dorëzon për herë të parë në atë muaj këtë pasqyrë, mund të vendosësh një X në një prej këtyre kutive:

Shtesë – nënkupton deklaram shtesë brenda të njëjtit muaj.

Korrigjim – nënkupton kur dëshiron të ndryshosh të dhënat e deklaruara më parë për atë muaj kalendarik.

Vetëm pagesë – nënkupton se dëshironi të bëni pagesë shtesë pa ndryshuar ndonjë prej të dhënave të mëhershme që janë deklaruar për të njëjtin muaj kalendarik.

- Kutia [8]** Vendos të ardhurat bruto për tremujor në kutinë [8] p.sh 800 €
- Kutia [9]** Nëse arkëtimet vjetore bruto janë nën 5,000 € vendos 37.5 € në kutinë [9]
- Kutia [10]** Nëse jeni të përfshirë në tregti, shitje me pakicë, prodhimtari, transport, bujqësi dhe veprimtari tjera komerciale, shumëzo shumën e vendosur në kutinë [8] me 3% dhe vendos rezultatin në kutinë [10]
- Kutia [11]** Nëse jeni të përfshirë në shërbime profesionale, specializuese, zbavitëse dhe veprimtari shërbyese tjera shumëzo shumën e vendosur në [8] me 5% dhe vendose rezultatin në kutinë [11]
- Kutia [12]** Vendos të ardhurat bruto nga qiraja në kutinë P.sh 200 €për këtë tremujor. [12] (100 €për shkurt plus 100 €për mars.)
- Kutia [13]** Shumëzo shumën në [12] me 16% dhe vendose rezultatin në kutinë në këtë rast 32.00 €[13]
- Kutia [14]** Vendos shumën e tatimit të mbajtur në burim nga të tjerët mbi të ardhurat nga qiraja në kutinë 14. Në këtë rast nuk ka, pasi biznesi individual nuk ndal në burim tatimin e qirasë.
- Kutia [15]** Zbrite shumën e tatimit të mbajtur në burim nga të tjerët si është treguar në kutinë [14] nga shuma e tatimit të treguar në kutinë [13] dhe vendose rezultatin në kutinë [15]. Në këtë rast 32.00 €
- Kutia [16]** Nëse keni të ardhura të shumëfishta nga aktivitetet afariste dhe qiraja, atëherë mblihdh një nga shumat e treguara në [9] [10] ose [11] me shumën e treguar në [15] dhe vendose rezultatin në kutinë [16]. Në këtë rast 69.50 €

Pasqyra duhet të nënshkruhet dhe t’i vihet data nga individi apo personi i caktuar nga ai dhe të dorëzohet në bankë deri në 15 ditë pas përfundimit të tremujorit kalendarik

Leni të zbrazët informatat e bankës për pagimin që t’i plotësojë arkëtari i bankës.

SHEMBULLI B:**Nëse Qarkullimi vjetor i personit juridik është prej 5,000 € deri në 50,000€**

Sh.p.k. "BESA" është themeluar në janar të vitit 2006 dhe ka NRB 70865432. Gjatë këtij viti parasheh se do të ketë qarkullim nën 50,000€

Gjatë periudhës janar - mars 2006, ka bërë qarkullim prej 8,000 € (6,000 € tregti dhe 2,000 € shërbime.)

Prej muajit shkurt e deri në dhjetor ka lëshuar dy lokale afariste me qira :

- njëri lokal afarist (zyre) me qira një biznesi individual me pagesë prej 200 € në muaj
- tjetri lokal afarist (zyre) me qira një personi juridik (OJQ) me pagesë prej 300 € në muaj.

Biznesi individual nuk e mban në burim tatimin në qira, kurse OJQ si person juridik e mban në burim tatimin në qira dhe e paguan për çdo muaj. $(300 \text{ €} \times 2 \text{ muaj} = 600 \text{ €} \times 16\% = 96 \text{ €})$



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
 MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
 MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



PASQYRA TREMUJORE E PAGESËS PARADHËNIE PËR KORPORATAT E VOGLA

[1] Periudha e deklarimit :	TM1/ 2006	[2] Nr. Serik:	[2] QS
-----------------------------	------------------	----------------	---------------

[3] Numri i regjistrimit të biznesit	7 0 8 6 5 4 3 2
--------------------------------------	------------------------

[4] Emri i biznesit	[4] BESA shpk
---------------------	----------------------

[5] Adresa e biznesit (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)	[5] Rruga "nena Tereze" NR.84 Prishtine	Telefoni	
---	--	----------	--

[6] Emri i personit kontaktues	[6]	Telefoni	
--------------------------------	------------	----------	--

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.

Shtesë Korrigjim Vetëm pagesë

[8] Shitjet bruto për tremujor
 (Kjo e dhënë është e përbashkët për të gjitha kategoritë e fituesve të të ardhurave nga biznesi)

[8]	8,000€
-----	---------------

I. Tatimpaguesit me arkëtime bruto vjetore më pak se 5,000 euro

[9] Vendos 37,5 euro në kutinë [9]

[9]	
-----	--

II. Tatimpaguesit me arkëtime bruto vjetore prej 5,000.01-50,000 euro të cilët zgjedhin të paguajnë në „mënyrë të paragjykuar“. (Nëse duan të tatohen mbi të ardhurat neto, duhet të plotësojnë Pasqyrën Tremujore Paradhënie për Korporatat e Mëdha)

[10] Pagesa paradhënie [10]=[8] x 3% (shitje me pakicë, prodhim, tregti, transport, bujqësi, veprimtari tjera komerciale)

[10]	180 €
------	--------------

[11] Pagesa paradhënie [11]= [8] x 5% (profesionale, specialitete, zbatimje, veprimtari tjera shërbyese)

[11]	100 €
------	--------------

III. Tatimpaguesit të cilët realizojnë të Ardhura nga Qiraja

[12] Të ardhurat bruto nga qiraja

[12]	1000 €
------	---------------

[13] Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja [13]=[12] x 16%

[13]	160 €
------	--------------

[14] Tatimi mbi të ardhurat nga qiraja të mbajtur nga të tjerët

[14]	96 €
------	-------------

[15] Tatimi final mbi të ardhurat nga qiraja [15]=[13]-[14]

[15]	64 €
------	-------------

[16] Totali i tatimit që do të paguhet me këtë pasqyrë [16]=[9]+[15] ose [10] +[15] ose [11]+[15] ose [10+11+15]

[16]	344 €
------	--------------

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.
 Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula

dd/mm/vv
 ____/____/____

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

Udhëzimet në plotësimin e Pasqyrës Tremujore të Pagesës Paradhënie për Korporatat e Vogla

- Kutia [1]** Vendos periudhën tatimore për të cilën pasqyra është dorëzuar, p.sh. TM/1 2006
- Kutia [2]** Numri serik i pasqyrës do të jetë i paraprintuar, kështu që mos shëno në kutinë [2]
- Kutia [3]** Vendos numrin e regjistrimit të biznesit, p.sh, NRB 70865432
- Kutia [4]** Vendos emrin e organizatës biznesore, p.sh, Sh.p.k. “BESA”
- Kutia [5]** Shkruaj adresën e organizatës biznesore, p.sh ‘Nëna Tereze’ Nr 84 Prishtinë dhe numrin e telefonit të biznesit
- Kutia [6]** Vendos emrin e personit kontaktues dhe jep numrin e telefonit të këtij personi
- Kutia [7]** Në kutinë [7], nëse nuk po e dorëzon për herë të parë në atë muaj këtë pasqyrë mund të vendosësh një X në një prej këtyre kutive:

Shtesë – nënkupton deklaram shtesë brenda të njëjtit tremujor.

Korrigjim – nënkupton kur dëshiron të ndryshosh të dhënat e deklaruara më parë për atë tremujorë.

Vetëm pagesë – nënkupton se dëshironi të bëni pagesë shtesë pa ndryshuar ndonjë prej të dhënave të mëhershme që janë deklaruar për të njëjtin tremujor.

- Kutia [8]** vendos të ardhurat bruto për tremujor në kutinë [8]. Në këtë rast 8,000 €
- Kutia [9]** Nëse arkëtimet vjetore bruto janë nën 5,000 € vendos 37.5 € në kutinë [9]
- Kutia [10]** Nëse jeni të përfshirë në tregti, shitje më pakicë, prodhimtari, transport, bujqësi dhe veprimtari tjera komerciale shumëzo shumën e vendosur në kutinë [8] me 3% dhe vendos rezultatin në kutinë [10] Rasti ynë $6,000 \text{ €} \times 3 = 180 \text{ €}$
- Kutia [11]** Nëse jeni të përfshirë në shërbime profesionale, specializuese, zbavitëse dhe veprimtari shërbyese tjera shumëzo shumën e vendosur në [8] me 5% dhe vendose rezultatin në kutinë [11] Rasti ynë $2,000 \text{ €} \times 5\% = 100 \text{ €}$
- Kutia [12]** Vendos të ardhurat bruto nga qiraja në kutinë [12] për këtë tremujor. Rasti ynë $(200 \text{ €} \times 2 \text{ muaj}) + (300 \text{ €} \times 2 \text{ muaj}) = 400 \text{ €} + 600 \text{ €} = 1,000 \text{ €}$ të ardhurat bruto nga qiraja. **Kutia [13]** Shumëzo shumën në [12] me 16% dhe vendose rezultatin në kutinë [13]. Rasti ynë $1,000 \text{ €} \times 16\% = 160 \text{ €}$
- Kutia [14]** Vendos shumën e tatimit të mbajtur në burim nga të tjerët mbi të ardhurat nga qiraja në kutinë [14]. Rasti ynë $600 \text{ €} \times 16\% = 96 \text{ €}$
- Kutia [15]** Zbrite shumën e tatimit të mbajtur në burim nga të tjerët si është treguar në kutinë [14]. Nga shuma e tatimit të treguar në kutinë [13] dhe vendose rezultatin në kutinë [15] Rasti ynë $160 \text{ €} - 96 \text{ €} = 64 \text{ €}$
- Kutia [16]** Nëse keni të ardhura të shumëfishta nga aktivitetet afariste dhe qiraja, atëherë mblihdh një nga shumat e treguara në [9], [10] ose [11] me shumën e treguar në [15] dhe vendose rezultatin në kutinë [16] Rasti ynë $180 \text{ €} + 100 \text{ €} + 64 \text{ €} = 344 \text{ €}$

Pasqyra duhet të nënshkruhet dhe t’i vihet data nga individi apo një person i caktuar nga ai dhe të dorëzohet në bankë deri në 15 ditë pas përfundimit të tremujorit kalendarik

Informatat e bankës për pagim leni të zbraza, që t’i plotësojë arkëtari i bankës.

3. Pagesat paradhënie tremujore për veprimtaritë e bizneseve të mëdha

Në përputhje me Nenin 31.2.(c) të Rregullores, tatimpaguesit me të ardhura bruto prej 50,000 euro e më tepër dhe ata që zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare, kërkohet të dorëzojnë një Pasqyrë Tremujore të Pagesës Paradhënie në një nga bankat e autorizuara më ose para 15 Prillit, 15 Korrikut, 15 Tetorit dhe 15 Janarit, në lidhje me tremujorët kalendarik që u paraprijnë këtyre datave. Pasqyra Tremujore e Paradhënies është përgatitur në tri kopje origjinale.

Kopja e parë dhe e dytë mbetet në bankë ndërsa e treta i këthehet tatimpaguesit pasi të jetë vulosur nga banka. Formulari i Pasqyrës Tremujore të Pagesës Paradhënie, së bashku me udhëzimet për plotësim, janë dhënë më poshtë:

SHEMBULL

Subjekti afarist “ Përparimi” Sh.p.k. me NRB 72456123 është regjistruar në janar të vitit 2006.

Sipas planit të biznesit do të ketë:

Të hyrat e tatueshme	120,000 €
Shpenzime të zbritshme	100,000 €
Fitimi i Tatueshëm	20,000 €
Tatimi në fitim 20%	4,000 €

Meqenëse është viti i parë, atëherë ky subjekt paguan në bazë të të ardhurave reale

Për çdo tremujor të vitit 2006, do të dorëzojë Pasqyrë tremujore të pagesës për korporatat e mëdha dhe do të paguajë nga 1,000 €

Ky biznes, për paratë që ka në bankë, ka të hyra nga interesi prej janarit për çdo muaj nga 800€ dhe banka për çdo muaj i ndal në burim tatimin në interes prej 160 € D.m.th. për tre muaj do të kemi:

$$(800 \text{ €} \times 3 \text{ muaj}) \times 20\% = 2400 \text{ €} \times 20\% = 480 \text{ €}$$



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



PASQYRA TREMUJORE E PAGESËS PARADHËNIE PËR KORPORATAT E MËDHA

[1] Periudha e deklarimit :	TM1/ 2006	[2] Nr. Serik:	[2] QL
-----------------------------	------------------	----------------	---------------

[3] Numri i regjistrimit të biznesit	7	2	4	5	6	1	2	3
--------------------------------------	---	---	---	---	---	---	---	---

[4] Emri i biznesit	[4] PERPARIMI Shpk
---------------------	---------------------------

[5] Adresa e biznesit (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)	[5]	Telefoni	
---	-----	----------	--

[6] Emri i personit kontaktues	[6]	Telefoni	
--------------------------------	-----	----------	--

[7] Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.

<input type="checkbox"/> Shtesë	<input type="checkbox"/> Korrigjim	<input type="checkbox"/> Vetëm pagesë
---------------------------------	------------------------------------	---------------------------------------

Opcioni A, bazuar në parashikimin e detyrimit tatimor të këtij vitit	Pika	Tatimi
[8] Të ardhurat e parapara për Periudhën Tatimore pjesëtuar me 4.....	[8] 30,000 €	
[9] Shpenzimet e parapara për Periudhën Tatimore pjesëtuar me 4.....	[9] 25,000 €	
[10] Fitimi i paraparë për periudhën Tatimore pjesëtuar me 4, [10]=[8]-[9] (Nëse është negative vendos 0)	[10] 5,000 €	
[11] Kësti për tremujor [10] x 20% (Nëse është negative vendos 0)		[11] 1,000 €

Opcioni B, bazuar në detyrimin tatimor të vitit të mëparshëm	Pika	Tatimi
[12] 110% e detyrimit tatimor të vlerësuar për vitin e kaluar pjesëtuar me 4		[12]
[13] Pagesa e këstit që paguhet me këtë formular (Vendos shumën në [11] ose [12])		[13] 1,000 €
[14] Tatimi i mbajtur në burim mbi dividendat, interesin, të drejtat pronësore dhe qiraja nga paguesit rezidente		[14] 480 €
[15] Pagesa totale me këtë formular [15]=[13]- [14]		[15] 520 €

(Pjesa vijuese të plotësohet vetëm nga Kompanitë e Sigurimeve)	Pika	Tatimi
[16] Primet bruto për tremujor		[16]
[17] Kësti për tremujor [16] x 7%		[17]
[18] Tatimi i mbajtur në burim mbi dividendët, interesin, të drejtat pronësore dhe qiraja nga paguesit rezidente		[18]
[19] Pagesa totale me këtë formular [19]=[17]- [18]		[19]

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta.
Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula
(_____)

dd/mm/vv
____/____/____

Pjesa e bankës		
Nënshkrimi dhe vula _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

Udhëzimet në plotësimin e Pasqyrës Tremujore të Pagesës Paradhënie për Korporatat e Mëdha

- Kutia [1]** Vendos periudhën tatimore për të cilën pasqyra është dorëzuar, p.sh. TM/1. 2006
- Kutia [2]** Numri serik i pasqyrës do të jetë i paraprintuar, kështu që mos shëno në kutinë [2]
- Kutia [3]** Vendos numrin e regjistrimit të organizatës biznesore, p.sh, 72456123
- Kutia [4]** Vendos emrin e organizatës biznesore, p.sh, ‘PERPARIMI’ Sh.p.k
- Kutia [5]** Shkruaj adresën e organizatës biznesore, si dhe numrin e telefonit të biznesit
- Kutia [6]** Vendos emrin e personit kontaktues dhe jep numrin e telefonit të këtij personi
- Kutia [7]** Në kutinë [7], nëse këtë pasqyrë nuk po e dorëzon për herë të parë në atë muaj, mund të vendosësh një X në një prej tre kutive:

Shtesë – nënkupton deklaram shtesë brenda të njëjtit tremujor.

Korrigjim – nënkupton kur dëshiron të ndryshosh të dhënat e deklaruara më parë për atë tremujorë.

Vetëm pagesë – nënkupton se dëshironi të bëni pagesë shtesë pa ndryshuar ndonjë prej të dhënave të mëhershme që janë deklaruar për të njëjtin tremujor.

- Kutia [8]** Vendos të Ardhurat e Parapara për periudhën tatimore pjesëtuar me 4. Rasti ynë 30,000 €
- Kutia [9]** Vendos Shpenzimet e Parapara për periudhën tatimore pjesëtuar me 4. Rasti ynë 25,000 €
- Kutia [10]** Vendos Fitimin e Paraparë për periudhën tatimore pjesëtuar me 4. Rasti ynë 5,000 €
- Kutia [11]** Llogarit këstin e paraparë duke e shumëzuar shumën e vendosur në [10] me 20%. Rasti ynë $5,000 \text{ €} \times 20\% = 1,000 \text{ €}$
- Kutia [12]** Nëse nuk jeni të siguritë në parashikimet tuaja dhe nëse keni një vit të kaluar të veprimtarisë në historinë e biznesit tuaj me qëllim të shmangies së ndonjë ndëshkimi dhe interesi për pagesat e pamjaftueshme, ju mund të vendosni në kutinë [12] 110% të tatimit të vlerësuar për vitin e kaluar pjesëtuar me 4.
- Kutia [13]** Vendos shumën e këstit që paguani me këtë formular, duhet të jetë ose njëra ose tjetra e vendosur në kutinë [11] ose [12] . Në këtë rast 1,000 €
- Kutia [14]** Vendos shumën e tatimit që është mbajtur në burim mbi të ardhurat tuaja nga dividendët, interesi, të drejtat pronësore dhe qiraja nga mbajtësit rezident. $2,400 \text{ €} \times 20\% = 480 \text{ €}$
- Kutia [15]** Vendos ndryshimin në mes [11]-[14]ose[13] –[14] dhe vendos rezultatin në kutinë [15]. Në këtë rast $1,000 \text{ €} - 480 \text{ €} = 520 \text{ €}$
- Kutia [16]** Kjo kuti është në dispozicion vetëm për kompanitë e sigurimeve. Vendos, në këtë kuti, primet bruto për tremujor.
- Kutia [17]** Vendos shumën e tatimit me [16] x 7% në kutinë [17]
- Kutia [18]** Vendos shumën e tatimit që është mbajtur në burim mbi të ardhurat tuaja nga dividendët, interesi, të drejtat pronësore dhe qiraja nga mbajtësit rezident për këtë tremujor
- Kutia [19]** Vendos ndryshimin në mes kutive [17] –[18] në kutinë [19]

Pasqyra duhet të nënshkruhet, t’i vihet data nga individi apo një person i caktuar nga ai dhe të dorëzohet në bankë deri në 15 ditë pas përfundimit të tremujorit kalendarik.

Leni të zbrazët informatat e bankës për pagimin që t’i plotësojë arkëtari i bankës.

4. Obligimi tatimor për TAK sipas Deklaratës përfundimtare dhe Pagesa e kësteve të TAK për vit in e ardhshëm

Pas përfundimit të periudhës tatimore 2006, afati për dorëzimin e Deklaratës së TAK për 2006 është prej 01.01.07 e deri më 01.04.2007 .

Me deklaratë përfundimtare të TAK do të dihet sakt obligimi tatimor vjetor për TAK.

a) Nëse obligimi për TAK për periudhën tatimore 2006 është	4,300 €
Pagesa e kësteve për TAK për periudhën tatimore 2006	4,000 €
Duhet të paguhet me deklaratë për periudhën tatimore 2006	300 €

Në këtë rast, nuk do të ketë ndëshkime pasi që është paguar mbi 90% e obligimit për TAK për periudhën tatimore 2006. $(400/4, 300) \times 100 = 93.02\%$.

Pagesat e kësteve të TAK për vitin 2007

Për vitin e ardhshëm 2007, nëse subjekti për pagesën e kësteve të TAK për 2007 bazohet në vitin e kaluar 2006, ku obligimi vjetor për TAK për 2006 është 4,300 €, atëherë pagesat e kësteve për 2007 duhet të jenë 10% më shumë se sa obligimi tatimor për 2006.

D.m.th. për çdo këst duhet të paguaj nga 1,182.5€

$$\begin{aligned} \text{Llogaritjet: } 4,300\text{€} \times 110\% &= 4,730 \text{ €} \\ 4,730 \text{ €} / 4 &= 1,182.5\text{€} \end{aligned}$$

b) Nëse obligimi për TAK për periudhën tatimore 2006 është	3,800 €
Pagesa e kësteve për TAK për periudhën tatimore 2006	4,000 €
Tatimi i paguar tepër për TAK për periudhën tatimore 2006	200 €

Tatimi i paguar tepër prej 200 € për TAK për periudhën tatimore 2007, pas verifikimeve përkatëse, mund të rimbursohet duke i kërthyer në llogari përkatëse të subjektit apo mund të përdoret për mbulimin e ndonjë obligimi për cilindo tatim tjetër.

Pagesat e kësteve të TAK për vitin 2007

Për vitin e ardhshëm 2007, nëse subjekti për pagesën e kësteve të TAK bazohet në vitin e kaluar 2006, ku obligimi vjetor për TAK për 2006 është 3,800 €, atëherë pagesat e kësteve për 2007 duhet të jenë 10% më shumë se sa obligimi tatimor për 2006

D.m.th. për çdo këst duhet të paguaj nga 1,045 €

$$\begin{aligned} \text{Llogaritjet: } 3,800 \text{ €} \times 110\% &= 4,180 \text{ €} \\ 4,180 \text{ €} / 4 &= 1,045 \text{ €} \end{aligned}$$

c) Nëse obligimi për TAK për periudhën tatimore 2006 është 0 (pasi që subjekti është në humbje)

Pagesa e kësteve për TAK për periudhën tatimore 2006	4,000 €
Tatimi i paguar tepër për periudhën tatimore 2006	4,000 €

Pagesat e kësteve të TAK për vitin 2007

Për vitin e ardhshëm 2007, bazuar në vitin e kaluar, subjekti nuk është i obliguar që të paguajë këste për TAK, pasi që gjatë vitit 2006 ka qenë në humbje. Por, me deklaratë përfundimtare të vitit 2007, nëse del detyrim tatimor, duhet të paguajë.

SQARIMET PËR LLOGARITJEN E GJOBAVE DHE INTERESAVE PËR PAGESË TË PAMJAFTUESHME TË KËSTEVE TË TATIMT NË FITIM PËR PERIU DHËN TATIMORE 2004

Sipas sqarimeve dhe interpretimeve të mëposhtme Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) bën llogaritjen e gjobave dhe intereseve për pagesë të pamjaftueshme të kësteve të Tatimit në Fitim për periudhat tatimore 2002, 2003 dhe 2004, bazuar në Nenin 29.1 dhe 29.5 të Rregullores Nr. 2002/3 mbi Tatimin në Fitim në Kosovë.

Sipas **Nenit 29.1** të Rregullores Nr. 2002/3 mbi Tatimin në Fitim

- Këstet duhet të paguhen brenda datës 15 të muajit që pason fundin e tremujorit
- Kësti i detyruar për t'u paguar është $\frac{1}{4}$ e detyrimit tatimor për periudhën.
- për çdo tremujor, kësti mund të paguhet :
 - ose bazuar në periudhën e mëparshme tatimore
 - ose bazuar në fitimin e parashikuar për periudhën tatimore

Sipas **Nenit 29.5** të Rregullores Nr. 2002/3 mbi Tatimin në Fitim

Nëse pagesat e kësteve kryhen në kohë, nuk do të ngarkohen gjoba dhe interesa për pagesë të pamjaftueshme të kësteve, në rast se:

- a. Diferenca midis detyrimit për çdo këst dhe këstit të paguar, është me pak se 10%
- b. PAGESA E BËRË NË **secilin** këst është 10% më shumë se $\frac{1}{4}$ e tatimit të vlerësuar nga Administrata Tatimore për periudhën e mëparshme tatimore.

Interpretimi nga Administrata Tatimore:

1. Gjobat dhe interesat për diferencë, midis këstit për tu paguar dhe këstit të paguar, llogariten gjate procesimit të deklaratës vjetore.
2. Për vitin e parë të deklarimit, përdoret rregulla e mëposhtme:
 - Nëse diferenca midis detyrimit tatimor për periudhën dhe shumës së pagesave të kësteve është më e vogël se 10%, në këste nuk aplikohen gjoba për nënpagesë të kësteve
 - Nëse diferenca është më e madhe se 10 %, tatimpaguesi ngarkohet me gjoba dhe interesa për nënpagese, për diferencën midis 90% të tatimit vjetor dhe shumës së kësteve të paguara, duke filluar nga data e detyrimit për pagesën e këstit të katërt.

SHEMBULL

1. Tatimpaguesi ka filluar aktivitetin për Tatim në Fitim në 2004.
Ka bërë pagesa në 3 këste (2,3,4) respektivisht 100 € 200 € 620 €
Detyrimi për periudhën tatimore 2004 është prej 1,000 €
Diferenca $0.9 \times 1,000 \text{ €} < (100 \text{ €} + 200 \text{ €} + 620 \text{ €})$
Nuk ka gjoba dhe interesa për këstet.
2. Tatimpaguesi ka filluar aktivitetin për Tatim në Fitim në 2004.
Ka bërë pagesa në 2 këste (3,4) respektivisht 200 € 500 €
Detyrimi për periudhën tatimore 2004 është prej 1,000 €
Diferenca $0.9 \times 1,000 \text{ €} > (200 \text{ €} + 500 \text{ €})$
Për diferencë $900 \text{ €} - 700 \text{ €} = 200 \text{ €}$ ngarkohet me gjoba dhe interesa duke filluar nga 15 Janarit 2005.

Janar	Gjoba:	$200 \text{ €} \times 0.02 = 4 \text{ €}$	Interesi:	$200 \text{ €} \times 0.015 = 3 \text{ €}$
Shkurt	Gjoba:	$200 \text{ €} \times 0.02 = 4 \text{ €}$	Interesi:	$200 \text{ €} \times 0.015 = 3 \text{ €}$
Mars:	Gjoba:	<u>$200 \text{ €} \times 0.02 = 4 \text{ €}$</u>	Interesi:	<u>$200 \text{ €} \times 0.015 = 3 \text{ €}$</u>
Total	Gjoba:	12 €	Interesi	9 €

3. Vitet Konsekutive:
 - a) Detyrimi i këstit për t'u paguar konsiderohet $\frac{1}{4}$ e detyrimit tatimor të llogaritur gjatë procesimit të deklaratës vjetore.
 - b) Nëse për periudhën tatimore subjekti rezulton me humbje, nuk llogariten gjoba dhe interesa në këste
 - c) Nëse për periudhën e mëparshme tatimore subjekti ka rezultuar me humbje, nuk llogariten gjoba dhe interesa në këste
 - d) Nëse për secilin këst subjekti ka paguar 110% të tatimit të periudhës së mëparshme tatimore pjesëtuar për 4, nuk llogariten gjoba dhe interesa në këste
 - e) Nëse për secilin këst, subjekti ka paguar me shume se 90% të këstit të detyrueshëm, nuk llogariten gjoba dhe interesa në këste
 - f) Nëse tatimpaguesi në disa këste paguan më shumë se kësti i detyruar, diferenca konsiderohet për të mbuluar këstet për të cilat tatimpaguesi ka paguar më pak se sa kësti i detyrueshëm

SHEMBULL

1. Në 2003 tatimpaguesi ka rezultuar me humbje.
Në 2004, ka rezultuar me një Tatim në Fitim 1,000 €.
Nuk ka gjoba për këstet
2. Në 2003 tatimpaguesi ka rezultuar me një Tatim në Fitim 1,000 €
Në 2004 ka rezultuar me humbje.
Nuk ka gjoba në këstet.
3. Në 2003 tatimpaguesi ka pasur një Tatim në Fitim 1,000 €
Në 2004 ka rezultuar me një tatim në fitim 2,000 €
Në çdo këst të 2004 ka paguar 280 €
Nuk ka gjoba në këstet, bazuar në mënyrën korrekte në vitin e mëparshëm

4. Në 2003 tatimpaguesi ka pasur një tatim në Tatim në Fitim prej 2,000 €
Në 2004 ka rezultuar me një tatim në Tatim në Fitim prej 1,000 €
Në çdo këst të 2004 ka paguar 230 €
Nuk ka gjoba në këstet, bazuar në mënyrë korrekte në këtë vitë (> 90% e këstit të detyruar)
5. Në 2003 tatimpaguesi ka pasur një Tatim në Fitim 1,000 €
Për 2004 ka rezultuar me një Tatim në Fitim 2,000 €

Kësti i parë	200 €
Kësti i dytë	300 €
Kësti i tretë	nuk ka dorëzuar
Kësti i katërt	400 €
Bazuar korrekt viti i mëparshëm	$(1,100\text{€}/4) = 275 \text{€}$
Kësti i detyruar për vitin 2004	$2,000\text{€}/4 = 500 \text{€}$

Llogariten Gjoba dhe interesa për:

Kësti i parë për diferencë $500 \text{€} - 200 \text{€} = 300 \text{€}$

Gjoba për periudhën prill 2004 - mars 2005 $(300\text{€} \times 2\%) \times 12\text{muaj} = 72\text{€}$

Interesa për periudhën prill 2004 - mars 2005 $(300\text{€} \times 2\%) \times 9\text{muaj} + (300\text{€} \times 1.5\%) \times 3\text{muaj} = 67.5 \text{€}$

Kësti i dytë për diferencë $500 \text{€} - 300 \text{€} = 200 \text{€}$

Gjoba për periudhën korrik 2004 - mars 2005 $(200\text{€} \times 2\%) \times 9\text{muaj} = 36\text{€}$

Interesa për periudhën korrik 2004 - mars 2005 $(200\text{€} \times 2\%) \times 6\text{muaj} + (200\text{€} \times 1.5\%) \times 3\text{muaj} = 33\text{€}$

Kësti i tretë për diferencë $500 \text{€} - 0 \text{€} = 500 \text{€}$

Gjoba për periudhën Tetor 2004-mars2005 $(500\text{€} \times 2\%) \times 6\text{muaj} = 60\text{€}$

Interesa për periudhën Tetor 2004-mars2005 $(500\text{€} \times 2\%) \times 3\text{muaj} + (500\text{€} \times 1.5\%) \times 3\text{muaj} = 52.5 \text{€}$

Kësti i katërt për diferencë $500 \text{€} - 400 \text{€} = 100 \text{€}$

Gjoba për periudhën Janar 2005 – mars 2005 $(100\text{€} \times 2\%) \times 3\text{muaj} = 6\text{€}$

Interesa për periudhën Janar 2005 – mars 2005 $(100\text{€} \times 1.5\%) \times 3\text{muaj} = 4.5\text{€}$

Total : Gjoba: $72 \text{€} + 36 \text{€} + 60 \text{€} + 6 \text{€} = 174 \text{€}$

Interesa : $67.5 \text{€} + 33 \text{€} + 52.5 \text{€} + 4.5 \text{€} = 157.5 \text{€}$

6. Në 2003 tatimpaguesi ka pasur një Tatim në Fitim 1,000 €
Në 2004 ka rezultuar me një Tatim në Fitim 2,000 €
- | | |
|---------------------------------|---|
| Kësti i parë | 800 € |
| Kësti i dytë | 100 € |
| Kësti i tretë | nuk ka dorëzuar |
| Kësti i katërt | 850 € |
| Bazuar korrekt viti i mëparshëm | $(1,000\text{€} \times 110\%)/4 = 275 \text{€}$ |
| Kësti i detyruar për vitin 2004 | $2,000\text{€}/4 = 500 \text{€}$ |

Llogariten Gjoha dhe interesa për:

Kësti i parë nuk ka gjoha, $800 \text{ €} - 500 \text{ €} = 300 \text{ €}$ përdoret për të mbuluar periudhat e tjera

Kësti i katërt nuk ka gjoha, $850 \text{ €} - 500 \text{ €} = 350 \text{ €}$ përdoret për të mbuluar periudhat e tjera

Kësti i dytë për diferencë $500 \text{ €} - 100 \text{ €} = 400 \text{ €}$

Pagesa e tepërt e bërë në këstin e parë 300 €

Gjobat llogariten për diferencë $400 \text{ €} - 300 \text{ €} = 100 \text{ €}$

Gjoha Për periudhën Korrik 2004 - Janar 2005 $(100 \text{ €} \times 2\%) \times 7 \text{ muaj} = 14 \text{ €}$

Interesa

Për periudhën Korrik 2004 - Janar 2005 $(100 \text{ €} \times 2\%) \times 6 \text{ muaj} + (100 \text{ €} \times 1.5\%) \times 1 \text{ muaj} = 13.5 \text{ €}$

Kredi nga periudha e katërt : 350 €

Mbetet nga kredia $350 \text{ €} - 14 \text{ €} - 13.5 \text{ €} - 100 \text{ €} = 222.5 \text{ €}$ që përdoren për këstin e tretë

Kësti i tretë për diferencë $500 \text{ €} - 0 \text{ €} = 500 \text{ €}$

Gjoha për periudhën Tetor 2004 - Janar 2005 $(500 \text{ €} \times 2\%) \times 4 \text{ muaj} = 40 \text{ €}$

Interesa për periudhën Tetor 2004 - Janar 2005 $(500 \text{ €} \times 2\%) \times 3 \text{ muaj} + (500 \text{ €} \times 1.5\%) \times 1 \text{ muaj} = 37.5 \text{ €}$

Në janar përdorim kredinë e mbetur : 222.5 €

$(40 \text{ €} + 37.5 \text{ €} + 500 \text{ €}) - 222.50 \text{ €} = 355 \text{ €}$.

Pra gjoha Shkurt Mars 2005 $(355 \text{ €} \times 2\%) \times 2 \text{ muaj} = 14.2 \text{ €}$

Pra interesa Shkurt Mars 2005 $(355 \text{ €} \times 1.5\%) \times 2 \text{ muaj} = 10.65 \text{ €}$

Total : Gjoha: $(14 \text{ €} + 40 \text{ €} + 14.2 \text{ €}) = 68.2 \text{ €}$

Interesa: $(13.5 \text{ €} + 37.5 \text{ €} + 10.65 \text{ €}) = 61.65 \text{ €}$

Sqarim Shtesë:

Këto sqarime pasiqë funksionojnë njësoj, vlejnë edhe për:

1. Tatimin në të Ardhurat e Korporatave për bizneset e mëdha, bazuar në Nenin 31.2 (e) dhe 31.6 të Rregullorës Nr. 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave
2. Tatimi në të Ardhurat Personale për bizneset e mëdha bazuar në Nenin 21.2 (c) dhe 21.3 të Rregullorës Nr. 2004/52 mbi Tatimin në të Ardhurat Personale

TATIMI MBI
VLERËN E SHTUAR

Qëllimi

Qëllimi i pjesës së doracakut për **Tatimin mbi Vlerën e Shtuar** është t'u ndihmojë atyre që dëshirojnë të njoftohen me sistemin e TVSh-së . Doracaku është shkruar në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve, duke u bazuar në kërkesat e tatimpaguesëve, për sqarime për problemet dhe paqartësitë e paraqitura gjatë zbatimit të Rregullores për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar .

Në doracak, janë të paraqitura hapat të cilat duhet të ndërmerren nëse tatimpaguesit obligohen ose dëshirojnë të regjistrohen për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Në doracak, është përshkruar edhe historiku i zbatimit të TVSh-së në Kosovë si dhe ndryshimet të bëra brenda kësaj periudhe .

Funksionimi dhe Zbatimi i TVSH-së në Kosovë

Kur filloi zbatimi i TVSH-së në Kosovë ?

Në Kosovë, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, zbatohet prej 1 Korriku të vitit 2001, përmes Rregullores 2001/11 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, e ndryshuar me Rregulloren 2002/17 prej 1 Gusht të vitit 2002 dhe Udhëzimit Administrativ 01 datë 05/31/2001, Udhëzimi Administrativ 01/2004, si mbështetje për zbatimin e këtyre Rregulloreve .

Në vitin 2004, me qëllim të krijimit të lehtësimeve tatimore në sektorin e bujqësisë, hyn në fuqi Rregullore 2004/35, për ndryshimin e nenit 10 të Rregullores 2001/11, për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, në lidhje me imputet Bujqësore, ndërsa prej 01 Janar 2006, hyn në fuqi Rregullorja 2005/40, me të cilën OJQ-ve ju hiqet e drejta për rikthim (shlyhet neni 13.2 b).

PYETJE, PËRGJIGJE DHE SHEMBUJ MBI TATIMIN NË VLERËN E SHTUAR

1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – Kush paguan TVSH-në ?

Përgjigje: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar apo TVSH është një tatim mbi konsumin. TVSH- në e paguan konsumatori në momentin e blerjes së mallrave dhe shërbimeve nga personi i tatueshëm (Subjekte të regjistruara si deklarues të TVSH-së) .

2. Momenti i lindjes së obligimit - Kush duhet ta vjel TVSH-në ?

Përgjigje: TVSH-në kanë të drejtë ta vjelin vetëm tatimpaguesit të regjistruar si deklarues të TVSH-së dhe ata në momentin e shitjes së mallrave dhe shërbimeve. Momenti i lindjes së obligimit për TVSh paraqitet në këto tri raste:

- Kur lëshohet fatura
- Kur malli i dorëzohet klientit ose kur kryhet shërbimi ndaj tij
- Kur të merret pagesa

3. Regjistrimi - Kush është i obliguar të regjistrohet për TVSH ?

Përgjigje: Çdo tatimpagues që ushtron një veprimtari ekonomike (prodhim, tregëti dhe kryen shërbime të ndryshme), dhe që ka një qarkullim prej 50,000 € brenda vitit kalendarik, duhet të regjistrohet në TVSH . Subjekti që ka arritur limitin e përcaktuar dhe që është regjistruar për TVSH, nga momenti i regjistrimit, bëhet person i tatueshëm .

4. Regjistrimi Vullnetar -Kush nuk është i obliguar, por mund të regjistrohet si deklarues vullnetar?

Përgjigje: Subjektet, që kanë qarkullim nën limitin e përcaktuar 50,000 € nuk janë të obliguar të regjistrohen si deklarues të TVSh-se, mirëpo nëse ata dëshirojnë, mund të regjistrohen si deklarues vullnetar. Nga momenti kur ata bëhen persona të tatueshëm në mënyrë vullnetare, i marrin të drejtat dhe përgjegjësitë si çdo deklarues i TVSH-së .

5. Mënyra e regjistrimit - Ku duhet të regjistrohem për TVSH ?

Përgjigje: Subjekti, i cili obligohet ose dëshiron të regjistrohet në tatimin mbi vlerën e shtuar, duhet të bëjë kërkesë duke plotësuar aplikacionin pranë zyrës së Administratës Tatimore në regjionet përkatëse.

Në momentin që kërkesa juaj pranohet dhe shqyrtohet nga ATK-ja, ju do të merrni një certifikatë të regjistrimit që përmban numrin unik të identifikimit, si dëshmi që jeni person i tatuar (Deklarues i TVSh-së).

Administrata Tatimore, mund të regjistrojë çdo person të tatueshëm për qëllime të pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar, pavarësisht se a është paraqitur ai person për regjistrim që nga data kur personi ka qenë i obliguar të regjistrohet .

6. Norma e TVSH-së në Kosovë - Sa është norma e TVSH-së ?

Përgjigje: Në Kosovë, përdoret norma standarde prej 15 % për çdo shitje të mallrave dhe shërbimeve në tregun e Kosovës. Përveç normës standarde 15 %, për Eksporte, Transportin ndërkombëtar dhe Impute Bujqësore, shkalla e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar është zero përqind (0 %) e vlerës së tatueshme. Vlera mbi të cilën llogaritet TVSh-ja quhet vlera e tatueshme.

7. Zbatimi - Si funksionon TVSH-ja?

Përgjigje: Nga tatimpaguesi që është i regjistruar si deklarues i TVSh-së, kërkohet të mbajë libra dhe regjistrime në pajtim me Rregulloren në fuqi (2002/17 dhe Udhëzimi Administrativ 01/2004).

Libri i Shitjes

Përsoni i tatueshëm, për çdo shitje të mallrave dhe shërbimeve, obligohet të arkëtojë 15 % TVSh nga konsumatori . Konsumatorit duhet t'i lëshohet një faturë për mallra dhe shërbime të shitura dhe e njejta faturë duhet të regjistrohet në librin e shitjes. Shitjet në të cilat përlllogaritet TVSh-ja quhen shitjet e tatueshme. Tatimi i arkëtuar nga konsumatori në bazë të Rregullores në fuqi quhet TVSh e llogaritur .

$$\begin{array}{rcl} \text{Vlera e Tatueshme} + \text{TVSh e llogaritur} & = & \text{Vlera totale} \\ 10,000 \text{ €} & + & 1,500 \text{ €} & = & 11,500 \text{ €} \end{array}$$

Libri i Blerjes

Subjekti i regjistruar si deklarues i TVSh-së, të gjitha blerjet i regjistron në librin e blerjes dhe TVSh-në e paguar në blerje e cila lejohet në bazë të Rregullores, do ta shfrytëzojë si TVSh të zbritshme, në raport me TVSh-në e llogaritur .

$$\begin{array}{rcl} \text{Vlera e Tatueshme} + \text{TVSH e zbritshme} & = & \text{Vlera totale} \\ 5,000 \text{ €} & + & 750 \text{ €} & = & 5,750 \text{ €} \end{array}$$

Për çdo muaj, subjektet e kësaj Rregulloreje, do të plotësojnë deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Deklarata përmban dy pjesë kryesore:

1. Pjesa e parë ka të bëjë me furnizimet (shitjet) ose tatimin e llogaritur dhe
2. Pjesa e dytë me blerje ose tatimin e zbritshëm.

Tatimi i llogaritur është tatimi që arkëtohet nga konsumatori (shitja). Tatimi i zbritshëm është tatimi i cili paguhet në blerje vendore (Blerja nga deklaruesit e TVSh-së) dhe importe.

Ndryshimi në mes të TVSh-së së llogaritur dhe TVSh-së së zbritshme do të rezultojë në një TVSh për pagesë ,ose një kreditim (Tatimi i paguar tepër).

SHEMBULL :

a) Rasti i parë kur tatimpaguesi paguan TVSH-në në fund të periudhës :

	Vlera e tatueshme	TVSH
TVSH e llogaritur	10,000 €	1,500 €
TVSH e zbritshme	5,000 €	750 €
TVSH për pagesë	15.000 €	750 €

b) Rasti i dytë kur tatimpaguesi është në kreditim(tatimi i paguar tepër):

	Vlera e tatueshme	TVSH
TVSH e llogaritur	5,000 €	750 €
TVSH e zbritshme	10,000 €	1,500 €
Balansa kreditore		750 €

Nuk do të lejohet të shfrytëzohet si TVSh e zbritshme, TVSh-ja e paguar në mallra dhe shërbime të marra për përdorim personal. Do të lejohet të zbritet vetëm tatimi i zbritshëm në mallra dhe shërbime të shfrytëzuara për qëllime biznesi. Furnizimet për biznes përfshijnë mallrat sikurse janë makineria, mobilet, ndërtesat apo shërbimet sikurse janë sigurimi, ndërtimi, pastrimi, kontabiliteti, ruajtja (mbrojtja) etj .

Në rastin kur tatimpaguesi është në kredit (Tatimi i paguar tepër) mund të bartet në periudha vijuese për zbritjen e tatimit të llogaritur,ose mund të rimbursohet, nëse plotësohen kushtet e kërkuara me rregullore në fuqi. Duhet të ceket se në raste kur kemi të bëjmë me shitjet e përjashtuara kjo rregull ndryshon, sepse për shitjet e përjashtuara nuk lejohet të shfrytëzohet tatimi i paguar në blerje si tatim i zbritshëm .

8. Rimbursimi - Kur mund të kërkojmë Rimbursim ?

Përgjigje: Personi i tatueshëm (deklarues i TVSh-së) mund të kërkojë rimbursim (kthimin e tatimit të paguar tepër), nëse e bart shumën e kreditimit për një periudhë të pandërprerë prej gjashtë muajve dhe shuma e tatimit të paguar tepër është mbi 5,000 € Nëse tatimpaguesi është eksportues, rimbursimin mund ta kërkojë një herë në tre muaj edhe nëse shuma e bartur e tatimit të paguar tepër është me e vogël se 5,000 €

Tatimpaguesi që ka eksporte dhe tatimi i paguar tepër është mbi 5,000 € mund të kërkojë rimbursim për çdo muaj, me kusht që të mos bëhet më shumë se një kërkesë në muaj .

9. Rikthimi - Kush ka të drejtë të kërkojë Rikthim ?

Përgjigje: Kontraktuesit e UNMIK-ut, Agjencioneve të specializuara të KB-së, KFOR-it, Bankës Botërore, Agjencioneve Ndërqeveritare, kanë të drejtë të kërkojnë një rikthim të TVSh-së së paguar në importe nëse paraqesin pranë Administratës Tatimore kopjet autentike të Deklaratave Doganore duke vërtetuar se TVSh-ja është paguar në importe si dhe kopje të kontratave me trupat e përmendur më lart.

Pas hyrjes në fuqi të Rregullores 2005/40, me qëllim të heqjes të së drejtës për kthimin e tatimit në vlerën e shtuar për OJQ-të me përfitim publik, neni 13.2 (b) i Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/11 është shlyer.

10. Shtyrja e TVSh-së - Cilat kushte duhet të plotësohen nga tatimpaguesi për të kërkuar shtyrje të TVSh-së ?

Përgjigje: Personi i tatueshëm (deklarues i TVSh-së) i cili fillon një biznes të ri dhe importon mall kapital ka të drejtë të kërkojë që pagesa e TVSh-së për atë import të shtyhet. Tatimpaguesi, të cilit i aprovet shtyrja, TVSh-në e shtyer do ta paguajë përmes tatimit të prodhimit.

Shtyrja do t'i aprovet personit të tatueshëm vetëm nëse i plotëson këto kushte:

1. Garancioni Bankar për të mbuluar pjesën e TVSh-së.
2. Kopjen e planit të biznesit.
3. Kopjen e kontratës me shitësin e makinerisë apo pajisjes.
4. Planin e uzinës apo fabrikës .
5. Lejen e ndërtimit të dhënë nga agjencitë e autorizuara .

11. Shqyrtimi - Sa kohë duhet të pritet pas aplikimit për shtyrje ?

Përgjigje: Administrata Tatimore do të shqyrtojë kërkesat e tatimpaguesëve në afatin sa më të shkurtër dhe do të lejojë shtyrje të afatit për pagesë të TVSh-së, të cilët i plotësojnë kushtet e parashtruara me Rregullore. Kërkesa do të shqyrtohet nga komisioni prej tre anëtarësh dhe do të aprovet nga Drejtori i Administratës Tatimore .

Administrata Tatimore, me shkrim, do të njoftojë tatimpaguesin për miratim apo refuzim të kërkesës. Nëse tatimpaguesit i aprovet shtyrja, një kopje e formularit të aprovimit do t'i dërgohet tatimpaguesit, ndërsa origjinalin Shërbimit Doganor ku do të precizohen data dhe vendi i hyrjes së mallrave në Kosovë .

Shërbimi Doganor, në kohën e importimit, do të kërkojë nga pronari kopjen e formularit të aprovimit të lëshuar nga ATK-ja që ta krahasojë me formularin e dërguar nga ATK . Personi i tatueshëm ka 6 muaj që të kompensojë TVSh-në me tatimin e mbledhur në shitje Nëse, gjatë kësaj periudhe, tatimpaguesi nuk arrin të kompensojë TVSh-në me shitje, obligohet që para skadimit të afatit të përcaktuar në formularin e aprovimit të bëjë pagesën në njërin nga bankat e autorizuara të Kosovës . Banka, do të mbulojë pjesën e TVSh-së, nëse tatimpaguesi nuk paguan brenda afatit të përcaktuar .

12. Si trajtohet TVSh-ja e paguar në kufi për veturë ?

Përgjigje: Bazuar në nenin 21.2 të Rregullores Nr. 2002/17 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2004 Neni 16, TVSh-ja e paguar për vetura nuk do të lejohet si TVSh e zbritshme , përveç kur:

- a) Veprimtaria e tatimpaguesit është tregtia e veturave (shitja e veturave), apo
- b) Përdorimi i veturave është aktivitet i vetëm i personit të tatueshëm, sikurse është rasti i shërbimeve të dhënies me qira të veturave, shërbimet e taksive, shërbimet e ambulancës dhe shërbimet e varrimit .

13. Nëse një kompani e huaj (gjermane), e cila nuk është e regjistruar në Kosovë, kryen shërbime në Kosovë, kurse kompania vendase si deklaruës i TVSh-së kryen shërbime për kompaninë gjermane. A është kompania vendase e obliguar që të llogarisë TVSh-në?

Përgjigje: Kompania vendase, e cila kryen shërbime për kompaninë gjermane është e obliguar, në bazë të Rregullores Nr. 2002/17 mbi TVSh-në, të faturojë me TVSh, sepse vendi i furnizimit është vendi ku kryhet shërbimi dhe pasi që të zbritet TVSh-ja e paguar në blerje, pjesa e mbetur paguhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Kompania gjermane, meqenëse vepron në Kosovë, është e obliguar që të regjistrohet dhe t'i paguajë të gjitha tatimet të parapara me ligj.

14. Nëse bizneset kanë të hyra nga qiraja për objekte afariste, a duhet të zbatojnë TVSh-në apo jo?

Përgjigje: Nëse tatimpaguesi është deklarues i TVSh-së dhe ka të hyra nga qiraja, gjegjësisht lëshon lokale (objekte) afariste me qira, duhet të lëshojë fatura me TVSh, për pjesën e të hyrave nga qiraja .

15. Organizata jo qeveritare me status të përfitimit publik, a është e obliguar të paguajë TVSH edhe nëse mjetet e projektit janë mjetet e donacionit të marr nga banka botërore, qeveria ose UNDP (projekti i infrastrukturës) dhe me pjesëmarrje të komunave ose komunitetit?

Përgjigje: Bazuar në Rregulloren Nr. 2001/11, e ndryshuar me Rregulloren Nr. 2002/17 mbi TVSh-në, OJQ-të nuk janë të liruara nga TVSh-ja për blerje vendore. Organizata joqeveritare me status të përfitimit publik, paguajnë TVSh-në në kufi dhe kanë të drejtën e rikthimit, nëse argumentohet se destinacioni i këtyre importeve është për qëllime të përfitimit publik. Nga janari i vitit 2006, me Rregulloren 2005/40, shlyhet neni 13.2 b), me ç'rast OJQ-ve iu hiqet e drejta e rikthimit të TVSh-së. OJQ-të nga 1 Janari i vitit 2006, do të paguajnë TVSh-në, në të gjitha blerjet e tyre .

16. Si do të veprohet në momentin e çregjistrimit për mallin në depo, i cili çregjistrohet për shkak të kalimit të afatit, të thyerjes, prishjes etj, e për të cilin është shfrytëzuar TVSh e zbritshme, në momentin e blerjes?

Përgjigje: Nëse në depo konstatohet mungesa e mallit për arsye të ndryshme, tatimpaguesi duhet të argumentojë këtë mungesë, në të kundërtën kjo mungesë do të konsiderohet si mall i shitur.

17. Personi fizik nuk është regjistruar si biznes, por realizon të hyra nga qiraja për objekte afariste mbi 50,000 euro në vit. Çfarë tatimi është i obliguar të paguajë ky person ?

Përgjigje: Sa i përket TVSh-së, personi fizik është i obliguar të regjistrohet si deklarues i TVSh-së, brenda 15 dite nga dita e arritjes së limitit prej 50,000 €. Nga momenti i regjistrimit, personi në fjalë bëhet person i tatueshëm dhe është i obliguar të vjel TVSh-në. Pra, të llogarisë TVSh-në në shitje dhe të zbrisë TVSh-në e paguar në blerje, ndërsa ndryshimin të paguajë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës .

18. Biznesi është i regjistruar si deklarues i TVSh-së dhe ka një kontratë me një organizatë qeveritare të huaj. Si duhet të trajtohen furnizimet me këtë rast: si furnizime të përjashtuara apo si furnizime të tatueshme ?

Përgjigje: Bazuar në Rregulloren Nr. 2001/11, ndryshuar nga Rregullorja Nr. 2002/17, neni 11 "Përjashtimet" shihet se cilat trupa janë të përjashtuar nga TVSh-ja . Në rastin tuaj biznesi është deklarues i TVSh-së dhe nëse furnizimet (shitjet) janë për organizatë qeveritare të huaj e përfshirë në kuadër të nenit 11, këto furnizime do të trajtohen si furnizime (shitje) të tatueshme me 0% dhe tatimpaguesi ka të drejtë të shfrytëzojë TVSh-në e paguar në blerje si TVSh të zbritshme .

SHEMBULL:

Në vazhdim, do të paraqesim një shembull praktik të regjistrimit të transaksioneve në librin e blerjes dhe të shitjes .

Libri i Shitjes :

1. Tatimpaguesi ka shitje vendore me 15 % në vlerë prej 10,000 €, TVSh 1,500 €
2. Tatimpaguesi eksporton mall në vlerë prej 20,000 €, TVSh 0 % .
3. Tatimpaguesi bën shitjen e farës në vlerë prej 5,000 €, TVSh 0%.

Libri i Blerjes :

1. Tatimpaguesi ka pranuar një faturë nga një tatimpagues, brenda vendit, i regjistruar si deklarues i TVSh-së. Vlera e faturës është 20,000 €, TVSh 3,000 €.
2. Tatimpaguesi ka pranuar faturë për blerje të derivateve në vlerë prej 4,000 € TVSh 600 €
3. Tatimpaguesi ka blerje të mallit nga një subjekt i cili nuk është i regjistruar si deklarues i TVSh-së. Vlera e faturës është 8,000 €.
4. Tatimpaguesi ka blerje të farës si mall për rishitje. Vlera e faturës për farë është 10,000€, TVSh 0 % .
5. Tatimpaguesi ka importe në vlerë prej 30,000 €, TVSh 4,500 €.

Shënimet e prezantuara më lartë duhet të regjistrohen në librin e blerjes dhe të shitjes dhe duhet të deklarohen në Administratën Tatimore, duke plotësuar Deklaratën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Periudha tatimore për TVSh është periudha mujore dhe afati i dorëzimit të deklaratës është fundi i muajit vijues. P.sh. për Janar/2006, afati i deklarimit është 28 Shkurt 2006. Në rast se dita e fundit e deklarimit është ditë feste, afati i fundit për dorëzimin e deklaratës është dita e parë e punës pas festës

Forma e Librit të shitjes :

Fatura			Shitjet Totale		Shitjet e Përfunduar			Shitjet e Tatueshme			
Data	Numri	Blerësi	NIT i blerësit (nëse ka)	(Baza e tatueshme për Tat. E Paragjyk)	f	Furnizimet (shitjet) e imputeve bujqësore me 0%	Eksportet, Daljet dhe furnizimet me 0%	Vlera e tatueshme me 15%	TVSh		
a	b	c	d	e=f+g+h+i	f	g	h	i	j		
xxxx	xxxx	Subjekti " x "	7000....	10.000				10.000	1.500		
xxxx	xxxx	Subjekti " y "	20.000			20.000				
xxxx	xxxx	Subjekti " z "	8000....	5.000		5.000					
Gjithsej											
Gjithsej				35.000		5.000	20.000	10.000	1.500		
Numri i kufisë në Deklaratën Tatimore					9	10	11	12	13		

Forma e Librit të Blerjes :

Fatura			Blerjet që i nënshtrohen TVSh-së							
Data	Numri	Emri i Shitësit	NIT i shitësit	Blerja totale me TVSH	Blerjet e perjashtuara dhe me TVSH jo të zbritshme	Blerjet e imputeve bujqësore të tatueshme me 0%		Blerjet Vendore		
						g	h	Vlera e tatueshme	TVSh	Vlera e tatueshme
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k
xxxx	xxxx	Subjekti "A"	7000....	23.000					20.000	3.000
xxxx	xxxx	Subjekti "B"	8000....	4.600					4.000	600
xxxx	xxxx	Subjekti "C"	7000....		8.000					
xxxx	xxxx	Subjekti "Ç"	7000....	10.000		10.000				
xxxx	xxxx	Subjekti "D"	7000....	30.000			30.000	4.500		
Gjithsej					8.000	10.000	30.000	4.500	24.000	3.600
Numri i kutisë në Deklaratën tatimore					Kutija 14	Kutija 15	Kutija 16	Kutija 17	Kutija 18	Kutija 19

Në vazhdim është i paraqitur shembulli i plotësimit të deklaratës bazuar në shenimet e regjistruara në libra.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TVSH

[1] Periudha e deklarimit :	JANAR / 2006	[2] Nr. serik.:	[2] TV
[3] Numri i regjistrimit të biznesit	8 0 0	[4] Numri i përkohshëm tatimor	
[5] Emri i biznesit	[5] Subjekti " X"		
[6] Adresa e biznesit (veç nëse ka ndryshuar nga formulari i fundit)	[6] Këndi i Dëshmorëve nr.12 ,	Prishtinë	Telefoni 038/000 - 000
[7] Emri i personit kontaktues	[7] Emri Mbiemri	Telefoni	044/000 - 000
[8a] Vendosi 'X' këtu <input type="checkbox"/> nëse nuk ka ndodhur asnjë transakcion gjatë periudhës së kaluar tatimore. Vetëm nënshkruani dhe dorëzoni deklaratën në bankën e autorizuar.			
[8b] Vendosi 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po e dorëzon për herë të parë për këtë periudhë.			
<input type="checkbox"/>	Shtesë	<input type="checkbox"/>	Korrigjim
		<input type="checkbox"/>	Vetëm pagesë

TVSh e llogaritur për muajin

[9] Furnizimet(shitjet) e përjashtuara.....	[9]	
[10] Furnizimet(shitjet) e inuteve bujqesore me 0%.....	[10]	5,000 €
[11] Eksportet dhe furnizimet e tatueshme me 0%.....	[11]	20,000 €
[12] Shitjet e tatueshme me normën normale 15%	[12]	10,000 €
	[13]	1,500 €

TVSh e zbritshme për muajin

[14] Blerjet e përjashtuara dhe me TVSH jo te zbritshme.....	[14]	8,000 €	Vlera e tatueshme
[15] Blerjet e inuteve bujqësore te tatueshme me 0%.....	[15]	10,000 €	TVSh e zbritshme
[16] Importet dhe Hyrjet nga RFJ.....	[16]	30,000 €	[17] 4,500 €
[18] Blerjet e tatueshme vendore me 15%	[18]	24,000 €	[19] 3,600 €

Rregullimet

[20] Teprica e TVSh e bartur nga muaji i kaluar	[20]		Balansi kreditor i TVSh
[21] Kërkesa për rimbursim nga tatimi i paguar tepër	[21]		
[22] Balansi kreditor nga muaji i kaluar [20]-[21]	[22]		
[23] Balansa kreditore e përgjithshme për muajin [23]=[17]+[19]+[22]	[23]	8,100 €	
[24] Balansa kreditore e mbetur[24]=[23]-[13] nëse [23]>[13]	[24]	6,600 €	
(dërgoje në kutinë [20] të deklaratës tatimore të muajit të ardhshëm)			
[25] TVSh që duhet paguar [25]=[13]-[23]nëse [13]>[23]	[25]		
[26] Ndëshkimet për deklarim dhe pagesë të vonuar	[26]		
[27] Obligimi i përgjithshëm që duhet paguar [25]+[26]	[27]		
[28] Shuma e paraqitur për pagesë	[28]		

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë Pasqyrë janë të vërteta. Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe vula (_____)	dd/mm/vv ____/____/____
---	----------------------------

Pjesa e bankës

Nënshkrimi dhe vula _____	Numri i llogarisë: 1000420070000373	Shuma e tatimit të paguar _____ €
	Teksti:	
	Data ____/____/____	

Pjesa e parë

Kutia [1] Plotësoni periudhën tatimore, si shembull: Korrik 2004

Kutia [3] Vendoseni: Numrin e Regjistrimit të Biznesit

Kutia [4] Nëse e keni një, vendoseni Numrin e Përkohshëm Tatimor

Kutia [5] Plotësoni emrin e biznesit

Kutia [6] Jepni Adresën e re t; Biznesit tuaj

Kutia [7] Jepni emrin e pronarit/menaxherit

Kutia [8a] Nëse nuk ka transaksione gjatë tërë muajit, vendosni ‘X’, nënshkruani dhe dorëzoni deklaratën në sportelet e bankës.

Kutia [8b] Në rubrikën [8b], nëse nuk e dorëzon për herë të parë në atë muaj këtë pasqyrë, mund të vendosësh një “X” në një prej tre kutijave:

Shtesë – nënkupton deklaram shtesë brënda të njejtit muaj.

Korrigjim – nënkupton kur dëshiron të ndryshosh të dhënat e deklaruara më parë për atë muaj kalendarik.

Pagesë shtesë- nënkupton se ju vetëm dëshironi të bëni një pagesë shtesë, pa ndryshuar ndonjë prej të dhënave të raportuara më parë, për të njejtin muaj kalendarik.

Pjesa e dytë

Kutia [9] Mbushni furnizimet tuaja të përjashtuara. Merrni atë nga shtylla ‘f’ të Librit të Shitjes

Kutia [10] Mbushni furnizimet e tatuara me 0%, inpute bujqësore

Kutia [11] Mbushni furnizimet e tatuara me 0%, eksportet dhe Daljet nëpërmjet RFJ-së. Merrni atë nga shtylla ‘h’ e Librit të Shitjes

Kutia [12] Mbushni Vlerën e tatuar të furnizimeve me përqindjen normale 15%. Merrni atë nga shtylla ‘i’ e Librit të Shitjes

Kutia [13] Mbushni TVSH-në e aplikuar gjatë muajit. Merrni atë nga shtylla ‘j’ e Librit të Shitjes

Kutia [14] Mbushni blerjet e liruara nga tatimi dhe ato pa TVSH. Merrni atë nga shtylla ‘f’ e Librit të Blerjes

Kutia [15] Mbushni vlerën e blerjeve për inpute bujqësore

Kutia [16] Mbushni Vlerën e Tatuara të Importeve dhe Hyrjeve nga RFJ. Merrni atë nga shtylla ‘h’ e Librit të Blerjes

Kutia [17] Mbushni TVSH-në e paguar në importet dhe Hyrjet nga RFJ. Shfrytëzoni shtyllën ‘i’ të Librit të Blerjes

Kutia [18] Mbushni vlerën e tatuar të blerjeve brënda vendit. Merrni atë nga shtylla ‘j’ e Librit të Blerjes

Kutia [19] Tregoni TVSH-në e paguar në blerjet e tatuara brënda vendit. Merrni atë nga shtylla ‘k’ e Librit të Blerjes

Kutia [20] Mbushni TVSH-në e paguar tepër, të bartur nga muaji i kaluar. Merrni atë nga kutia [24] e deklaratës tatimore të muajit të kaluar

Kutia [21] Nëse balanca e treguar në kutinë [20] është bartur për gjashtë muaj të njëpasnjëshëm dhe vlera është më e lartë se 5,000 euro, ju lejohet për rimbursimi

Kutia [22] Nëse [20]>[21] bëni zbritjen [20] -[21] dhe vendosni rezultatin në kutinë [22]

Kutia [23] Mblidhni Totalin e Kreditit Tatimor [23] = [17]+[19] +[22]

Kutia [24] Llogaritni Balancën Kreditore të mbetur [24]=[23]-[13] nëse[23]>[13]

Kutia [25] Llogaritni TVSH-në e paguar [25]=[13]-[23] nëse [13]>[23]

Kutia [26] Vendosni çdo gjobë dhe kamatë për deklaram dhe pagesë të vonuar

Kutia [27] Obligimi i përgjithshëm (total) =[25]+[26]

Kutia [28] Trego shumën të cilën po e paguan me këtë deklaratë

Pjesa e Tretë

Nënshkruani dhe vëni datën në Deklaramen Tatimore dhe lëroni pjesën e tretë zbratur që të mbushet nga arkëtari (sportelisi) i bankës. Pasi të jenë nënshkruar dhe vulosur të tri kopjet, sportelisi do t’i mbajë dy kopjet e para dhe t’u japë juve kopjen e tretë. T’u përkujtojmë se data e dorëzimit në bankë do të skanohet automatikisht nga kompjuterët tanë për të aplikuar apo jo gjobat dhe kamatën për deklaram dhe pagesë të vonuar.

RIMBURSIMI DHE RIKTHIMI SI PJESË E LEGJISLACIONIT

1. Kompania ka një kontratë për ndërtimin e objektit afarist (prodhues) me kryesin e punëve me të cilin jemi aksionarë me 49% të aksioneve. Meqë ende nuk kemi filluar prodhimin dhe nuk e dijmë kur do të ndodh kjo, pjesën e TVSh-së ja kemi paguar kryesit të punëve. A kemi të drejtë ta rimbursojmë ?

Përgjigje: Bazuar në Rregulloren e TVSh-së 2002/17, neni 1 paragrafi 1.21, Neni 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2004, në zbatim të kësaj Rregulloreje si dhe Neni 1 i Ligjit Nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ju konsideroheni të jeni persona të lidhur. Meqë jeni persona të lidhur, transaksionet duhet të jenë sipas vlerës së hapur të tregut.

Faturat e lëshuara nga kontraktori për ndërtim ju i regjistroni në librin e blerjes dhe pasi që nuk keni filluar prodhimin, dhe me investimet e juaja nuk jeni duke vjelur TVSH-në (çka ishte edhe qëllimi i investimit), ju mund ta bartni TVSH-në e zbritshme si kreditim dhe ta shfrytëzoni kundrejt TVSH-së së llogaritur, ose të kërkonti rimbursim nëse i plotësoni kushtet, konform Nenit 23 të Rregullorës Nr. 2002/17 dhe Nenit 24 të Ligjit Nr. 2004/48 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

2. Jemi biznes që merremi me ofrimin e shërbimeve mjeksore. Sipas rregullores, furnizimet e shërbimeve mjeksore, janë furnizime të përjashtuara. Ne e kemi një kontratë qiraje me një biznes tjetër i cili çdo muaj na e faturon TVSh-në si dhe i kemi blerë disa pajisje për zyre po ashtu me TVSh. Pas disa muajve, TVSh-ja e zbritshme është akumuluar dhe ne pretendojmë të kërkojmë rimbursim?

Përgjigje: Bazuar në Rregulloren e TVSh-së Nr. 2001/11 date 31.05/2001, ndryshuar nga Rregullorja Nr. 2002/17 date 01/08/2002, neni 12 - paragrafi 12.1 saktëson se cilat prej furnizimeve mjeksore, mallra apo shërbime janë të përjashtuara nga TVSh-ja.

Meqë kërkesa për Rimbursimin e TVSh-së, ka të bëjë me qiranë dhe pajisjet për zyrë, për të cilat është paguar TVSh-ja dhe të cilat ekskluzivisht lidhen për shërbimet (mallrat), që bëjnë pjesë në kuadër të këtij neni, atëherë neni 21, paragrafi 21.2 dhe 21.4 e kufizojnë një të drejtë të tillë, duke mos lejuar zbritje të tatimit të zbritshëm, të paguar në lidhje me furnizimet, të cilat nuk janë përdorë për furnizime të tatueshme, të kryera nga personi i tatueshëm. Me këtë rast, neni 21.4 e ndërlihd edhe më tutje këtë çështje ku në mënyrë decidive ceket se nuk lejohet kreditimi i tatimit të zbritshëm për furnizimet e tatueshme të referuara në nenin 12.

3. Jemi agjencion dhe merremi me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve. Bazuar në deklaratimet për TVSh, e kemi një balancë kreditore të cilën pretendojmë ta kërkojmë si rimbursim ?

Përgjigje: Bazuar në Rregulloren e TVSh-së Nr. 2002/17, Neni 10 paragrafi 10.1(b), mallrat dhe shërbimet që lidhen me transportin ndërkombëtar të mallrave e udhëtarëve, ju duhet të ofroni faturat (dokumentet) origjinale të blerjeve me TVSh, të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht me aktivitetin primar të biznesit tuaj dhe pasi që furnizimet në lidhje me transportin e mallrave dhe udhëtarëve janë furnizime të tatueshme me 0% , d.m.th. nuk ka TVSh të llogaritur, ju mund të kërkonti rimbursim po qe se i plotësoni kushtet konform Rregullores Nr. 2002/17, neni 23 paragrafi 23.2

4. Kemi lidhur një kontratë me KFOR –in. Bazuar në regjistrimet e mbajtura, TVSh-ja e zbritshme është akumuluar dhe pretendojmë të aplikojmë për rimbursim?

Përgjigje: Bazuar në interpretimet e bëra nga ATK, në lidhje me “Blerjet e përjashtuara” nga këndvështrimi i blerësit, është sqaruar se furnizimet për AER , trupat e UN, KFOR etj , të trajtohen si furnizime të tatueshme me 0%, që do të thotë se ju mund ta kërkonti rimbursimin për tepicën e TVSh-së, nëse e ofroni dokumentacionin përkatës, konform kërkesave të Rregullores. 2002/17, në lidhje me rimbursimin .

5. Jemi regjistruar si person i tatueshëm me qarkullim mbi 50,000€, por pas analizës e kemi konstatuar se ne nuk kemi pasur të drejtë për arsye se nuk e kemi arritur atë qarkullim. Meqë kemi importuar gjatë periudhës para se ta plotësojmë kushtin për regjistrim si person i tatueshëm , a kemi të drejtë që ta kërkojmë rimbursimin e TVSh-së që e kemi paguar në importe?

Përgjigje: Ju duhet t’i referoheni nenit 7.2 (të Udhëzimit Administrativ Nr: 01/2004 të datës 01.09.2004).

Furnizimet (shitjet) e kryera nga personat e tatueshëm të cilët importojnë apo kryejnë Hyrje nga RFJ, por qarkullimi vjetor i të cilëve nuk tejkalon limitin 50,000 € janë furnizime (shitje) të përjashtuara për nenin 12 (e) të Rregullores Nr. 2002/17.

Personat e tatueshëm, të cilët i kryejnë këto furnizime, kërkohet të regjistrohen sipas nenit 3.6 të Rregullores dhe të paguajnë TVSh-në në importet dhe Hyrjet nga RFJ. Ata nuk lejohen të ngarkojnë TVSh-në dhe nuk lejohen për zbritje të TVSh së zbritshme.

Prandaj, ju nuk jeni regjistruar në mënyrë të drejtë dhe duke ju referuar sqarimit paraparak ju nuk mund të kërkonti rimbursim për TVSh-në në importe sepse nuk e keni pasur statusin e personit të tatueshëm në momentin kur keni importuar .

6. Jam prodhues, ku mallrat që do të prodhohen nuk janë të destinuara për tregun e brendshëm , por vetëm për eksport. Në bazë të regjistrimeve të mia balanca kreditore ishte 38,500 €. Pas verifikimit nga ana e ATK-së, është konstatuar se balanca kreditore 31,200 € është shumë, e cila më takon që të më rimbursohet. Në xhirollogarinë time më janë transferuar vetëm 29,375 €. Dëshiroj të di arsyen e mosrealizimit të plotë të rimbursimit.

Përgjigje: Bazuar në Ligjin Nr. 2004/48 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Neni 45 Nëndeklarimet dhe mbideklarimet tatimore, Paragrafi 45.1 përcakton që ju e keni mbivlerësuar kërkesën për rimbursim dhe është konstatuar se mbivlerësimi i kërkesës së juaj është bërë për shkak të pakujdesisë (mbivlerësim i paqëllimshëm). Ju jeni ndëshkuar me njëzet e pesë % (25 %) të diferencës mes shumës korrekte të tatimit që duhet të deklarohet dhe shumës që në të vërtetë është deklaruar .

Shiko shembullin në vijim:

Rasti i parë kur shuma e mbivlerësuar është ndëshkuar me 25%

Shuma e kërkuar	Shuma e aprovuar	Shuma e mbideklaruar	Ndëshkimi mbi shumën e mbideklaruar 25%	Shuma që do të Rimburohet
(a)	(b)	$c = (a - b)$	$d = (c * 25 \%)$	$e = (b - d)$
38,500.00 €	31,200.00 €	7,300.00 €	1,825.00 €	29,375.00 €

Nëse do të konstatohej se mbideklarimi do të jetë për shkak të synimit me paramendim apo me qëllim , atëherë ndëshkimi do të jetë (100%) i ndryshimit në mes të shumës korrekte të tatimit që duhet të ishte deklaruar dhe shumës që në të vërtetë është deklaruar.

Rasti i dytë kur shuma e mbivlerësuar është ndëshkuar me 100%

Shuma e kërkuar	Shuma e aprovuar	Shuma e mbideklaruar	Ndëshkimi mbi shumën e mbideklaruar 25%	Shuma që do të Rimburohet
(a)	(b)	$c = (a - b)$	$d = (c * 25 \%)$	$e = (b - d)$
38,500.00 €	31,200.00 €	7,300.00 €	7,300.00 €	23,900.00 €

Nëse një tatimpagues ka bërë kërkesë në ATK për rimbursim në vlerë prej 20,000 € kurse sipas gjendjes së përgjithshme ky tatimpagues ka obligime ndaj ATK-së në këto tatime TPGJ 3,000 € TF 5,000 €,TAP 2,000 € atëherë do të kemi:

Rasti i parë kur shuma e mbivlerësuar është ndëshkuar me 25%

Shuma e kërkuar	Shuma e aprovuar	Obligim në ATK	Shuma e mbideklaruar	Ndëshkimi 25%	Shuma për rimbursim
a	b	C	$d = (a - b)$	$e = (d * 25 \%)$	$f = (b - c - e)$
20,000.00 €	15,000.00 €	10,000.00 €	5,000.00 €	1,250.00 €	3,750.00 €

Rasti i dytë kur shuma e mbivlerësuar është ndëshkuar me 100%

Shuma e kërkuar	Shuma e aprovuar	Obligim në ATK	Shuma e mbideklaruar	Ndëshkimi 25%	Shuma për rimbursim
a	b	C	$d = (a - b)$	$e = (d * 25 \%)$	$f = (b - c - e)$
20,000.00 €	15,000.00 €	10,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €	0.00 €

Pra, ju do të rimbursoni shumën prej 4,250.00 € nëse mbideklarimi i juaj është bërë pa qëllim (pra do të sanksionoheni me 25% të shumës së mbideklaruar), kurse nëse mbideklarimi i juaj është bërë qëllimisht, atëherë juve nuk do të ju mbetet asnjë shumë për rimbursim sepse do të sanksionoheni me 100% të shumës së mbideklaruar .

7. Jemi korporatë. Në bazë të pasqyrave financiare dhe rregullimeve të bëra për qëllime të tatimeve kemi përlogaritur se pagesat e kësteve e tejkalojnë detyrimin e tatimit përfundimtar në korporatë. Këtë pjesë të paguar më tepër, kërkojmë që ta rimbursojmë .

Përgjigje: Nëse ju ofroni fakte të mjaftueshme pra, nëse ju i keni mbajtur pasqyrat konform Standardeve të kontabilitetit dhe i keni bërë rregullimit të parapara me rregullore tatimore , ATK-ja brenda 60 ditëve nga data e deklarimit duhet ta shqyrtojë kërkesën tuaj dhe të aprovojë rimbursimin tuaj .

Nëse kërkesa nuk shqyrtohet mbrenda 60 ditëve, atëherë ATK do të paguajë interes në shkallën prej 0.15% në muaj.

8. Jam biznes që paguaj AP mbi të ardhurat reale dhe në bazë të llogaritjeve të mia kam paguar më shumë se sa që kam pas obligim tatimor. Këtë tepriçë (pagesë tepër) të tatimit kërkojë ta rimbursoj.

Përgjigje: Nëse jeni biznes që paguani Tatimin mbi të Ardhura personale në fitimin real , dhe paradhënjët që i keni paguar janë më të mëdha se tatimi që ju keni qenë të detyruar ta paguani, ju mund të kërkonim rimbursim.

Deklarimi bëhet me formularin dhe pasqyrat e tatimit vjetor i cili duhet të dorëzohet deri më 1 prill të vitit vijues.

9. Jemi kompani që merremi me ndërtimin e banesave ku përveq banesave për banim, njëkohësisht, në katet përdhese ndërtojmë lokale afariste. Gjatë blerjeve të materialeve për ndërtimin e banesave, TVSh-ja e zbritshme e paguar e ka tejkualuar TVSh-në e llogaritur. Meqë pjesa më e madhe e furnizimeve janë të përjashtuara , a mund të kërkojmë rimbursim tepriçën kreditore të TVSh-së?

Përgjigje: Për furnizimet e përjashtuara, nuk keni të drejtë në rimbursim. Sqarimet, se si duhet vepruar në këtë rast, po i japim në Udhëzimin mbi Ndërmarrjet Ndërtimore si më poshtë .

UDHËZIM PËR NDËRMARRJE NDËRTIMORE

Bazuar në Nenet përkatëse të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut Nr.2001/11 (Rregullores Nr. 2002/17) rrespektivisht,

- **Neni 12 "Furnizimet e përjashtuara"**
(pika d) " Transferimi i titullit të pronësisë, qiraja e tokës dhe e shtëpive të banimit" ,
- **Neni 21 "Tatimi i zbritshëm"**
paragrafi 21.2 " Zbritje e tatimit të zbritshëm nuk lejohet për tatimin në vlerën e shtuar të paguar në lidhje me furnizimet, të cilat nuk janë përdorur për furnizime të tatuara të kryera nga personi i tatuuar " ,
- *paragrafi 21.4 " Nuk lejohet zbritje e tatimit të zbritshëm në lidhje me furnizimet e përjashtuara sipas nenit 12,*

në pamundësi të aplikimit të nenit 24 të Udhëzimit Administrativ Nr.01 datë 31/05/2001 (Udhez. Admin. Nr.01/2004 date 01/09/2004), për shkak të natyrës specifike për këtë lloj të veprimtarisë afariste, që ka të bëjë me aplikimin e "Koeficienti i Kreditimit Tatimor" ,

(Koefficienti do të llogaritet në fund të periudhës tatimore dhe do të zbatohet në TVSh-në e paguar në importet, hyrjet, blerjet brenda vendit për atë periudhë tatimore. Rezultati do të jetë TVSh e Lejuar si Tatim i Zbritshëm për periudhën tatimore, që është i zbritshëm nga Tatimi i Llogaritur i të njejtës periudhë),

UDHËZOJMË me sa vijon :

Në rastet, kur subjektet merren me ndërtimin e banesave kolektive dhe objekteve afariste, duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë, në projektet e tyre të ndërtimit apo në kuader të objektit që planifikohet të ndërtohet, pjesëmarrja e përcaktuar në % (përqindje) të këtyre dy kategorive. Pra,

- banesave (pjesa për banim) si furnizim i përjashtuar, dhe
- lokaleve afariste si furnizim i tatuar .

E gjithë kjo bëhet me qëllim të pranimit të pjesës së TVSh-së së zbritshme, për aq sa ka edhe furnizime të tatuara si dhe në pamundësi të ndarjes të secilës kategori e blerjeve, qoftë me TVSh apo pa TVSh, është shpenzuar për furnizime të tatuara dhe cila kategori për furnizime të përjashtuara. Kjo ndarje, njëkohësisht, korespondon dhe është në harmoni të plotë me nenet përkatëse të Rregullores së TVSh-së.

Për t'a ilustruar këtë po marrim një shembull:

Subjekti " X " planifikon të ndërtojë një ndërtesë dhe me projekt është përcaktuar që **70 % do të jenë Banesa** (pjesa për banim) dhe **30 % Lokale afariste**.

Nëse subjekti është deklarues i TVSh-së, në Librin e Blerjes për çdo periudhë tatimore do të bëj prerje (përlllogaritje) bazuar në përqindjen e përcaktuar në projekt .

Periudha tatimore , JANAR / 2005

Libri i Blerjes

	TVSH e zbritshme	
1. Blerje pa TVSh	5,000 €	/
2. Importe	10,000 €	1,500 €
3. Blerje të tatuara me 15 %	20,000 €	3,000 €
Totali	35,000 €	4,500 €

Në këtë rast, tatimpaguesit do t'i pranohet vetëm **30% nga vlera totale e TVSh-së e zbritshme** dhe në deklaratën e TVSh-së do t'i plotësojnë kutiat përkatëse, dhe ate:

[16] Importet dhe hyrjet , dhe

[18] Blerjet e tatuara vendore me 15% .

pasi që vetëm **30% e projektit ka të bëjë me furnizime të tatuara .**

Për pjesën e TVSh-së së zbritshme, që ka të bëjë me furnizimet e përjashtuara, korigjohet pjesa e importeve dhe blerjeve vendore me 15% (që në rastin konkret përfshinë pjesën e mbetur 70%) dhe në deklaratën e TVSh-së paraqitet në kutinë:

[14] Blerjet pa TVSh dhe me TVSh jo të zbritshme

Pas korigjimeve të bera në Librin e Blerjes për periudhën tatimore JANAR/2005, deklarata tatimore do të plotësohet si vijon :

[14] Blerje pa TVSh dhe me TVSh jo të zbritshme	[14] 29,150 €	
[16] Importet dhe hyrjet	[16] 3,000 €	[17] 450 €
[18] Blerje të tatuara vendore me 15 %	[18] 6,000 €	[19] 900 €

TVSh-ja e cila nuk pranohet si e zbritshme, njihet si shpenzim (Kosto) të Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (Tatimi në Fitim) .

Kur tatimpaguesi ka disa projekte të ndërtimit dhe përqindja ndryshon varësisht nga projekti, inspektori duhet ta zbatojë përqindjen mesatare për të gjitha projektet.

Nëse tatimpaguesi, përveç veprimtarisë ndërtimore, mirret edhe me veprimtari tjera, nga tatimpaguesi kërkohet të mbajë libra të veçanta për ndërtimtari, në të cilat do të bëhen edhe korigjimet e nevojshme para se të plotësohet deklarata tatimore për periudhën përkatëse .

Shënim: Nëse më vonë ndryshon % (përqindja) e raportit në mes të furnizimeve të tatuara dhe furnizimeve të përjashtuara atëherë, përkundër projektit fillestar të prezantuar, mund të bëhen korigjimet e nevojshme për ndryshim të këtij raporti në mes të TVSh-së së zbritshme dhe TVSh-së së përjashtuar .

Vërejtje: Neni 21 i po të njejtit Udhëzim sqaron :

Në lidhje me Nenin 12 të Rregullores "Furnizim i përjashtuar", transferi i titullit dhe dhënia me qira e pasurisë së banueshme dhe tokës është një furnizim i liruar nga tatimi. Megjithatë, "Konstrukioni" konsiderohet një furnizim normal i shërbimeve dhe është furnizim i tatuar . Për shkak të karakteristikave specifike të konstrukcionit, " Situacioni i Progresit të Punëve" do të njihet si në Faturën e shitjes normale të TVSH-së .

10. *Në Misionin e Zyrës së Ndërlidhjes në Kosovë , jemi të liruar nga TVSh-ja për importet apo hyrjet nga RFJ-ja, të kryera për përfaqësuesit diplomatikë ose zyrat e ndërlidhjes. Postë Telekomit i Kosovës , Korporata Energjetike e Kosovës dhe Grand Hotel Prishtina , të cilat edhe pse kanë faturuar për Zyrën tonë të Ndërlidhjes, kanë përfshirë në çmimin përfundimtar të faturës edhe TVSh-në.*

Përgjigje: Bazuar në Rregulloren Nr. 2001/11 për TVSh, e ndryshuar me Rregulloren Nr. 2002/17, neni 11 pika (d) ku përcaktohet se:

Importet ose hyrjet brenda RFJ-së, të cilat i kanë bërë përfaqësuesit diplomatikë ose janë bërë për ta, apo për Zyrat e Ndërlidhjes, në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/42 të datës 10 korrik 2000 mbi Themelimin dhe funksionimin e zyrave të ndërlidhjes në Kosovë,

Blerje e Përrjashtuar nënkuptohet:

Sa herë të jetë kryer një blerje e përjashtuar brenda vendit nga Zyrat e ndërlidhjes apo përfaqësuesit e zyrave, duhet të sigurojnë, për shitësin e regjistruar, hollësitë e tyre personale identifikuese dhe autorizimin nga organizata se ai /ajo është i autorizuar të ekzekutojë blerjen zyrtare.

Shitësit vendorë, nuk do të ngarkojnë TVSh-në për furnizimet e përjashtuara për organizatat e listuara më lart. Shitësit duhet të faturojnë me normën tatimore 0% , dhe mund të kërkojnë kredit të tatimit të zbritshëm për çdo tatim të paguar për atë furnizim.

Përfaqësuesi i Zyrës do të vërtetojë se asnjë TVSH nuk është paguar për atë furnizim duke vendosur nënshkrimin e tij/saj në faturë. Trupat e përjashtuar do të bëjnë kopje të faturave të TVSH-së së përjashtuar çdo muaj, verifikojnë autenticitetin dhe i dërgojnë ato në Zyrën Tatimore Regjionale .

Zyra e Ndërlidhjes mund të kërkojë nga subjektet që e kanë ngarkuar TVSH-në në faturat e tyre, t'i korrigjojnë faturat dhe t'i këthejnë TVSH-në e paguar, pasi që zyra t'i ofrojë formularin me dëshmitë e nevojshme.

KT

KONTROLLI TATIMOR

□ Roli dhe rëndësia e kontrollit tatimor

Kontrolli është grup veprimesh apo aktiviteteve të cilat i ndërmerr menaxhmenti i ATK-së për të verifikuar se a zbatohen procedurat ligjore dhe me kohë t'i zbulojë shmangiet nga standardet e pranuar, si dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë.

Me rastin e kontrollit, organet tatimore janë të obliguara t'i përmbahen rregullave tatimore të përcaktuara me ligjin mbi procedurat e ATK-së. Këto janë rregulla të cilat përcaktojnë kohën e vlefshmërisë, mundësinë për t'iu qasur shënimeve zyrtare, obligimit për të ruajtur fshehtësinë zyrtare, dhe për të vepruar me besim të plotë mbi faktet.

Me zbatimin e procedurave tatimore, në njërin anë mbrohen interesat fiskale të shtetit, dhe në anën tjetër mbrohen të drejtat dhe obligimet e tatimpaguesit.

Për të qenë sa më të efektshëm dhe konkret në objektivat dhe drejtimin e veprimtarisë kontrolluese, në afatet e realizimit të programit, dhe përcaktimin e drejtimeve kryesore të kontrollave, rëndësi e veçantë i kushtohet studimit të fushave, dhe njohjes së objektivave të kontrollit në mënyrë të detajuar, duke bërë vlerësimin sa më real të gjendjes së tatimpaguesëve.

□ Parimet themelore të kontrollit tatimor

Organet kompetente tatimore, të të gjitha llojet e kontrollave tatimore, duhen të kenë parasysh këto parime:

- **Integriteti**- është vlera kryesore e kodit të etikës. Organet tatimore kanë detyrë që të jenë në pajtueshmëri të plotë me standarde të larta të sjelljes si psh. ndershmërinë, drejtësinë, pastërtinë dhe besueshmërinë në rrjedhën e punës së tyre.
- **Pavarësia dhe objektiviteti**- organet tatimore duhet të jenë dhe të mbetën të pavarura dhe objektive për subjektin që kontrollon. Pra, kursesi nuk duhet të dobësohen nga interesa personale apo të jashtme, dhe nuk duhet të lejojnë paragjykim apo anim për të menjanuar objektivitetin.
- **Kompetenca dhe kujdesi i duhur**- organet tatimore kanë për detyrë të sillen në mënyrë kompetente dhe profesionale në çdo kohë, dhe të aplikojnë standarde të larta profesionale në zbatimin e punës së tyre me kompetencë dhe paanësi. Organet tatimore duhet të mbledhin informacione rreth subjektit dhe njërive të tija, por përfundimi dhe opinioni duhet të mbështetet vetëm në fakte.
- **Sjellja profesionale**- organet tatimore duhet të kenë sjellje profesionale dhe të mos përfshihen në sjellje të tilla të cilat diskreditojnë profesionin, dhe thyejnë parimet e etikës profesionale, dmth se janë të obliguara që shërbimet profesionale t'i ushtrojnë me kujdes dhe në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore.
- **Konfidencialiteti**- organet tatimore duhet të respektojnë konfidencialitetin e informatave, dhe nuk duhet të shfrytëzojnë apo shpalosin asnjë informatë pa pasur autorizimin e duhur, përveç rasteve kur ka një të drejtë apo detyrim ligjor në lidhje me to.

□ Vetë-Vlerësimi

- Aty ku një person dorëzon një deklaratë tatimore të kërkuar sipas legjislacionit të zbatueshëm, tatimi i deklaruar si detyrim në formularin tatimor do të trajtohet si vetë-vlerësim i tatimpaguesit për detyrimin tatimor të pagueshëm dhe të saktë.
- Një tatimpagues, mund të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore, nëse ai ose ajo më vonë zbulon ndonjë gabim në deklaratën të cilën e ka dorëzuar. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se pesë vjet pas datës kur deklarata është dorëzuar fillimisht.
- Deklarata ndryshuese nuk do të ketë asnjë efekt pasi organet tatimore të kenë ushtruar kompetencën e vetë sipas nenit 13 ose 14 të Ligjit Nr. 2004/48 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”, në lidhje me atë periudhë tatimore, dhe të ketë filluar një hetim tatimor për atë periudhë tatimore.

□ Vlerësimi i organeve tatimore

Vlerësimet nga zyra- aty ku organet tatimore besojnë se informatat e siguruara nga një person në deklaratën tatimore nuk paraqesin në mënyrë të saktë detyrimin e tij tatimor, ose kur tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar me ligj, mund të bëjnë një vlerësim të detyrimit të tij tatimor.

Vlerësimi do të bëhet sipas gjykimit më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion dhe ato përfshijnë:

- a) librat, regjistrimet, faturat ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit;
 - b) librat, regjistrimet, faturat ose informatat tjera përkatëse të personave të tretë;
 - c) Informatat të tjera objektive rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatimpaguesit lidhur me detyrimin e tij.
- Në qoftë se librat dhe regjistrimet kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, organet tatimore do të bëjnë një vlerësim bazuar në një parashikim. Parashikimi duhet të bazohet në mjetet, të ardhurat qarkulluese, shpenzimet e prodhimit, shpenzimet krahasuese, dhe metodat tjera direkte dhe indirekte, që lidhen me llogaritjen e detyrimit tatimor.
 - Kufizimi kohor për vlerësimin e të gjitha tatimeve është gjashtë vite nga data kur deklarata tatimore me të cilën lidhet vlerësimi, bëhet e detyrueshme për pagim.

Organet tatimore mund të bëjnë vlerësim në çdo kohë, në rastin kur:

- a) një person, me synim të shmangies së tatimeve, nuk ka dorëzuar deklaratën tatimore;
- b) një person, me synim të shmangies së tatimeve, ka dorëzuar një formë tatimore të cilën organet tatimore e konsiderojnë të pasaktë;
- c) Është kryer mashtrimi nga ose në emër të një personi në lidhje me një detyrim tatimor.

Tatimpaguesi ka barrën e provës, lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga organet tatimore është e gabuar.

□ **Procesi i kontrollit tatimor**

Me rastin e kontrollit, organet tatimore (ATK), të të gjitha llojet e kontrollave duhet të kenë parasysh:

1. Informatën mbi respektimin e rregullave tatimore,
2. Përgatitjen e inspektorit i cili udhëheq kontrollin tatimor,
3. Ekonomicitetin dhe racionalitetin e veprimit,
4. Fshehtësinë e shënimeve në pajtueshmëri me ligjin dhe aktet tjera në fuqi (etikën profesionale.)

Analiza e riskut

Formulimi i programit të kontrollit kërkon një analizë të detajuar të risqeve, andaj analiza e riskut është mjet për vendosjen se cilat procedura duhet të kryhen. Për këtë analizë ATK-ja përdor informacionin, të dhënat e mbledhura para kontrollit dhe ato të cilat dalin nga paraqitja analitike paraprake.

Mbi bazën e këtij informacioni, ATK vlerëson mundësinë që deklarata tatimore përmban pasaktësi që kanë ndikim material për objektivin e kontrollit. Kjo shënon elementet mbi të cilat bazohet ky vlerësim, që më pas këto elemente përfshihen në kontroll.

Organet tatimore vlerësojnë riskun e kontrollit, me kryerjen e analizës së riskut. Analiza e riskut përfshinë: njohjen, llogaritjen dhe vlerësimin e riskut, se një deklaratë tatimore përmban gabime të rëndësishme materiale si p.sh;

- *mos-regjistrimi i faturave;*
- *trillimi i blerjeve dhe shpenzimeve;*
- *pretendimi për kreditim tatimor që nuk i takon;*
- *pagat e kalkuluar gabimisht ;*
- *zbatimi i përqindjeve të zhvlerësimit pa të drejtë;*
- *paraqitja e zërave të pazakontë etj.*

Procesi i kontrollit tatimor kalon nëpër këto faza:

- *Planifikimi i kontrollit tatimor;*
- *Ekzekutimi i kontrollit tatimor;*
- *Formimi i gjykimit;*
- *Raportimi dhe*
- *Krijimi i dosjes.*

Menaxhimi dhe organizimi



□ *Planifikimi i kontrollit tatimor*

ATK është e autorizuar të bëjë inspektimin dhe kontrollin e librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit për qëllime zyrtare. Realizimin e kontrollave, organet tatimore, e sigurojnë duke u bazuar në:

- *Planin e përgjithshëm vjetor të kontrollit*
- *Planin tremujor të kontrollit.*
- *Planin mujor të kontrollit.*
- Planin e përgjithshëm vjetor e përpilon departamenti i kontrollit, në bashkëpunim me regjionet përkatëse të ATK-së. Në Planin e përgjithshëm, parashihen kontrollat për tatimpagues, të mesëm dhe të mëdhenj, periudha dhe koha e kontrollit, si dhe planifikimi i kuadrit për realizimin e tij.
- Planin tremujor dhe mujor e përgatitin menaxherët e regjioneve dhe udhëheqësit e ekipeve, duke u bazuar në planin e përgjithshëm vjetor, dhe i cili më pas zërthehet sipas prioritetëve në baza javore dhe ditore.
- Çdo herë, me rastin e përgatitjes së planit ekziston hapësirë për rastet urgjente, me kërkesë të agjencioneve të zbatimit të ligjit si p.sh (Shërbimi policorë, Dogana etj.)

• *Përzgjedhja e rasteve për kontroll*

Përgatitja e rasteve për kontroll nënkupton grup veprimesh apo aktiviteteve që në mënyrë sa më efikase të realizohet kontrolli tatimor, siç janë:

- njohja e tatimpaguesit në bazë të shënimeve nga dosja e tatimpaguesit;
- njohja e tatimpaguesit nga aspekti i statusit të cilin e disponon (deklaratat, raportet e kontrollit, librat dhe evidenca e tij);
- njohja e tatimpaguesit nga kontrollat e më hershme dhe vizitat e bëra etj.
- përgatitja individuale e zyrtarit tatimor duke ju përshtatur llojit dhe peshës së kontrollit tatimor.

Përzgjedhja e rasteve për kontroll duhet të bëhet të subjektet me risk të lartë dhe të mesëm , por duke mos lënë anash edhe bizneset tjera, të cilat duhet të vizitohen në mënyrë që mos të kuptohet se kanë mbetur të harruara.

Ekzekutimi i kontrollit tatimor

- *Kontrrolli tatimor*

Fillimi i kontrollit tatimor - Organet tatimore, për këtë qëllim të veçantë, në çdo kohë dhe me njoftim paraprak, përveç nëse rrethanat kërkojnë ndryshe, do të kenë qasje në çdo objekt ku kryhet biznesi, përfshirë librat, regjistrimet, kompjuterët ose pajisje të ngjashme për ruajtje të regjistrave, për të konkluduar se qasja mund të sigurojë materiale përkatëse lidhur me çdo lloj detyrimi tatimor.

Kontrrolli fillon me dhënien e urdhërit me shkrim nga ATK, andaj organet tatimore sipas këtij urdhri mund:

- a) të bëjnë një kopje nga secili libër, regjistrim, kompjuter ose pajisje e ngjashme për ruajtjen e regjistrave,
- b) të mbajnë çdo libër ose regjistrim të tillë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të përcaktuar detyrimin ose për çdo veprim sipas këtij ligji,
- c) të kërkojnë transferimin e posedimit të çdo libri ose regjistri i cili për organet tatimore mund të sigurojë provë e cila mund të jetë e rëndësishme materiale, në përcaktimin e detyrimit tatimor.
- d) të kërkojnë transferimin dhe të mbajnë kompjuterin për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të kopjuar informatat e kërkuara;
- e) të kërkojnë dhënien e fjalëkalimit që mbron informatat në kompjuter ose pajisje për ruajtjen e regjistrave.

- *Intervista fillestare*

Një prej fazave të rëndësishme të çdo kontrolli është intervista fillestare me tatimpaguesin. Qëllimi primar i intervistës është që zyrtarët tatimorë të njoftohen me veprimtarinë e tij, e cila do të prezantojë pamjen e përgjithshme të tatimpaguesit, një kuptim të përgjithshëm të operacioneve të tatimpaguesit dhe një paraqitje të mbajtjes së të dhënave.

Hapja e bisedës (Intervista fillestare) të bizneset individuale duhet të bëhet me pronarin e biznesit ose përfaqësuesin e tij.

Në një ortakëri duhen intervistuar partnerët, kurse të korporata, intervista duhet realizuar me drejtorët e korporatës, meqë ata janë përfaqësuesit ligjor që drejtojnë ndërmarrjen.

Pyetjet e bëra dhe përgjigjet e intervistës duhet të shkruhen në formularin AU 005 dhe në fletët e punës, të cilat do të jenë transparente për tatimpaguesin.

- *Procesi i ekzaminimit analitik*

Procesi i ekzaminimit analitik përfshinë:

- analizën e deklaratave tatimore;
- shqyrtimin e librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit;
- ekzaminimin e dokumenteve siç janë: faturat dhe regjistrat tjerë;
- kërkesën e informatave nga palët e treta;
- shqyrtimin dhe analizën e shënimeve të mbledhura para dhe gjatë procesit të kontrollit etj.

Pas ndërmarrjes së hapave të cekur më lartë, organet tatimore vijnë deri te formimi i gjykimit.

Formimi i gjykimit

Në këtë fazë të procesit të kontrollit, inspektori i kontrollit përmbledh të gjitha të gjeturat gjatë kontrollit dhe formon gjykimin mbi bazën e këtyre të gjeturave.

Në rastet kur të dhëna të veçanta të regjistruara janë jo-korrekte, organet tatimore duhet të veprojnë në përputhshmëri të plotë me rregullat e përcaktuara me Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Nr. 2004/48.

Organet tatimore, para se të përcaktojnë pozicionin përfundimtar, me tatimpaguesin duhet të diskutojnë për gjykimin dhe konkluzionin. Nëse tatimpaguesi nuk pajtohet me konstatimin e organeve tatimore ai duhet t'u ofrojë dëshmi për të vërtetuar të kundërtën.

Pas diskutimit të konkluzioneve me tatimpaguesin, organet tatimore përcaktojnë përfundimisht pozicionin e tij.

Nëse gjatë kontrollit kemi tatim shtesë, atëherë organet tatimore i plotësojnë format AU010 të cilat dorëzohen në TI për përpunim. Nëse nuk kemi tatim shtesë, atëherë plotësohet formulari për mos ndryshim AU008.

Baza për llogaritjen e sanksioneve dhe interesit është tatimi shtesë i zbuluar tek tatimpaguesi.

Për llogaritjen e sanksioneve dhe interesit vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet:

- *cilit lloj të tatimit i takon tatimi shtesë i zbuluar;*
- *cilës periudhe tatimore i takon tatimi shtesë i zbuluar;*
- *kur ka skaduar afati i pagesës së tatimit;*
- *kur është kryer kontrolli tek tatimpaguesi me rastin e zbulimit të tatimit shtesë dhe*
- *për sa kohë është e lejuar llogaritja e gjobave dhe interesit.*

Bazuar në Ligjin 2004 /48 Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, për mos përmbushje të detyrimeve tatimore janë paraparë sanksionet dhe Interesi si vijon:

Sanksionet, për mosdorëzim të deklaratës tatimore në kohë, mospagim dhe interes;

▪ ***Për mosdorëzimin e deklaratës tatimore në kohën e caktuar (mosdeklarim me kohë) tatimpaguesi do të nënshtrohet një sanksioni prej 5% në muaj ose për pjesën e muajit, maksimalisht 25% (5 muaj x 5% = 25%)***

▪ ***Për mospagesën e tatimit në kohën e paraparë, tatimpaguesi do të nënshtrohet një sanksioni prej 2 % në muaj apo pjesë të muajit. Ky ndëshkim paguhet maksimalisht deri në 12 muaj (12 x 2%= 24%);***

▪ ***Për pagesën e vonuar llogaritet interesi ne bazë mujore, për çdo muaj apo pjesë të muajit nga dita kur tatimi duhet të paguhet, Interesi është 1.5 % në muaj apo pjesë të muajit. Llogaritja e interesit vazhdon deri tek pagesa e tërësishme e obligimit***

Nën-deklarimet e tatimit dhe mbi-deklarimet e rimbursimeve tatimore.

- Në rastin kur një person i cili ka detyrë të plotësojë një deklaratë tatimore sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë nën-deklaron shumë korrekte të detyrimit tatimor, ose mbi-deklaron shumë korrekte të rimbursimit tatimor e cila i takon, personi i tillë do t'i nënshtrohet sanksionit prej:
 - a) njëzet e pesë përqind (25%) të diferencës mes shumës korrekte të tatimeve që duhet të deklarohet dhe shumës që në të vërtetë është deklaruar aty ku ndodh nën-deklarimi i tillë ose, siç mund të jetë rasti, mbi-deklarimi ka ndodhur për shkak të pakujdesisë ose pakujdesisë së madhe të atij personi; ose
 - b) një qind për qind (100%) e ndryshimit mes shumës korrekte të tatimit që duhet të ishte deklaruar dhe shumës që në të vërtetë është deklaruar aty ku ndodh nën-deklarimi i tillë ose, siç mund të jetë rasti, mbi-deklarimi ka qenë për shkak të synimit me paramendim ose me qëllim të atij personi për të fshehur shumë korrekte të tatimit që kërkohet të deklarohet me qëllim që t'i shmanget pagesës, ose kërkesës për rimbursim, të atij ndryshimi.

Mosdorëzimi, moskrijimi ose mos paraqitja e të dhënave

- Çdo person i cili ka detyrë të krijojë ose mbajë regjistrime sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë dhe i cili nuk e kryen këtë do t'i nënshtrohet ndëshkimit prej:
 - a) njëzet e pesë përqind (25%) të tatimit të vlerësuar me të cilin lidhen regjistrimet nëse moskryerja është për shkak të pakujdesisë së madhe nga ana e personit; dhe
 - b) një qind për qind (100%) të tatimit të vlerësuar me të cilin lidhen regjistrimet nëse moskryerja është për shkak të përpjekjes me qëllim për të shmangur pagesën e tatimit.

Shkeljet e Tatimit në Vlerën e Shtuar

- Një tatimpagues i cili ka detyrë të regjistrohet për TVSh dhe i cili kryen furnizime pa qenë i regjistruar për TVSh do të jetë përgjegjës për detyrimin e TVSh-së mbi ato furnizime plus sanksioni prej:
 - a. njëzet e pesë përqind (25%) të detyrimit tatimor mbi ato furnizime nëse mos-regjistrimi ka ndodhur për shkak të pakujdesisë ose pakujdesisë së madhe të personit të tatueshëm; apo
 - b. një qind përqind (100%) të detyrimit tatimor në ato furnizime nëse mosregjistrimi ka ndodhur për shkak të synimit me paramendim ose me qëllim të personit të tatueshëm që mos të paguajë TVSh-në për ato furnizime.

- Një person i tatueshëm i cili nuk lëshon faturë të TVSh-së ose i cili lëshon një faturë jokorrekte që rezulton në një ulje të dukshme në shumën e detyrimit të TVSh-së ose në një rritje të dukshme në shumën e kreditimit të pretenduar do të jetë përgjegjës për atë ulje në shumën e detyrimit ose në atë rritje në shumën e kreditimit të pretenduar në lidhje me faturën ose transaksionin, plus sanksioni prej:

- a. njëzet e pesë përqind (25%) të uljes ose rritjes së dukshme në shumën e detyrimit të TVSh-së aty ku mos-lëshimi i një fature të TVSh-së ose lëshimi i një fature jokorrekte ka ndodhur për shkak të pakujdesisë ose pakujdesisë së madhe të personit të tatueshëm; apo*
- b. një qind përqind (100%) të uljes ose rritjes së dukshme në shumën e detyrimit të TVSh-së në rastin kur mos-lëshimi i një fature të TVSh-së ose lëshimi i një fature jokorrekte ka qenë për shkak të synimit me paramendim ose me qëllim të personit të tatueshëm ose për të mos lëshuar një faturë të TVSh-së ose për të lëshuar një faturë të rreme.*

Mos-mbajtja e tatimeve nga paga, pagesa ose dorëzimi i tatimeve dhe shumave të tjera

- Çdo person përgjegjës për të mbajtur tatime nga paga, për të mbledhur ose paguar tatimin i cili qëllimisht nuk mban tatimin nga paga, nuk mbledh ose paguan atë tatim do t'i nënshtrohet një sanksioni të barabartë me shumën e tatimit të mos-mbajtur nga paga, apo shumën e tatimit të pa-mbledhur ose të papaguar.
- Çdo punëdhënës përgjegjës për të mbajtur tatimin nga paga dhe për të paguar kontributet e pensionit në Fondin e Kursimeve për Pension të Kosovës në emër të vetin ose të punësuarve të tij i cili qëllimisht nuk mban kontributet e tilla nga paga ose i cili qëllimisht nuk paguan kontributet e mbajtura nga paga do t'i nënshtrohet një sanksioni të barabartë me shumën e kontributeve të mos-mbajtura në burim ose të papaguara në Fond.

Me ligjin në fuqi nga pagesa në fillim paguhen obligimet shtesë nëse ekzistojnë e pastaj borxhi themelor i lindur me tatim.

Raportimi

Raporti i kontrollit- në përfundim të çdo kontrolli, organet tatimore duhet të përgatisin një raport me shkrim mbi të gjeturat të cilat janë konstatuar gjatë kontrollit

- ***Struktura e raportit të kontrollit duhet të përfshijë:***
 - *emrin e biznesit/ adresën / telefoni;*
 - *numrin e regjistrimit të biznesit NRB;*
 - *pronarin e biznesit/ adresa /telefoni;*
 - *objektivat dhe fushëveprimin e kontrollit;*
 - *tatimet e kontrolluara dhe periudhat tatimore;*
 - *ndryshimet pas përfundimit të kontrollit;*
 - *emrin e inspektorëve të kontrollit.*

- **Përmbajtja e raportit**

Përmbajtja e raportit duhet të jetë e tillë, që raporti të mund të lexohet në mënyrë të pavarur nga çdo dokument tjetër, dmth:

- rezultatet duhet të përfshihen në raport në mënyrë bindëse, të qartë, të organizuar, dhe të mbështetur në fakte;
- raporti duhet të jetë i qartë, të mos jetë i dykuptimtë, dhe të mund të interpretohet vetëm në një mënyrë;
- duhet të përfshijë informatat e mbështetura me fakte relevante dhe kompetente, të jetë i pavarur, objektiv, i drejtë dhe konstruktiv;
- raporti i kontrollit duhet të ketë mbështetje të plotë në ligjet dhe rregulloret e ATK-së, të jetë i mbështetur nga fletët e punës, llogaritjet dhe kopjet e bashkangjitura si dëshmi.

Në fund, raporti i kontrollit duhet të jetë i nënshkruar nga inspektori tatimor, udhëheqësi i ekipit, dhe menaxheri i regjionit përkatës.

- **Dërgimi i raportit**

- raporti duhet t'i dorëzohet tatimpaguesit, pas përfundimit të kontrollit, së bashku me dokumentacionin tjetër mbështetës, si : (Formularët AU -011, AU,014 etj.);
- raporti dërgohet me **një letër shoqëruese** të bashkangjitur me raportin e kontrollit;
- letra shoqëruese duhet të nënshkruhet nga tatimpaguesi për të vërtetuar se raporti i është dorëzuar tatimpaguesit;
- nëse tatimpaguesi nuk nënshkruan letrën shoqëruese, inspektori-dërguesi i raportit, i shënon vërejtjet pse tatimpaguesi nuk e ka nënshkruar;
- në rastet kur tatimpaguesi nuk e pranon Raportin e Kontrollit, atëherë dërgimi mund të bëhet edhe përmes postës, apo edhe formave tjera të përcaktuara me ligj.

- **Vlerësimet pas kontrollit**

Formulari AU011- Njoftimi për vendosje tatimi dhe kërkesë për pagesë me të dhënat e plotësuara, duhet ta ketë mbështetjen me sqarimet e raportit të kontrollit se si ka ardhë deri të:

- Qarkullimi shtesë ,
- Tatimi shtesë ,dhe
- Sanksionet.

Në kohën e dorëzimit të AU011 dhe **raportit përmbledhës të kontrollit** te tatimpaguesi, organet tatimore duhet të jenë të gatshëm që t'i japin sqarime tatimpaguesit lidhur me tatimin shtesë, sanksionet, interesin, periudhat tatimore, pagesën dhe procedurën mbi të drejtën e ankesës.

Konform dispozitave të Nenit 20 të Ligjit Nr. 2004/48 “Administrata Tatimore dhe Procedurat”, Njoftim - Vlerësimi dhe kërkesa për pagesën e tatimit duhet të përmbajë informacionin që vijon:

- emrin e tatimpaguesit;
- numrin identifikues të tatimpaguesit;
- datën e njoftimit,
- çështjen dhe periudhat tatimore për të cilat është bërë njoftimi;
- shumën e tatimit të vlerësuar, gjobat dhe interesin për pages të vonuar;
- kërkesën për pagesën e shumës së detyruar;
- vendin dhe mënyrën e pagesës së shumës së detyruar dhe
- një sqarim të shkurtër për vlerësimin.

- *Ankesat në Administratën Tatimore*

Pas dorëzimit të vlerësimeve dhe raportit përfundimtar të kontrollit, organet tatimore, tatimpaguesit duhet t’i dorëzojnë formularin AU 014, mbi të drejtën e ankesës në rast të mos pajtimit me përcaktimin e bërë nga organet tatimore.

Ankesa duhet të dorëzohet brenda 60 ditëve nga data kur tatimpaguesi ka pranuar njoftimin e vlerësimit ose përcaktimin tjetër zyrtar. Ankesa duhet të jetë me shkrim, të përmbajë arsyet dhe dokumentet mbi të cilat tatimpaguesi e bazon ankesën.

Departamenti i ankesave, do të marrë në konsideratë ankesën e tatimpaguesit dhe për këtë do të lëshojë një vendim. Ankesa do të shqyrtohet sa më shpejt të jetë e realizueshme, por jo më vonë se 60 ditë pas datës së ankesës.

Vendimi i Departamentit të Ankesave do të jetë vendim i fundit i organeve tatimore, dhe do të jetë detyrues për ATK.

Tatimpaguesi, i cili nuk pajtohet me një vendim të Departamentit të Ankesave mund të paraqesë ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtim brenda 60 ditëve pasi është marrë njoftimi i vendimit të Departamentit të Ankesave.

Në rastin kur Departamenti i Ankesave nuk dorëzon vendimin brenda 60 ditëve, nga dita kur është dorëzuar ankesa, tatimpaguesi mund të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime.

Kundër vendimeve të Bordit mund të bëhet ankesë në gjykatë të juridiksionit kompetent, me kusht që ankesat e tilla të jenë pranuar brenda 60 ditëve nga pranimi i njoftimit të vendimit të Bordit

Krijimi i dosjes

Në mënyrë që të organizohet dhe të arkivohet dokumentacioni i punës së inspektorit, krijohen dosjet e kontrollit.

- Këto dosje janë të standardizuara në mënyrë të tillë që sigurojnë një gjurmim të lehtë të dokumentacionit të kërkuar, dmth përmbajnë informata tërësore, shpjegime, dhe klasifikime plotësuese që të lejojnë të kuptuarit e drejtë të aktiviteteve, procedurave dhe proceseve të ndërmarra në një kontrollë.
- Organet tatimore duhet të respektojnë fshehtësinë e informatave në dosjen e tatimpaguesit, dhe nuk duhet të shfrytëzojnë apo shpalosin asnjë informatë nga kjo dosje, pa pasur autorizimin e duhur, përveç rasteve kur ka një të drejtë apo detyrim ligjor në lidhje me to.

SHEMBULL:

Ky shembull tregon anën procedurale të një kontrolli për TVSh, ku përfshinë: përcaktimin e tatimit shtesë, llogaritjen e ndëshkimeve dhe përmbajtjen e raportit të kontrollit.

Në këtë shembull vlerat dhe normativi janë të supozuara.

Supozojmë se ndërmarrja "NN" gjatë periudhës Korrik- Shtator / 2005 ka pasur këto transaksione:

1. Blerjet e Çimentos për periudhën Korrik-Shtator kanë qenë: $85,329.60\text{€} \times 15\% = 12,799.44\text{€}$
2. Blerjet e rërës për periudhën Korrik-Shtator kanë qenë: $56,441.39\text{€} \times 15\% = 8,466.21\text{€}$
3. Shitjet sipas tatimpa. për periudhën Korrik-Shtator kanë qenë: $203,314.88\text{€} \times 15\% = 30,497.23\text{€}$
4. Stoqet në fund të periudhës tatimore Qershor/2005 kanë qenë: 00€
5. Stoqet në fund të periudhës tatimore Shtator /2005 kanë qenë: 00€

Blerjet për periudhën tatimore sipas tatimpaguesit

Periudhat tatimore	Përshkrimi i mallit	Njësia matëse	Sasia	Çm. Furnizues për njësi	Blerjet - Vlera e tatueshme	Tvsh e zbritshme	Vlera me tvsh
1	2	3	4	5	6	7	8
Korrik /2005	Çimento	kg	61000	0.0696	4,245.60 €	636.84 €	4,882.44 €
	Rërë	m3	215	13.044	2,804.46 €	420.67 €	3,225.13 €
Gusht/2005	Çimento	kg	433000	0.0696	30,136.80 €	4,520.52 €	34,657.32 €
	Rërë	m3	1529	13.044	19,944.28 €	2,991.64 €	22,935.92 €
Shtator/2005	Çimento	kg	732000	0.0696	50,947.20 €	7,642.08 €	58,589.28 €
	Rërë	m3	2583	13.044	33,692.65 €	5,053.90 €	38,746.55 €
TM 3/2005					141,770.99 €	21,265.65 €	163,036.64 €

Shitjet për periudhën tatimore sipas tatimpaguesit

Periudhat tatimore	Përshkrimi i mallit	Blerësit	Sasia në m ³ beto. sipas tatimpag.	Çmimi mesatar i shitjes pa TVSH	Vlera e shitjes pa TVSH	TVSH e llogaritur	Vlera e shitjes përfshirë TVSH
1	2	3	4	5	6	7	8
Korrik /2005	beton B20	Subjekte	50	62.609	3,130.45 €	469.57 €	3,600.02 €
	beton B20	Persona fizikë	70	63.479	4,443.53 €	666.53 €	5,110.06 €
Gusht/2005	beton B20	Subjekte	400	62.609	25,043.60 €	3,756.54 €	28,800.14 €
	beton B20	Persona fizikë	700	63.479	44,435.30 €	6,665.29 €	51,100.59 €
Shtator/2005	beton B20	Subjekte	800	62.609	50,087.20 €	7,513.08 €	57,600.28 €
	beton B20	Persona fizikë	1200	63.479	76,174.80 €	11,426.22 €	87,601.02 €
TM 3/2005			3220		203,314.88 €	30,497.23 €	233,812.11 €

Shitjet sipas kontrollit

Periudhat tatimore	Sasia e çimentos në kg	Sas.në m ³ beton sipas kontrollit	Sas.në m ³ beton sipas tatimpaguesit	Ndryshimi sipas kontrollit	Çmimi i shitjes pa TVSH	Vlera e shitjes pa TVSH	TVSH e llogaritur
1	2	3=(2:340)	4	5=(3-4)	6	7= (5x6)	8=(7 x 15%)
Korrik /2005	61000	179	120	59	63.479 €	3,745.26 €	561.79 €
Gusht/2005	433000	1274	1100	174	63.479 €	11,045.35 €	1,656.80 €
Shtator/2005	732000	2153	2000	153	63.479 €	9,712.29 €	1,456.84 €
TM 3/2005	1226000	3606	3220	386	63.479 €	24,502.90 €	3,675.43 €

Sqarim:

- Qarkullimi shtesë është përcaktuar duke marrë për bazë sasin e blerë të çimentos, në përpjestim me normativin prej 340 kg çimento për një m³ beton .
- Normativin të cilin ndërmarrja ka ofruar për prodhimin e betonit të markës MB-25 është 340 kg në m³.
- Nga kjo rrjedhë se sasia e çimentos prej: 1226000 kg / 340 = 3606 m³ beton.

Emri i Tatimpaguesit: NN
 Periudha Tatimore: Shtator/ 2005
 Data e përfundimit të kontrollit: 15.12.2005

NRB: 80000000
 Insp. Tatimor: A.Gashi
 Shenja ident.: 298
 Vendi i kontrollit: Prishtinë

Nr.	Llogaritje e ndryshimeve	Tatimpaguesit [A]	Sipas kontrollit [B]
1	Shitjet e tatueshme me normën normale 15%	126,262.00 €	135,974.29 €
2	Tvsh e llogaritshme	18,939.30 €	20,396.14 €
3	Blerjet e tatueshme vendore me 15%	84,639.85 €	84,639.85 €
4	Tvsh e zbritshme	12,695.98 €	12,695.98 €
5	Teprica e TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	0 €	0 €
6	TVSH për pagesë	6,243.32 €	7,700.16 €
7	Tvsh e paguar për muajin	6,243.32 €	6,243.32 €
8	Tatimi shtesë		1,456.84 €
9	Ndëshkimet		
11	Shmangia e qëllimshme e tatimit 100% , Neni 49.2(b) Ligji 2004/48		1,456.84 €
12	Mospagim i Tatimit Në Kohë 2% në muaj , Neni 44 Ligji 2004/48 (2muaj x 2 % = 4%)		58.27 €
13	Interesi (Neni 22, Ligji 2004/48) (2 muaj x 1.5 % = 3 %)		43.71 €
14	Totali: Tatimi shtesë ndëshkimet dhe interesi		3,015.66 €

Tatimi shtesë i percaktuar me kontroll, krijon bazën për llogaritjen e Ndëshkimeve dhe Interesit nga Administrata Tatimore.

Pas procesimit të formularëve AU-010 nga Teknologjia Informative gjenerohen formularet AU -011, (Njoftim Vlerësimet) të cilat ju informojnë se Administrata Tatimore ka vendosur tatim shtese , ndëshkime dhe interes ,në emer dhe llogarin tuaj.



UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
 MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
 MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



Data : 15.12.2005

Nr. dosjes: 76

Raporti i Kontrollit

Nr. i biznesit –NRB	<u>80000000</u>
Emri i biznesit /adresa /telefoni	“ NN “
Statusi ligjor i biznesit	<i>Biznes Individual</i>
Pronari i biznesit emri dhe mbiemri / nr. personal / adresa / telefoni	<i>S. Berisha 111111111 - Prishtinë</i>
Përfaqësuesi i biznesit emri dhe Mbiemri / nr. personal	<i>Udhëheqësi financiar – B. Krasniqi 1000000000 – Prishtinë</i>
Regjioni	<i>Prishtinë</i>
Objekti i kontrollit	<i>Qarkullimi dhe blerjet</i>
Tatimi (et) periudha(t) kontrolluese	<i>TVSH – 01.07. 2005 – 30.09.2005</i>
Ndryshimet pas përfundimit të kontrollit	<i>Rritja e qarkullimit</i>
Inspektori(et) tatimor emri dhe Mbiemri / nr. i ID	<i>A. Gashi ID 0298</i>

1. Arsyja e kontrollit dhe rezultatet e kontrollit

Arsyeja e kontrollit

Përzgjedhja për kontrollë bazohet në:

- Analizën e rrezikut;
- Përzgjedhjen sipas rastit;
- Informatat nga palët e treta;
- Të tjera (shpjego).....

Rezultatet e kontrollit:

Kontrolla e përfunduar për Tatimin në Vlerën e Shtuar, ka konstatuar rritje qarkullimi prej 24,503.28 € gjë që ka rezultuar me tatim shtesë në shumën : 3,675.43 €, ndëshkime dhe interes në vlerë 4,030.03 €

2. Përshkrimi i biznesit

Ndërmarrja " NN" është e organizuar si biznes individual me pronar të vetëm. Pronar i kësaj ndërmarrje është S. Berisha, me vendbanim në Prishtinë. Kjo ndërmarrje është themeluar me datë 01.03.2004. Në fillim aktivitet i vetëm i këtij subjekti ka qenë shitja e materialit ndërtimor, kurse më vonë, nga datë 01.03.2005, ka ndërprerë këtë aktivitet, dhe ka filluar të merret vetëm me prodhimin dhe shitjen e betonit.

Selia e ndërmarrjes gjendet në Prishtinë, në lagjen Dardania, linja e prodhimit të betonit gjendet në fshatin Bardhosh, dhe janë pronë e pronarit. Ndërmarrja ka të punësuar gjithësejt 13 punëtorë, të cilët punojnë vetëm në një ndërrim, prej të cilëve: një është menaxher i shitjes, një inxhinier prodhimi dhe mirëmbajtje, një kontabilist, gjashtë punëtorë prodhimi, njëri prej të cilëve është mbikëqyrës ndërrimi, dy roje nate , dy vozitës. Pagat bruto të punësuarëve janë: menaxheri i shitjes dhe inxhinieri i marrin nga 450 €, kontabilisti 350 €, vozitësit nga 300 €, punëtorët e prodhimit marrin nga 250 €, mbikëqyrësi i ndërrimit 300 €, rojtarët nga 200 €. Evidenca kontabël përfshin librin e shitjes dhe blerjes, librin e pagave dhe librin e shpenzimeve. Prej mjeteve themelore posedon: pajisje për prodhimin e betonit , dy kamiona për bartjen e betonit, një kamion pompë për shkarkimin e betonit, një kamion për bartje.

3. Kontrollat Paraprake

Kontrolli paraprak ka përfunduar më dt. 15.08.2005 dhe ka rezultuar me tatim shtesë për mos prezantim real të qarkullimit. Periudha e kontrollit ka përfshirë periudhën 01.03.2004 - 30.06.2005.

4. Kontrolli në praktikë dhe shtrirja e tij

Kontrolli ka filluar me një intervistë fillestare me datë 15.11.2005, me pronarin S. Berisha dhe udhëheqësin financiar të kësaj ndërmarrje B.Krasniqi. Intervista fillestare është zhvilluar në selinë e biznesit e cila gjendet ne Prishtinë. Ky takim kishte të bënte me një njoftim mbi aktivitetin e kësaj ndërmarrje, ku është biseduar për linjen e prodhimit, formën e ndarjes së punës për të punësuarit e saj, partnerët e ndërmarrjes, konkurrencën, dhe një kuptim të përgjithshëm financiar të kësaj ndërmarrje.

Periodha e kontrollit përfshin periudhën 01.07.2005 - 30.09.2005. Dokumentet e prezantuara, me rastin e kontrollit, kanë qenë librat dhe regjistrimet e tij, ku janë përfshirë librat e blerjes dhe shitjes, faturat e blerjeve dhe shitjeve, evidenca kontabël, si dhe normativet të cilat kompania i përdorë varësisht nga marka e prodhimit të betonit.

Blerësit e ndërmarrjes janë personat fizikë, por edhe subjekte, varësisht nga kërkesa.

Blerjet e çimentos dhe rërës i bënë nga ndërmarrjet vendore.

Stoqe të mbetura nga periudhat paraprake kanë qenë zero, si dhe stoqet e mbetura në fund të periudhës Shtator /2005 janë zero.

Mbeturina gjatë procesit të përpunimit të çimentos nuk mbesin, meqë kanë një teknologji të përsosur, dhe shitjet bëhen sipas porosisë.

Ndërmarrja krijon mundësi për prodhimin betonit të markës: MB-20, MB 25 dhe MB- 30, por kërkesat në treg janë të orientuara për prodhimet e betonit të markës MB-25 . Normativin të cilin e përdor ndërmarrja për prodhimin e betonit, sillet prej 280 - 380 kg çimento në m³ dhe atë varësisht nga marka e betonit .

Blerjet për periudhën Korrik-Shtator/2005 sipas tatimpaguesit kanë qenë;

Çimento 1226000 kg , Vlera pa TVSh është, $85,329.60 \times 15 \% = 12,799.44$ €

Rërë 4327 m³ , Vlera pa TVSh është , $56,441.39 \times 15\% = 8,466.21$ €

Shitjet për periudhën Korrik- Shtator/2005 sipas tatimpaguesit kanë qenë;

Beton B- 25 3220 m³ , vlera e tatueshme është, $203,314.88 \times 15 \% = 30,497.23$ €.

5. Përshkrimi i kontrollit të kryer

Faktet në rast

Me rastin e ekzaminimit të dokumentacionit, për analizë të hollësishme kemi marrë faturat e shitjes dhe blerjes të cilat ndërmarrja i ka të evidentuara në regjistrat e saja gjatë kësaj periudhe.

Nga shitjet e saj vërehet se betoni i prodhuar dhe shitur ka qenë i markës MB-25, dhe normativi i cili duhet përdorur për këtë lloj betoni është 340 kg çimento për një m³ beton. Nga përlllogaritja matematikore e sasisë së betonit të prodhuar dhe sasisë së shitur, bazuar në normativin të cilin e kemi marrë për bazë, kemi konstatuar se ndërmarrja nuk ka prezantuar qarkullimin real. Deri te konstatimi i tillë ka ardhur bazuar në normativin të cilin ndërmarrja e ka ofruar dhe përdorur gjatë prodhimit, në përpjesëtim me sasinë e blerë të çimentos në një rënë anë, dhe sasisë se shitur të betonit të prodhuar.

Shpjegimet e hollësishme i kemi paraqitur në fletët e punës, të cilat japin një pasqyrim të veprimeve të marrura, dhe rezultateve të dala nga kontrolli, të cilat i janë bashkangjitur raportit.

Ligji në fuqi

Baza ligjore e ATK për të bërë një vlerësim cili dallon nga vet vlerësimi i tatimpaguesit është i përcaktuar me Ligjin 2004/48, mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Neni 17, si dhe Neni 13 dhe 14, i cili i ruan të drejtën për t'u qasur librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit.

Baza ligjore e Administratës Tatimore për të vendosur mbi qarkullimin, është paraparë me Ligjin e TVSH-së Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/ 17, Neni 8 paragrafi 8.1, si dhe Neni 16 paragrafi 16.1

Njoftimi paraprak

Tatimpaguesi është njoftuar hollësisht për të gjitha të gjeturat, të cilat kontrolli i ka konstatuar, ku janë përfshirë faktet në rast, baza ligjore , tatimi shtesë , dhe sanksionet .

Opinionit dhe arsyet e tatimpaguesit

Pas njoftimit mbi të gjeturat, opinionit i tatimpaguesit ka qenë se deri të kjo gjendje, të cilën e keni konstatuar, kryesisht ka ardhur për shkak të kujdesit jo të duhur. Tatimpaguesi edhe pse shpreh pakënaqësinë lidhur me një gjendje të tillë të krijuar, nuk konteston një konstatim të bërë nga ATK.

Vlerësimi final

Vlerësimi i ATK, pas njoftimit paraprak, dhe opinionit të tatimpaguesit mbetet i pa ndryshueshëm.

6. Sanksionet

Sanksionet janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 2004/ 48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat:

- Sipas Neni 44 të këtij Ligji për mospagesën e tatimit në kohën e paraparë, tatimpaguesi do të detyrohet të paguajë ndëshkimin 2 % në muaj apo pjesë të muajit. Ky ndëshkim paguhet maksimalisht deri në 12 muaj ($12 \times 2\% = 24\%$);
- Sipas Neni 22 të këtij Ligji për pagesën e vonuar llogaritet interesi në bazë mujore, për çdo muaj apo pjesë të muajit nga dita kur tatimi duhet të paguhet. Interesi është 1.5 % në muaj apo pjesë të muajit. Llogaritja e interesit vazhdon deri te pagesa e tërësishme e obligimit.
- Sipas Neni 49.2 (b) të këtij Ligji një person i tatueshëm i cili nuk lëshon një faturë të TVSH-së ose i cili lëshon një faturë jokorrekte që rezulton në një ulje të dukshme të detyrimit tatimor, ose në një rritje të dukshme të kreditimit të pretenduar në lidhje me faturën ose transaksionin, do t'i nënshtrohet një sanksioni prej 100 %, kur mos-lëshimi i një fature ose lëshimi i një fature jo korrekte të ketë ndodhur me qëllim.

7. Instruksionet / udhëzimet / pikat te tjera

Udhëzimet të cilat ju kanë dhënë tatimpaguesit kanë pasur të bëjnë kryesisht me vërejtjen rreth qarkullimit shtesë për TVSH, dhe implikimit të sajë në tatimet tjera (Tatimi në të Ardhura Personale)

8. Aneksi

Anekset e bashkangjitura këtij raporti janë:

- formularët AU-011, nga Teknologjia Informative
- formulari AU-014, mbi të drejtën e ankesës:
- fletët e punës.

Data 15.12.2005

Inspektori Tatimor

Data 15.12.2005

Udhëheqësi i ekipit

Data 15.12.2005

Menaxheri

MPO

MBLEDHJA DHE PËRMBUSHJA
OBLIGIMEVE

MBLEDHJA DHE PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE

Ky është një përshkrim i thjeshtë i detyrave për kryerjen e punës së Mbledhjes Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës. Është e qartë se, shumë aktivitete janë të rëndësishme për një Administratë Tatimore të mirë, siç janë Kontrolli dhe Edukimi i Tatimpaguesit. Të gjitha këto punë bëhen që të kemi një përmbushje të detyrave në nivel sa më të lartë, mbledhje sa më të madhe të detyrimeve tatimore.

Të gjitha funksionet, brënda ATK-së, duhet të ndihmojnë në këtë drejtim. Nëse nuk mbledhen të hyra për Buxhetin e Kosovës, atëherë nuk do të përmbushet misioni i ATK-së. Mbledhja profesionale është e një rëndësie kritike për ATK-në. Prandaj, këtu i theksojmë disa detyra themelore të kërkuara nga funksioni i mbledhjes si dhe mënyrën se si ato arrihen.

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TË MBLEDHJES SË DETYRIMEVE

Ekzistojnë vetëm pesë mënyra për të shlyer një detyrim. Këto pesë mënyra, për të shlyer një detyrim, janë të njëjta, pavarisist se a flasim për një mbledhës privat apo publik.

- Mënyra e parë dhe më e mirë për të shlyer një detyrim është që të inkasojmë shumën e tërësishme të detyrimit. Kjo mund të ndodh menjëherë pasi t'ia dërgojmë njoftimin e parë tatimpaguesit, apo derisa të mos jetë nevoja për të shfrytëzuar ndonjë mjet tjetër të mbledhjes. Nganjëherë ndodh që tatimpaguesi të tregojë se është i paaftë të bëjë pagesën e tërësishme edhe pse ne me një analizë financiare kemi zbuluar se ai mund ta bëjë këtë. Në këto raste, ATK-ja këmbëngulë që të bëhet pagesa e tërësishme e detyrimit. Një gjendje jo e mirë financiare nuk do të thotë se ka të drejtë të mos e bëjë pagesën e tatimit.
- Mënyra e dytë, për të bërë një shlyerje të detyrimit tatimor, është që tatimpaguesit t'i ofrohet një shtyerje më e gjatë apo më e shkurtër kohore për pagesë të tatimit. Ka raste kur nga analiza financiare konstatohet se një pagesë e tërësishme nuk është e mundur të bëhet menjëherë. Kjo, zakonisht, është e mundshme për ato biznese, të cilat kanë punë sezonale apo periodike, si p.sh. bujqësia apo ndërtimataria etj, dhe ka mundësi që të zgjatet afati i pagesës prej 30 – 90 ditë.
- Mënyra e tretë, për të shlyer një detyrim në tërësi, është nëpërmjet marrëveshjes për pagesë në këste, ndonjëherë e quajtur marrëveshje për pagesë më të gjatë. Në ato raste, kur analiza financiare tregon se kjo është mënyra e vetme për ta bërë atë, kjo

bëhet nëpërmjet të pagesës në këste të njejta për muaj të caktuar, brenda afatit të caktuar.

- Mënyra e katërt, për të shlyer një detyrim, është përmes përcaktimit se ky detyrim nuk mund të mbledhet, sepse nuk mund të gjendet vendi i tatimpaguesit (bazuar në hulumtimin e dokumenteve) ose (bazuar në analizë financiare) nuk ka kurrfarë mundësie që detyrimi të paguhet. Në të dy rastet ATK, duhet të përcaktojë se a ekziston mundësia e përmirësimit të kësaj gjendje në të ardhmen. Nëse po, atëherë ky rast duhet të ruhet si dosje në pritje për një shqyrtim të më vonshëm. Nëse jo, atëherë ai vendoset në dosje dhe prap nuk shikohet pasi nuk mund të përcaktohen shkaktarët.
- Mënyra e pestë dhe e fundit është, që detyrimi të shlyhet nëpërmjet mbledhjes me forcë. Barra tatimore, masat për marrje pasurie, shpallja e tatimit në rrezik, embargo në importe dhe eksporte, ndalesat për largim, ngritje të padisë penale etj. janë forma të cilat ATK i zbaton .

Aktiviteti i mbledhjes me forcë, më detajisht, është sqaruar më poshtë:

Kur një tatim është i detyrueshëm?

Që të fillojë mbledhja dhe përmbushja e obligimeve, duhet të ekzistojë një detyrim tatimor që duhet ti paguhet ATK-së e që nuk është paguar, qoftë nga vetëvlersimi i tatimpaguesit (kur tatimpaguesi e deklaroi tatimin por nuk e bënë pagesën) apo nga vlerësimi i bërë nga ATK (pasi që vlerësimi i bërë të ketë kaluar periudhën 60 ditore të afatit të parashtrimit të ankesës). Për tatimin që nuk është paguar e që është bërë i detyrueshëm, zbatohet procedurat e mbledhjes sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 2004/48

Zbatimi i procedurave të mbledhjes sipas Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 2004/48.

Vendosja e barrës mbi pasuritë e tatimpaguesëve

“**Barrë tatimore**” nënkupton të drejtën e Administratës Tatimore të Kosovës të marrë dhe të mbajë pasurinë e tatimpaguesit si siguri për pagesën e çdo tatimi dhe të drejtën për të shitur pasurinë e tillë dhe për të përdorur paratë e shitjes për pagesën e atij tatimi.

Barra tatimore është një instrument detyrues për të detyruar tatimpaguesin të paguajë detyrimet tatimore të pashlyera. Duke vënë një barrë mbi një pasuri të tatimpaguesit borxhli, ATK sigurohet se pasuria nuk do të transferohet, shitet apo të ekspozohet për shitje nga tatimpaguesi. Një barrë mund të dorëzohet në secilën zyrë përgjegjëse për regjistrimin e pronës në Kosovë siç janë: Agjencioni Kadastral i Kosovës, Regjistri i Banesave, Njësia për Regjistrimin e Automjeteve, Regjistri i Transaksioneve të Siguruara, etj, dhe tregon se pronari i pasurisë i ka një borxh tatimor ATK-së. Zyrat e regjistrimeve të sipërpërmendura, kërkohet të regjistrojnë çdo transaksion në lidhje me atë pasuri për të cilën është dorëzuar barra, derisa të jenë lajmëruar zyrtarisht për lirim nga barra, të vendosur nga ATK.

Urdhër-vjelja e pasurisë

Urdhër-vjelje është instrument konfiskimi përmes të cilit të drejtat e pronësisë mbi pasurinë, pronën apo të ardhurat, transferohen nga tatimpaguesit borxhlinj në ATK.

Në qoftë se një person, i cili është i detyruar të paguajë një lloj tatimi, nuk paguan ose refuzon të paguajë brenda 10 ditëve, pas dorëzimit të një njoftimi për vlerësim, ATK-ja ka të drejtë ligjore të mbledhë shumën e tillë (dhe shuma të tjera që janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e masës për marrje pasurie), me masën për marrje pasurie që i përket personit të tillë (qoftë në pronësi fizike të tatimpaguesit ose një personi të tretë).

Urdhër-vjelja mbi pasuritë e tatimpaguesëve që gjendet të palët e treta

Me qëllim që të zbatohet masa për marrje pasurie, ATK-ja do t'i dorëzojë njoftimin për konfiskim personit (përfshirë punëdhënësit, bankat, institucionet të tjera financiare) që ka kontroll ose posedim të pasurisë që i përket tatimpaguesit (qoftë e tundshme, e patundshme, e prekshme ose e paprekshme) ose ai i cili i ka një detyrim ndaj tatimpaguesit, në kohën kur është nxjerrë masa për marrje pasurie.

Në rast se pasuria përbëhet prej rrogës ose pagave të paguara, ATK-ja do t'i dorëzojë një njoftim për konfiskim zyrtarit ose punëdhënësit, i cili ka për detyrë të paguajë rrogën ose pagat.

Në rastet kur pasuria, mbi të cilën është vendosur masa e marrjes, nuk është e majftueshme për të plotësuar pretendimin për të cilën është vendosë masa e marrjes, ATK-ja mundet, më pas, dhe sa herë të jetë e nevojshme, të vazhdojë të vendosë masa marrjeje mbi pasuri të tjera që mund t'i nënshtrohen masës së marrjes, derisa të jetë paguar tërësisht shuma e detyrimit, së bashku me të gjitha shpenzimet nga personi në fjalë.

ATK-ja mund të mbledhë nga çdonjëri prej ortakëve të ortakërisë, çdo lloj tatimi i cili përbën një detyrim të ortakërisë (së bashku me shpenzimet dhe sanksionet).

ATK-ja mund të mbledhë çdo lloj tatimi, i cili përbën një detyrim të shoqatës ose organizatës nga secili anëtar, menaxher ose drejtor i një shoqate të painkorporuar ose organizate (së bashku me shpenzimet, sanksionet dhe interesin). Anëtari i një shoqate të painkorporuar ose organizate, do të jetë përgjegjës për të paguar detyrimin tatimor vetëm deri në shkallën kur anëtari e ka ditur ose në mënyrë të arsyeshme është dashur të dijë për detyrimin tatimor të shoqatës ose organizatës.

Shpallja e tatimit në rrezik

ATK mund të bëjë një vlerësim rreziku, në rastin kur ATK konsideron se mbledhja e tatimit që bëhet detyrim i pagueshëm është në rrezik, sepse personi po përgatitet të shmangë tatimin, duke braktisuar Kosovën, transferuar mjetet, ndërprerë biznesin ose duke ndërmarrë veprime tjera që do të rrezikojnë mbledhjen e tatimit, nëse nuk bëhet një vlerësim rreziku.

Njoftimi i Autoriteteve Doganore për ndaljen e importeve dhe eksporteve

Në çdo rast kur një person i cili është i detyruar të paguajë ndonjë tatim, shpërfillë ose refuzon të paguajë mbrenda 10 ditëve, pas dorëzimit të njoftim-vlerësimit ose kur ATK konsideron se pagesa e tatimit është në rrezik, sipas Nenit 33, do të jetë e ligjshme për ATK-në të kërkojë me shkrim nga Shërbimi Doganor që të vendosë embargo në kalimet e çdo importi apo eksporti nga ai person, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit në mes të ATK-së dhe Shërbimit Doganor të UNMIK-ut.

Ndalesat për largim

Në qoftë se ATK-ja informon Policinë Kufitare me shkrim, se një person i detyruar të paguajë tatime sipas kësaj rregullore nuk ka paguar tatimin, Policia Kufitare do të ndërmarrë hapa të nevojshëm që të parandalojë largimin e personit në fjalë nga Kosova për një periudhë prej 72 orëve, nga koha e lëshimit të letrës, përveç rastit kur gjatë asaj periudhe personi:

- a. kryen pagesën në tërësi;
- b. arrin një marrëveshje të kënaqshme me Drejtorin e ATK, për pagesën e tatimit.

Lidhur me tatimin që nuk është paguar, kur është bërë i detyrueshëm dhe i pagueshëm, ATK-ja, mund të ngrëjë padi dhe të kërkojë pagesën në gjykatën që ka kompetencën e juridiksionit.

Procedurat e konfiskimit

Para se të fillojë përgaditja e procesit të konfiskimit, së pari duhet të bëjmë mbledhjen e informatave financiare për gjendjen financiare të tatimpaguesit, në mënyrë që të organizohet puna dhe të dokumentohet vendimi për mbledhje. Në bazë të deklaratës së mbledhjes së informatave, përcaktohet se si duhet mbledhur borgji.

Para se të ndërmerret çfarëdo aksioni i mbledhjes me forcë, mirë duhet të dihet gjendja e tatimpaguesit . Mënyra më e mirë për ta ditur është të intervistohet tatimpaguesi. Pyetjet duhet të jenë të thjeshta dhe të kuptueshme.

Analiza financiare e gjendjes përdoret:

1. Çdo herë kur nuk kemi informata të qarta dhe të mjaftueshme për mbledhje.
2. Për të gjithë tatimpaguesit e mëdhej
3. Çdo herë kur ATK-ja e sheh të nevojshme.

Procedurat fillestare të konfiskimit

Çdo herë, gjatë përgaditjes së aksionit të konfiskimit, duhet të verifikohet se a ju ka dorëzuar tatimpaguesit formulari “Vërejtja e fundit për pagesën e tatimit”. Nëse tatimpaguesi, dhjetë ditë pas pranimit të këtij formulari, nuk ka bërë pagesën e tatimit, atëherë përgaditet formulari “Njoftimi për konfiskim” për secilën periudhë tatimore dhe i dorëzohet tatimpaguesit.

ATK-ja, çdo herë kur ta fillojë aksionin e konfiskimit, duhet të jetë e shoqëruar me, së paku dy pjesëtarë të policisë.

Nëse tatimpaguesi e bënë pagesën e menjëhershme dhe të plotë, atëherë konfiskimi duhet të ndërpritet.

Nëse tatimpaguesit nuk mund t'i përcaktohet lokacioni dhe nuk ka vendqëndrim të biznesit në Kosovë, njoftimi për konfiskim i dërgohet në adresën e fundit të tatimpaguesit, që njihet .

Në rastet kur pasuria e tatimpaguesit gjëndet në zotërim të palës së tretë, atëherë njoftimi për konfiskim i jepet kësaj pale.

ATK-ja ka të drejtë të ligjshme të konfiskojë aq pasuri sa është e nevojshme, që me rastin e shitjes së pasurisë së konfiskuar, të shlyejë obligimin tatimor (qoftë në pronësi fizike të tatimpaguesit ose të një personi të tretë).

Aktiviteti i parë, për të finalizuar konfiskimin është, që të identifikohet pasuria e konfiskuar, duke etiketuar se kjo pasuri është pronë e Administratës Tatimore. Formulari “Kujdes” (Warning) i ngjitet pasurisë së konfiskuar ku shkruan se kjo është pronë e Administratës Tatimore, për shkak të mos pagesës së tatimit. Çmimi me të cilin konfiskohet pasuria, duhet të jetë një çmim që garanton shitje të sigurtë. Çmimi me të cilin konfiskohet pasuria, duhet të jetë 50% çmim më i lirë i atij malli të konfiskuar se sa në tregun e lirë, apo 30% duhet të jetë më i lirë se sa çmimi furnizues për atë mall. Për pasurinë (mallrat) që caktohen për ta konfiskuar, vendosin ATK-ja e kursesit tatimpaguesi.

Mund të kërkohet ndihma e tatimpaguesit, për të marrë të gjitha masat paraprake për ta siguruar pronën. Nëse ATK-ja e sheh të nevojshme, mund të kontaktojë me tatimpaguesin lidhur me këtë çështje, për ta ruajtur pronën e konfiskuar. Pas çdo aksioni të konfiskimit apo të mbylljes së lokaleve, duhet të lajmrohet stacionit më i afërt i policisë ku duhet t'u tregohet prona e konfiskuar dhe adresa për të patrolluar në atë lokalitet dhe për t'u kujdesur për pronën e konfiskuar nga Administrata Tatimore.

Procedurat e shitjes

Në bazë të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 2004/48, neni 30. Administratës Tatimore i lejohe, që në ankand, ta bëj shitjen e mallit të konfiskuar.

Shitja e pasurisë së konfiskuar bëhet nëpërmjet akandit publik apo ankandit me oferta të mbyllura. Se cilën metodë ATK-ja do ta zgjedhë, për shitjen e pasurisë së konfiskuar, duhet të shqyrtohet se cila pritet të sjellë çmimin më të mirë për pasurinë që ofrohet për shitje.

Nëse pasuria nuk mund të ndahet dhe të shitet në pjesë, pasuria mund të shitet në tërësi dhe çdo tepicë e të ardhurave nga shitja i këthehet tatimpaguesit. Tatimpaguesit do t'i shlyhet obligimi tatimor për atë shumë sa është shitur pasuria e konfiskuar.

Njoftimi i shitjes lëshohet pas 60 ditëve të konfiskimit të pasurisë. Njoftimi për shitje duhet t'i dërgohet tatimpaguesit, t'i dorëzohet në vendqëndrimin e tij apo të biznesit të tij. Nëse nuk e dijmë vendqëndrimin, njoftimi duhet t'i dërgohet me postë, të vërtetuar, në adresën e tij të fundit që e kemi. Një kopje, të Njoftimit për Shitje, duhet t'i dërgohet bashkëpronarëve të pronës apo mbajtësit të barrës. Njoftimi për Shitje duhet të publikohet në gazetën lokale . Nëse njoftimi e ndihmon shitjen, atëherë mund të vendoset edhe në vende tjera ku nuk ka ndodhur konfiskimi.

Nëse është e nevojshme shtyerja e shitjes, ajo mund të bëhet në çdo kohë, para fillimit të shitjes. Shtyrja këshillohet të bëhet atëherë kur, sipas mendimit të ATK-së, fitojnë entet shtetërore. ATK-ja mund të bëjë shtyrjen e shitjes edhe atëherë kur mendon se është mbrojtur interesi i tatimpaguesit.

Para shitjes, ofertuesëve duhet t'u jepet rasti që të inspektojnë pasurinë dhe të pyesin ndonjë pyetje lidhur me pasurinë.

Shitja me Ankand Publik. Fillimisht, duhet të krijohet oferta minimale për pasurinë, e bazuar në vlerën e shitjes së detyrueshme, caktohet koha dhe vendi i shitjes, jo më pak se 10 ditë dhe jo më shumë se 40 ditë, nga data e publikimit.

Ankandi do të jetë i hapur për të gjithë pjesëmarrësit e ankandit, të cilët do të ofrojnë shumën e parave për pasurinë që është në shitje.

ATK-ja do të deklarojë pasurinë për shitje, ofertuesit që ofron çmimin më të lartë.

Pasuria nuk do t'i dorëzohet ofertuesit më të sukseseshëm deri sa të bëhet pagesa e plotë.

Çdo tatimpaguesi që ju ka konfiskuar pasuria, mund ta paguajë shumën totale të tatimit, ndëshkimeve dhe interesit plus shpenzimet varëse gjatë procesit të mbledhjes, në çdo kohë, para se ATK-ja të pranojë ofertën më të lartë. Para se t'i këthehet tatimpaguesit, pasuria e konfiskuar, duhet të vërtetohet pagesa e plotë.

Njoftimi i shitjes me Oferta të Mbyllura: Me këtë formë, shitja do të bëhet kur ofertuesi oferton me pliko të mbyllur, e adreson në ATK, dhe në pliko e thekson se oferta e mbyllur duhet të hapet vetëm nga marrësi. ATK-ja duhet t'i mbajë ofertat, t'i regjistrojë në një listë sipas renditjes që janë pranuar, duke shënuar një numër identifikues në secilën pliko. Ka mundësi që ofertuesi ta tërheq ofertën e vet vetëm nëse kjo ndodhë para kohës së caktuar për hapjen e ofertave.

Në kohën dhe vendin e caktuar fillon hapja e plikove, në prezencën e ofertuesëve ku janë të obliguar që të regjistrohen në listën e pjesëmarrësve në ankand. ATK-ja duhet t'i shënojë në një listë renditjen e ofertave ashtu siç hapen, duke lexuar me zë dhe duke shikuar të gjithë pjesëmarrësit në ankand. Pas leximit të të gjitha ofertave, ATK shpall ofertën më të lartë dhe emrin e ofertuesit më të sukseseshëm.

Nëse e konstatojmë se pasuria e konfiskuar ka shpenzime për ta ruajtur, fillon të dëmtohet apo zvoglohet në vlerë, kjo pasuri mund të shitet vetëm me njoftim të pronarit, pa e pritur periudhën 60 ditore. Kjo procedurë vlenë për ato mallra që duhet të mbahen në frigorifer, për mallrat që prishen lehtë, mallrat me afat të shkurtër të skadimit apo në rastet kur gjatë kohës së deponimit, shpenzimet do të jenë në disproporcion me rezultatin final që dalin nga shitja e mallrave të konfiskuara. Se kur duhet përdorur këtë procedurë (pa e pritur kohën prej 60 ditëve) vendosë ATK-ja.

Llogaritja e shpenzimeve në procesin e konfiskimit & shitjes në ankand & shpërndarja e pagesës

Neni 23 i Ligjit Nr. 2004/48 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, specifikon shpërndarjen e pagesës kur ATK shet me ankand pasurinë e konfiskuar të tatimpaguesit, për detyrime të papaguara:

1. Shpenzimet e Mbledhjes
2. Ndëshkimet
3. Interesi
4. Tatimi

Në shpenzimet e mbledhjes hyjnë, kostoja administrative për konfiskim, shërbimet e ruajtjes, transportimi, shërbimet e ngarkim-shkarkimit dhe shpenzimet e ankandit.

Marrim një rast :

SHEMBULLI 1. Një tatimpagues, ka një detyrim tatimor të papaguar, në shumë prej 10,000.00€ Administrata Tatimore konfiskon një aset të borxhliut dhe e shet përmes ankandit për 9,500.00€

Kostoja administrative për konfiskim është :

• Për shërbimet e ruajtjes	1,200.00 €
• Për shërbimet e transportit	100.00 €
• Për shërbimet e shpalljes	50.00 €
TOTAL	1,350.00€

Sipa Ligjit të lartpërmendur, renditja e pagesave rezulton:

1. Shpenzimet e mbledhjes	1,350.00 €
2. Tatimi, Nde.&Int.	10,000.00 €
3. Pagesa(shit. e aseteve)	9,500.00 €

Bilanci i mbetur i detyrimit tatimor 1,850.00 €(prej shumës së paguar, nga shitja e asetit 9,500.00 € tatimpaguesi, së pari i ka shlyer shpenzimet e mbledhjes në shumë prej 1,350.00€ së dyti , ka shlyer detyrimin tatimor në shumën prej 8,150.00 €).

SHEMBULLI 2. Një tatimpagues, ka një detyrim tatimor të papaguar në shumë prej 10,000.00€ Administrata Tatimore konfiskon një aset të borxhliut dhe e shet përmes ankandit për 12,000.00€

Kostoja administrative për konfiskim është :

•	Për shërbimet e ruajtjes	0.00 €
•	Për shërbimet e transportit	0.00 €
•	Për shërbimet e shpalljes	150.00 €
	TOTALI	150.00 €

Sipa Ligjit të lartpërmendur, renditja e pagesave rezulton:

1.	Shpenzimet e mbledhjes	150.00 €
2.	Tatimi, Nde.&Int.	10,000.00 €
3.	Pagesa(shit. e aseteve)	12,000.00 €

Bilanci i mbetur i kreditimit tatimor 1,850.00€ (prej shumës së paguar nga shitja e asetit 12,000.00€ tatimpaguesi, së pari i ka shlyer shpenzimet e mbledhjes në shumë prej 150.00 € së dyti, ka shlyer detyrimin tatimor në shumën 10,000.00€).

ATK është e detyruar që shumën prej 1,850.00€ ta kthejë të tatimpaguesit.

DOKUMENTET BURIMORE**ADMINISTRATA TATIMORE DHE PROCEDURAT**

- RREGULLORE..... NR.2000/20
- DIREKTIVA ADMINISTRATIVE.....NR.2000/06
- DIREKTIVA ADMINISTRATIVE.....NR.2000/07
- LIGJI.....NR.2004/48
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.01/2000
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.05/2005

TATIMI I PARAGJYKUAR

- RREGULLORE.....NR.2000/29
- RREGULLORE.....NR.2001/40
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.2000/03

TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

- RREGULLORE.....NR.2001/11
- RREGULLORE.....NR.2001/41
- RREGULLORE.....NR.2002/17
- RREGULLORE.....NR.2004/35
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.01/2001
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.01/2004

TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE

- RREGULLORE.....NR.2002/04
- RREGULLORE.....NR.2003/03
- RREGULLORE.....NR.2004/52
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.01/2002
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.02/2005

TATIMI NË FITIM

- RREGULLORE.....NR.2002/03
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.02/2002

TATIMI NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

- RREGULLORE.....NR.2004/51
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.01/2005
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV.....NR.03/2005

GRUPI PUNUES**Sakip Imeri**

Zv. Drejtor - Departamenti i Përbushjes

Ekrem Hysenaj

Zv. Drejtor - Departamenti i Lojërave të Fatit

Naser Prapashtica

Menaxher në Sektorin e Edukimit të Tatimpaguesëve

Osman Neziri

Menaxher në Sektorin e Mbledhjes së Detyrueshme

Nahit Sharku

Menaxher në Sektorin e Kontrollit

Sami Gjyrevci

Këshilltar për përzgjedhje të rasteve për kontroll

Bejt Kapiti

Këshilltar për Tatimin në të Ardhurat e Koorporatave

Magbule Shala

Këshilltare për Tatimin në të Ardhurat Personale

Ruzhdi Zenelaj

Këshilltar për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Sevdie Namani

Këshilltare për Rimbursim dhe Rikthim

Sadije Kosumi


Këshilltare në Sektorin e Mbledhjes së Detyrueshme

Rexhep Krasniqi

Dizajner në Sektorin e Edukimit të Tatimpaguesëve

Xhemail Bajrami

Lektor

**INFORMATA:**

Regjioni	Numri Telefonit
Prishtinë	038/200-255-17
Prizren	029/44-901
Pejë	039/32-124
Gjilan	0280/26-967
Mitrovicë	028/30-059
Ferizaj	0290/20-387
Gjakovë	0390/30-021

E-mail: info@atk-ks.orgWeb: www.atk-ks.org

ORGANIZIMI TERRITORIAL I ATK-së

